



AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

ANALIZE

E

TREGUT

TE TELEFONISE FIKSE

- 1) Tregu i aksesit ne rrjet publik telefonik nga vendodhje fikse.
- 2) Tregu i thirrjeve telefonike te disponueshme per publikun nga vendodhje fikse.
- 3) Tregu me shumice i origjinimit te thirrjeve ne rrjetin telefonik publik te ofruara nga vendndodhje fikse.
- 4) Tregu me shumice i terminimit te thirrjeve per rrjete publike telefonike individuale te ofruara nga vendndodhje fikse.
- 5) Tregu me shumice i sherbimeve tranzite ne rrjetet telefonike publike te ofruara nga vendndodhje fikse.

Dokument Perfundimtar

Korrik 2013

(MIRATUAR ME VKD NR.2336 DATE 30.07.2013)

INDEKSI I PERMBAJTJES

I. PERMBLEDHJE	4
II. HYRJE	13
II.1. PANORAME E SEKTORIT TE TELEFONISE FIKSE	13
II.2. PERCAKTIMI I SIPERMARRSVE ME FUQI TE NDJESHME NE TREG	18
I. Objektivat e Ligjit dhe kuadri rregullator.....	18
II. Procesi i Konsultimit	19
III. Bashkepunimi me Autoritetin e Konkurences.....	19
IV. Struktura e Dokumentit	19
V. Perkufizimi i tregut perkates.....	20
VI. Fuqia e Ndjeshme ne Treg dhe masat rregulluese	22
III. ANALIZA E TREGJEVE TE SHERBIMEVE ME PAKICE	24
III.1. PERKUFIKIMI I TREGJEVE NE NIVELIN ME PAKICE	24
III.2. ANALIZA PER FNT E TREGJEVE ME PAKICE	32
1. Pjeset e tregut.....	33
2. Barrierat per hyrje ne treg	35
3. Konkurrenca e mundshme.....	35
4. Tarifimi i sherbimeve me pakice	37
5. Perfitimet e perdoruesve fundore.....	46
Perfundim per FNT	47
IV. ANALIZA E TREGJEVE TE SHERBIMEVE ME SHUMICE: ORIGJINIMI, TRANZITIMI DHE TERMINIMI I THIRRJEVE NE RRJETET FIKSE	49
IV.1. PERKUFIKIMI I TREGJEVE TE INTERKONEKSIONIT	49
Zhvillime pas Analize 2010 dhe zhvillime te priteshme ne vitet ne vijim	50
IV.2. ANALIZA PER FNT E TREGJEVE TE INTERKONEKSIONIT	55
1 Terminimi i thirrjeve ne rrjetet fikse	55
2 Origjinimi i thirrjeve ne rrjetet fikse	60
3. Tranzitimi i thirrjeve ne rrjetet fikse	63
V. MASAT RREGULLUESE PER OPERATORET ME FNT.....	65
V.1. MASAT RREGULLATORE TE PROPOZUARA PER TREGJET ME SHUMICE TE INTERKONEKSIONIT.....	67
1. Masat rregullatore te propozuara per Albtelecom.....	67
2. Masat rregullatore te propozuara per terminimin ne rrjetet e OA dhe AMC Fiks.....	74
V.2. MASAT RREGULLATORE TE PROPOZUARA PER ALBTELECOM NE TREGJET E PAKICES	77
ANEKS 1. LISTA E SIPERMARRSVE TE RRJETEVE PUBLIKE TELEFONIKE FIKSE TE PERCAKTUAR ME FNT NE TERMINIMIN E THIRRJEVE	81
ANEKS 2: KOMENTET NE KONSULTIM PUBLIK DHE QENDRIMI I AKEP.....	83

INDEKSI I TABELAVE DHE FIGURAVE

Figura II.1 Ecuria e numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse 2000-2012.....	13
Figura II.2 Ecuria e numrit të perdoruesve të telefonisë celulare dhe fikse 2000-2012	15
Figura II.3. Ecuria e penetrimit të telefonisë celulare dhe fikse 2003-2012.....	15
Figura II.4. Krahasimi i normave të penetrimit: Shqipëri 2012 vs mesatare e BE- 27 (2010/11)..	16
Figura II.5. Të ardhurat totale të operatorëve të komunikimeve Elektronike (2012).....	17
Figura III.1: Ecuria e thirrjeve nga rrjetet fikse dhe celulare 2003-2012	29
Tabela III.1: Ecuria e numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse sipas operatorëve (2010-2012)....	33
Figura III.2: Pjesët e tregut të numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse (2012).....	34
Tabela III.2:Pjesët e tregut të treguesve kryesorë të telefonisë fikse 2007-2012	34
Figura III.6: Ecuria e tarifës së pajtimit mujor Familjar: Shqipëri dhe SEE 2006-2012	38
Tabela III.3. Tarifat e pajtimit mujor Familjarë dhe Biznes: Shqipëri dhe SEE 2012	39
Figura III.7. Tarifa e pajtimit standart me minuta të përfshira (me TVSH)	39
Figura III.7. Tarifa e pajtimit mujor Familjarë në Euro dhe Euro/PPP:	40
Shqipëri dhe SEE 2010	40
Figura III.8. Kostoja e një thirrje lokale 10 minuta: Shqipëri dhe SEE 2006-2012 (euro me TVSH)	41
Figura III.9. Kostoja e një thirrje kombëtare 10 minuta: Shqipëri dhe SEE 2008-2012	41
Figura III.10. Kostoja e një thirrje ndërkombëtare 10 minuta drejt MB dhe SHBA: Shqipëri dhe SEE 2008-2012	42
Tabela III.4. Tarifat me pakice telefonike të Abcom 2012	43
Tabela III.5. Tarifat me pakice telefonike të AMC Fiks 2012	44
Tabela III.6: Përdorimi mesatar mujor i shërbimeve të Albtelecom 2008-2012/1	46
Figura IV.1: Skema e elementeve (inputeve) me shumicë për realizimin e thirrjeve telefonike....	50
Figura IV.2: Skema e strukturës kryesore dhe topologjia e rrjetit Albtelecom	51
Tabela IV.1: Tarifat e terminimit të thirrjeve në rrjetet operatorëve alternative dhe Albtelecom (2013).....	57
Figura IV.3: Ecuria e tarifave të terminimit në rrjetet fikse inkumbent në SEE 2008-2012: segment lokal.....	58
Figura IV.4: Ecuria e tarifave të terminimit në rrjetet fikse inkumbent në SEE 2008-2012:segment njëfish	58
Figura IV.5: Ecuria e tarifave të terminimit në rrjetet fikse inkumbent në SEE 2008-2012:segment dyfish	58
Tabela IV.3: Pjesët e tregut të origjinimit të thirrjeve në rrjetet fikse 2007-2012.....	61
Tabela IV.4: Trafiku kombëtar i tranzituar nga Albtelecom dhe OA (2010-2012)	63
Tabela V.1: Vlerat maksimale të tarifave të terminimit, origjinimit dhe tranzitimit në rrjetin Albtelecom 2012-2014 (propozim Konsultim Publik).....	70
Tabela V.1/1: Vlerat maksimale të tarifave të terminimit, origjinimit dhe tranzitimit në rrjetin Albtelecom 2013-2015 (Finale)	73
Tabela V.2: Vlerat maksimale të tarifave të terminimit në rrjetet e operatorëve alternative fikse 2012-2015(propozim Konsultim Publik)	74
Tabela V.3:Vlerat maksimale të tarifave të terminimit në rrjetin AMC për thirrjet drejt AMC Fiks 2012-2014(propozim Konsultim Publik)	75
Tabela V.2/1: Vlerat maksimale të tarifave të terminimit në rrjetet e operatorëve alternative fikse 2013-2015(Final)	76
Tabela V.3/1: Vlerat maksimale të tarifave të terminimit në rrjetin AMC për thirrjet drejt AMC Fiks 2013-2015 (FINAL)	77

I. PERMBLEDHJE

Ky dokument është versioni final i analizës së tregjeve me pakice të aksesit dhe thirrjeve telefonike nga vendndodhje fikse dhe tregjeve me shumice të interkoneksionit në rrjetet fikse (origjinim, terminim dhe tranzitim), dhe konkretisht:

- 1) Tregu i aksesit në rrjet publik telefonik nga vendndodhje fikse;
- 2) Tregu i thirrjeve telefonike të vlefshme për publikun nga vendndodhje fikse.
- 3) Tregu me shumice i origjinimit të thirrjeve në rrjetin telefonik publik të ofruara nga vendndodhje fikse .
- 4) Tregu me shumice i terminimit të thirrjeve për rrjete publike telefonike individuale të ofruara nga vendndodhje fikse.
- 5) Tregu me shumice i shërbimeve tranzite në rrjetet telefonike publike fikse.

Ligji nr.9918, datë 19.05.2008 "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar (në vijim Ligji 9918), në nenin 1 të tij, përcakton se qëllimi i ligjit është që nëpërmjet parimit të asnjësisë teknologjike të promovojë konkurrencë dhe infrastrukturë eficiente në komunikimet elektronike dhe të garantojë shërbimet e duhura dhe të përshtatshme në territorin e Republikës së Shqipërisë. Në Nenin 35 të tij ligji 9918 parashikon detyrimin për zhvillimin e procedurës së keshillimit me paletë e interesit për analizën e tregut duke përcaktuar edhe kohezzgjatjen minimale të periudhës së konsultimit publik prej 60 ditësh. Njëkohësisht nëni 36 përcakton se AKEP vendos, ndryshon mban ose heq detyrime për FNT pas keshillimit me paletë e interesuara.

Konsultimi publik u mbajt në përputhje me parashikimet e ligjit, për një periudhë prej 60 ditësh në periudhën 3.08.2012-3.10.2012, gjatë së cilës dokumenti ishte i publikuar në faqen e internetit të AKEP, dhe procesi i konsultimit u krye për statusin e FNT si dhe për detyrimet e propozuara për FNT.

Në përfundim të periudhës së konsultimit nga paletë e interesuara kanë dërguar komente në lidhje me këtë dokument operatorët Albtelecom, Albanian Mobile Communication, Vodafone Albania, Abcom dhe Neofone. Autoriteti i Konkurrencës ka dërguar komente me një shkresë zyrtare Nr. 1650/1 Prot., datë 15.10.2012, ku nuk vihet re ndonjë kundërshti rreth konkluzioneve të propozuara nga AKEP në dokumentin e konsultuar. Komentet mbi dokumentin si dhe qëndrimet e mbajtura rreth këtyre komenteve nga AKEP janë reflektuar në këtë dokument final të analizës në seksionin e fundit, "ANEKS 2".

Kjo analizë e tregjeve të telefonisë fikse zhvillohet në ciklin e tretë të saj dhe është në vijim të analizës së vitit 2010, procesi i cili përfundoi me publikimin e Analizës së Tregut të Telefonisë Fikse në muajin Korrik 2010 dhe Vendimin e Keshillit Drejtues të AKEP, VKD nr.1348 datë 26.07.2010, për shpalljen me FNT të operatorit Albtelecom sh.a në tregjet përkatës të mëposhtem:

- 1) Tregu me pakice i aksesit në rrjet telefonik publik nga vendndodhje fikse për klientet familjare;

- 2) Tregu me pakice i aksesit ne rrjet telefonik publik nga vendndodhje fikse per klientet jo-familjare;
- 3) Tregu me pakice per sherbimet telefonike lokale dhe/ose kombetare te disponueshme per publikun te ofruara nga vendndodhje fikse per klientet familjare.
- 4) Tregu me pakice per sherbimet telefonike nderkombetare te disponueshme per publikun te ofruara nga vendndodhje fikse per klientet familjare.
- 5) Tregu me pakice per sherbimet telefonike lokale dhe/ose kombetare te disponueshme per publikun te ofruara nga vendndodhje fikse per klientet jo-familjare.
- 6) Tregu me pakice per sherbimet telefonike nderkombetare te disponueshme per publikun te ofruara nga vendndodhje fikse per klientet jo-familjare.
- 7) Tregu me shumice i origjinimit te thirrjeve ne rrjetin telefonik publik telefonik te ofruara nga vendndodhje fikse.
- 8) Tregu me shumice i terminimit te thirrjeve per rrjete publike telefonike individuale te ofruara nga vendndodhje fikse
- 9) Tregu me shumice i sherbimeve transite kombetare ne rrjetet publike telefonike fikse.

Ne baze te parashikimeve ligjore dhe te Rregullores, analiza permban:

- perkufizimin e tregjeve perkatese;
- shqyrtimin e secilit treg perkates per te analizuar konkurrencen ne keto tregje dhe nese ka operatore me fuqi te ndjeshme ne treg, duke perdorur kriteret e percaktuara ne nenin 33 te Ligjit si dhe udhezimin e KE;
- analizimin e problemeve ne tregjet ne te cilat nuk ka konkurrence efektive apo ku ka operatore me fuqi te ndjeshme ne treg;
- detyrimet (masat rregullatore) per operatoret me fuqi te ndjeshme (FNT);

Konkluzione nga analiza e tregjeve me pakice

Ne analize e tregut ne 2010 AKEP, si edhe ne Rekomandimin e vitit 2003 te KE, vleresoi se tregjet perkatese ne telefonine fikse ishin gjashte:

- dy tregje te aksesit ne rrjet publik telefonik nga vendndodhje fikse duke dalluar per pajtimtaret familjare dhe biznes (jo-familjare);
- dy tregje te thirrjeve telefonike lokale/kombetare nga vendndodhje fikse duke dalluar per pajtimtaret familjare dhe biznes (jo-familjare);
- dy tregje te thirrjeve telefonike nderkombetare nga vendndodhje fikse duke dalluar per pajtimtaret familjare dhe biznes (jo-familjare);

AKEP duke marre ne konsiderate zhvillimet e tregut te telefonise fikse ne 2010-aktualisht dhe pritshmerite per te ardhmen, pervojen ne vendet e BE dhe te rajonit, perfshire rekomandimin e vitit 2007 te KE per tregjet perkates dhe pritshmerite per risihikimin e ketij rekomandimi, si dhe kushtet kombetare te ketyre tregjeve, vlereson se tregjet perkatese te justifikueshme per nderhyrje ex-ante dhe per t'u analizuar jane:

- *Tregu i aksesit ne rrjet publik telefonik nga vendodhje fikse (per pajtimtare familjare dhe jo –familjare);*
- *Tregu i sherbimeve publike telefonike te ofruara nga vendodhje fikse per pajtimtare familjare dhe jo –familjare).*

Ri-perkufizimi i tregjeve perkates te mesiperme permban te njejtat sherbime si ne 2010, por te segmentuara ne dy tregje dhe jo ne gjashte.

Duke u bazuar ne analizen e kryer per FNT ne keto tregje, AKEP vlereson se:

- Pjesa e tregut te Altelecom per aksesin (numri i pajtimtareve) dhe thirrjet telefonike nderkombetare ka pesuar reduktim dhe eshte ne nivele 70-74%, ndersa per llojet e tjera te thirrjeve telefonike, perfshire thirrjet ne total, pjesa e tregut eshte shume e larte mbi 90% dhe kjo ka qene e qendrueshme gjate 5 viteve te fundit. Gjithashtu edhe pjesa e tregut ne te ardhura nga sherbimet telefonike megjithese ka pasur renie eshte e larte ne nivel rreth 76%.
- Per sa i perket avantazheve te Altelecom ndaj operatoreve alternative qe vijne nga madhesia e Altelecom duket se megjithese Altelecom ka humbur pjese tregu dhe disa operatore alternative kane rritur ndjeshem numrin e abonenteve, Altelecom vazhdon te kete avantazhe ndaj operatoreve te tjere dhe keto avantazhe mund te rriten me migrimin e plote drejt NGN/NGA.
- Konkurrenca e mundshme nga rritja dhe forcimi i pozitive te operatoreve kryesore alternative ne treg si dhe nga mundesite e perdoruesve fiks per te zevendesuar thirrje fikse me thirrje nga celulare me tarifa te cilat jane ulur dhe po ulen ndjeshem, ndikon ne reduktimin e pozites dominuese te Altelecom.
- Masat rregullatore te implementuara deri me tani si Z(P)B dhe LLU dhe implementimi i portabilitetit te numrit fiks ndikojne ne rritjen e konkurrences ne treg dhe reduktimin e dominances se Altelecom ne telefonine fikse.
- Paketat standarte te Altelecom nuk kane pasur ndryshime ne 2010-2013 dhe kane akoma probleme per orientimin ne kosto te tarifes se pajtimtarit mujor per paketen standarte Familjare dhe te disa tarifave te thirrjeve drejt destinacioneve te caktuara si drejt celulare;
- Evolimi i teknologjise dhe sjelljes konsumatore ne drejtim te paketave te integruara dhe te thjeshta (me perfshirje te minutave ne pagese mujore) jane tregues se Altelecom ndeshet me presion konkurrues nga operatoret e tjere ne tarifimin e sherbimeve telefonike.

Megjithate faktoret qe ndikojne ne reduktimin e dominances se Altelecom ne tregjet me pakice te telefonise fikse, pjeset e tregut te Altelecom ne nivele rreth 75% per pajtimtare dhe te ardhura dhe mbi 90% per thirrjet telefonike jane tregues se Altelecom ka FNT ne tregjet me pakice te aksesit dhe thirrjeve telefonike.

AKEP vlereson se sipermarresi Altelecom sh.a. permbush kushtet per FNT ne tregjet perkatese:

- Tregu i aksesit ne rrjet publik telefonik nga vendodhje fikse;
- Tregu i thirrjeve telefonike te vlefshme per publikun nga vendodhje fikse.

Konkluzione nga Analiza e tregjeve me shumice

AKEP vlereson se tregjet perkates te interkoneksionit ne rrjetet fikse jane:

- Tregu i terminimit te thirrjeve zanore ne rrjetin Altelecom, sherbim i ofruar nga sipermarresi Altelecom sh.a;
- Tregu i terminimit te thirrjeve zanore ne rrjetin publik fikse te operatorit alternativ X, sherbim i ofruar nga sipermarresi X¹;
- Tregu i terminimit te thirrjeve zanore ne rrjetin publik AMC drejt pajtimareve AMC Fiks, sherbim i ofruar nga sipermarresi AMC sh.a.;
- Tregu i origjinimit te thirrjeve zanore ne rrjetet fikse, sherbim i ofruar nga sipermarresit e rrjeteve publike fikse;
- Tregu i tranzitimit te thirrjeve zanore ne rrjetet fikse, sherbim i ofruar nga sipermarresit e rrjeteve publike fikse;

Dimensioni gjeografik i tregjeve te terminimit, origjinimit dhe tranzitimit te thirrjeve zanore eshte zona operimit (mbulimit me rrjet) te operatorit perkates ofruar te sherbimit (territori i Republikes se Shqiperise per Altelecom dhe AMC).

Perfundime per tregjet e terminimit te thirrjeve:

AKEP vlereson se Altelecom dhe te gjithe operatoret alternative, perfshire AMC jane operatore me FNT ne terminimin e thirrjeve ne rrjetet e tyre:

- *Altelecom sh.a. permbush kushtet per t'u shpallur sipermarres me FNT ne tregun e terminimit te thirrjeve drejt pajtimareve te rrjetit fikse Altelecom;*
- *Sipermarresi X permbush kushtet per t'u shpallur sipermarres me FNT ne tregun e terminimit te thirrjeve drejt pajtimareve te rrjetit fikse alternativ X;*
- *Sipermarresi AMC sh.a. permbush kushtet per t'u shpallur sipermarres me FNT ne tregun e terminimit te thirrjeve drejt numrave gjeografike ne rrjetin AMC (pajtimareve te AMC Fiks)²;*

Lista me operatoret alternative te percaktuar me FNT per terminimin ne rrjetet e tyre eshte dhene ne Aneks 1 te ketij dokumenti final te analizes. Lista eshte hartuar duke u bazuar ne te dhenat e Rregjistrimit te Autorizimit te pergjithshem deri me 30.07.2013 si dhe te dhenat e rregjistrimit te AI per sipermarresit e pajisur me numeracion gjeografik Fiks deri me 30.07.2013.

Faktoret kryesore qe ndikojne ne propozimin per FNT te operatoreve alternative, jane:

- Pjesa e tregut: Secili nga Operatoret Alternative ka 100 % pjese tregu ne sherbimin e terminimit te thirrjeve zanore ne rrjetin e tij;
- Diskriminimi ne tarifa: Aplikimi ne 2010-aktualisht i tarifave te ndryshme te terminimit ne rrjetet e operatoreve alternative ne varesi te operatoreve origjinues kombetare si dhe mbajtja e tarifave te terminimit mbi nivelin e tarifave te Altelecom per nje kohe te gjate;

¹Lista e operatoreve alternative te percaktuar me FNT eshte dhene ne Aneks 1.

² Ne dokument ne shume vende per lehtësi tregu i terminimit te thirrjeve drejt numrave gjeografike fikse te AMC referohet si drejt pajtimareve AMC Fiks.

Perfundime per tregun e origjinimit te thirrjeve:

Pas vleresimit te pjeses se tregut per Albtelecom, OA dhe AMC Fiks, rezulton se niveli i larte i pjeseve te tregut mbi 90% dhe qendrushmeria ne vite e ketyre pjeseve te tregut, tregon pozicion dominues te Albtelecom ne kete treg.

Nga vleresimi i faktoreve te fuqise kundervepruese te bleresve, si dhe vleresimeve mbi mundesite e zhvillimit te konkurrences ne kete treg, prezences se barrierave te hyrjes ne kete treg etj, AKEP gjykon se

- *Albtelecom sh.a. permbush kushtet per t'u shpallur sipermarres me FNT ne tregun perkates te origjinimit te thirrjeve nga vendndodhje fikse.*

Perfundime per tregun e tranzitit kombetar

Pas vleresimit te pjeses se tregut per Albtelecom dhe OA, rezulton megjithese Albtelecom ka humbur pjese tregu ne periudhen 2010-2012, niveli i larte prej 62% i pjeses se tregut te Albtelecom ne 2012, si dhe avantazhet e Albtelecom per madhesine dhe mbulimin me rrjet fikse ne raport me operatoret e tjere fikse, tregon pozicion dominues te Albtelecom ne kete treg. Nga vleresimi i faktoreve te fuqise kundervepruese te bleresve te ketij sherbimi, si dhe vleresimeve mbi mundesite e zhvillimit te konkurrences ne kete treg, prezences se barrierave te hyrjes ne kete treg etj, AKEP gjykon se :

- *Albtelecom sh.a. permbush kushtet per t'u shpallur sipermarres me FNT ne tregun perkates te tranzitimit te thirrjeve kombetare.*

Masat rregulluese per FNT ne tregjet me shumice te Interkoneksionit

AKEP gjykon se problemet e tregjeve me shumice nga FNT e Albtelecom ruajne te njejten natyre me problemet e identifikuara ne analize 2010, keshtu qe ndaj operatorit me FNT Albtelecom propozohet qe detyrimet aktuale te qendrojne dhe te vazhdohet implementimi i tyre dhe konkretisht:

1. Detyrimi i Mosdiskriminimit (neni 39)
2. Detyrimi i transparencës (Neni 40)
3. Detyrimi për ndarjen e llogarive (Neni 41)
4. Detyrimi për akses dhe interkoneksion dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit (Neni 42)
5. Detyrimi per zgjedhjen e bartesit dhe parazgjedhjen e bartesit (neni 43)
6. Detyrimi për kontroll të tarifave dhe sistemin e mbajtjes së llogarive (Neni 45)

Detyrimet e mesiperme jane per te tre tregjet me shumice (terminim, origjinim dhe tranzitim), pervec detyrimit 5 (zgjedhje/parazgjedhje bartesi) qe vendoset per FNT ne origjinimin e thirrjeve.

Kalimi ne rrjetin NGN/NGA nder te tjera con ne menyre me te perqendruar te komutimit e trafikut si per trafikun e interkoneksionit edhe per trafikun e abonenteve te Albtelecom si dhe me e rendesishmja ne eliminimin e hierarkise se centraleve. Nje sere centralesh lokale/RSU eliminohen dhe komutimi i trafikut nuk ndjek rrjedhen e komutimit me TDM por perqendrohet ne nje apo dy pika ne rrjet dhe shperndahet tek abonentet duke shfrytezuar

rrjetin NGN dhe transportimin ne nivel IP si dhe transportimi i te dhenave. Ky ndryshim i menyres se interkonketimit me rrjetin NGN te Altelecom eshte nje proces shume i rendesishem dhe do te duhet te diskutohet edhe me operatoret e tjere, pasi ai bart nje sere implikimesh ne menyren e interkonektimit, pikat e interkonektimit, menyren e pageses, cilesine e sherbimit, standartet e perdorura etj, dhe sic shprehet edhe vet Altelecom kjo do te kerkoje nje periudhe tranzitore te bashkekzistences se te rrjetit NGN me interkonektimin ne nivel TDM.

Per te vlersuar rregullimin e tarifave me shumice te interkoneksionit te Altelecom ne periudhat e mevonshme, AKEP vlereson se eshte e rendesishme te merren ne konsiderate zhvillimet e ndodhura ne periudhen 2010-aktualisht si dhe pritshmerite per zhvillime te ardhshme. Nder keto zhvillime mund te permendim procesin e migrimit te rrjetit te Altelecom nga PSTN/TDM drejt NGN/NGA, tendencen e struktures se tarifave me pakice te telefonise fikse, procesin e konsultimit publik te AKEP per rishikimin e planit te numeracionit gjeografik, si dhe njekohesisht komentet dhe kerkesat e Altelecom te lidhura me keto procese si dhe per propozimin e AKEP te dhene ne konsultim publik te dokumentit te Analizes se tregut fiks.

Nga analiza e ketyre faktoreve vihet se shume prej tyre bartin argumenta pro reduktimit te numrit te segmenteve te terminimit dhe te pikave te interkonektimit. Duke marre ne konsiderate gjithë faktoret e mesiper, AKEP gjykon se:

- Pavaresisht migrimit te plote ne rrjetin NGN te Altelecom, per nje periudhe tranzitore deri ne kalimin e plote ne interkonektiom ne nivel IP, do te kete bashkekzistence te dy rrjeteve PSTN/TDM dhe NGN/NGA dhe sic eshte theksuar me pare ne kete dokument ky eshte nje konstatim i Altelecom dhe praktike edhe ne vende te tjera.
- Ndryshimet qe duhet te kryhen ne interkoneksion per kalimin e plote te tij ne nivel IP kane nje sere implikimesh qe do te duhet te diskutohen edhe me operatoret e tjere ne treg, te tilla si menyra e interkonektimit (TDM-IP; IP-IP etj), pikat e interkonektimit, menyren e pageses (CPP/RPP/Bill and Keep), cilesine e sherbimit, standartet e perdorura etj.
- Reduktimi i segmenteve te terminimit/origjinimit nga 3 ne 2 si dhe tranzitimit nga 2 ne 1 mund te kryhen duke filluar nga 1 Janar 2014 nderkohe kalimi ne 1 segment terminimini/origjinimi do te diskutohet edhe me lojtaret e tregut dhe ne kuader te ndryshimeve ne interkoneksion per kalimin ne nivel IP.
- Vlerat e tarifave te interkoneksionit te Altelecom te jene sipas vlerave te propozuara ne konsultim publik, duke eliminuar fazen e trete ku arrihej me nje segment si dhe duke zhvendour ne kohe Fazen I dhe II. Faza I do te filloje me 1.01.2014.

Bazuar ne problematiken e evidentuar me tarifat e aplikuar nga operatoret alternative, kushtet e tregut te telefonise fikse si dhe nga pervoja ne vendet e rajonit dhe te BE, AKEP gjykon qe masat rregulluese ndaj operatoreve Alternative per FNT ne terminimin e thirrjeve ne rrjetet e tyre te jene:

1. Detyrimi i Mosdiskriminimit (neni 39)
2. Detyrimi i transparencës (Neni 40)
3. Detyrimi për akses dhe interkoneksion dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit (Neni 42)
4. Detyrimi per kontroll tarife

Detyrimet e propozuara nuk perfshijne publikim te RIO-s, si dhe nje sere detyrimesh te tjera te vendosura ndaj Albtelecom. Detyrimi i kontrollit te tarifes perfshin rregullimin nga AKEP te tarifave te terminimit te operatoreve alternative.

Duke qene se tarifat e terminimit ne rrjetet e operatoreve alternative jane te lidhuara me ato te Albtelecom dhe ne vijim te ndryshimeve te kryera ne tarifat e terminimit te Albtelecom nga Konsultimi public jane reflektuar edhe ne percaktimin e tarifave te terminimit per operatoret alternative dhe per AMC per AMC Fiks.

AKEP vlereson se detyrimet per FNT per AMC (per terminimin ne AMC fiks) te jene te njejta me ato te operatoreve alternative fiks.

Ndryshimet e mesipeme synojne reduktim te segmenteve te terminimit/origjinimit/tranzitimit dhe vlerave te tarifave te terminimit/origjinimit/tranzitimit per Albtelecom dhe reduktim te segmenteve dhe tarifave te terminimit te operatoreve te tjere fiks duke syuar edhe reduktimin e asimetrise se tarifave te ketyre operatoreve alternative e ato te Albtelecom. Nderkohe per konvergjencen e tarifave te terminimit te te gjitha operatoreve te rrjeteve fikse, AKEP do te marre vendime ne kohen e kalimit me nje segment te tyre.

Ndryshimet e mesiperme pritet te kene efekt pozitiv ne treg pasi ato reduktojne nevojën per interkonektim ne shume pika interkoneksioni (bashkimi i segmentit lokal dhe njefish) dhe njekohesisht zvogelojne shpenzimet e operatoreve per pagesat e tarifave te interkoneksionit (reduktimi i tarifave), dhe keta faktore do te cojne ne fleksibilitet me te madh te operatoreve ne tarifim dhe tarifa me te uleta per perdoruesin fundor.

Masat rregulluese per FNT te Albtelecom ne tregjet me pakice

Ne percaktimin e masave rregulluese per FNT e ndjeshme te Albtelecom ne tregjet me pakice, AKEP fillimisht ka evidentuar disa karakteristika te tregut shqiptar te telefonise fikse ne ndryshim nga ato te vendeve te tjera te rajonit dhe BE si dhe disa prej ndryshimeve kryesore qe kane ndodhur ne treg ne periudhen 2010-2013 me impakt ne tregjet me pakice ne telefonine fikse, te tilla si:

- kushtet e tregut te telefonise fikse ne Shqiperi jane shume te ndryshme nga ato ne vende te tjera, ne lidhje me penetrimin e telefonise fikse (12% krahasuar me 40% ne BE dhe rajon), numer i madh operatorësh alternative (rreth 80), trafiku i origjinuar nga operatorët celulare eshte shume me i madh se ai nga rrjetet fikse (diferenca te medha Shqiperi-BE).
- praktika në vendet e BE-se, ku shumica e këtyre vendeve kanë hequr detyrimet e rregullimit të tarifave në tregjet me pakicë të telefonisë fikse:
- Albtelecom ka hedhur ne treg paketa te reja tarimore me zgjedhje dhe perzgjedhja e tyre nga nje numer i madh pajtimtaresh te Albtelecom tregon se ato jane me atraktive per perdoruesit se paketat standard;
- perfshirja ne paketat e sherbimeve telefonike e sherbimit te aksesit ne Internet nga Albtelecom dhe nga operatore alternative, dhe perzgjedhja e tyre nga nje numer i madh pajtimtaresh tregon se konkurrenca midis operatoreve te telefonise fikse tashme nuk eshte

vetem ne drejtim te sherbimeve telefonike por edhe me sherbimin e Internetit dhe ky i fundit konsiderohet te jete shtytesi kryesor per zhvillimin e telefonise/rrjeteve fikse.

- fillimi i implementimit të masave rregullatore në nivelin me shumicë (C(P)S dhe LLU), portabiliteti i numrit fiks rrisin presionin konkurrues mbi Albtelcom per thirrjet telefonike;

AKEP, bazuar ne analizen e kryer, si dhe te masave rregullatore te vendosura per FNT ne tregjet me shumice, vlereson se eshte e arsyeshme që Albtelcom te kete detyrime ne tregun me pakice si: transparenca dhe mosdiskriminimi, nderkohe qe mos te kete detyrim per rregullimin e tarifave. Detyrimet e Albtelcom per FNT ne dy tregjet me pakice te sherbimeve telefonike do te perfshijne:

- detyrimin per transparence.

Ky detyrim perfshin detyrimin e Albtelcom per publikim dhe njoftimin ne AKEP per paketat/ofertat tarifore te reja dhe cdo ndryshim ne to:

- 1 muaj para hyrjes ne fuqi te ndryshimeve ne paketen tarifore aktuale standard “Familjare”;

- Detyrimi per mos-diskriminim

Sipas ketij detyrimi ndalohet diskriminimi i pajustificuar midis abonenteve te ndryshem kur kushtet e sherbimit jane te njejta.

Nderkohe ne lidhje me heqjen e detyrimit te kontrollit te tarifave, bazuar ne nenin 34 te ligjit 9918, heqja e ketij detyrimi do te behet efektive me 1.01.2014, rreth 6 muaj pas marrjes se vendimit per FNT dhe masat rregulluese per Albtelcom sipas konkluzionve te kesaj analize tregu, si dhe ne te njejten date me ndryshimet e tarifave me shumice ne rrjetin Albtelcom.

Njekohesisht ne kete mase rregullatore, Albtelcom ndalohet te kryeje ofrim te paketave te pajustificuara (unjustified unbundling) me sherbime te ndryshme, qe nenkupton Albtelcom duhet te lejoje pajtimtaret (aktuale apo te rinj) te blejne sherbime te vecanta. Pra paketat me sherbime te ndryshme (bundles) duhet te jene opsionale dhe jo detyruese apo qe krahas paketave (bundle), Albtelcom duhet te ofroje sherbime telefonike te vecanta dhe te mos kushtezoje sherbimet telefonike me blerje te sherbimeve te tjera (ne menyre te detyruar per pajtimtarin).

- Ofrimi i Z(P)B per pajtimtarin

Ky detyrim eshte vendosur dhe ne nivel me shumice per Albtelcom qe te ofroje operatoreve te tjere sherbime te Z(P)B dhe nenkupton se pari qe pajtimtaret te kene te drejte te blejne thirrje telefonike duke perdorur Z(P)B. Ofrimi i ketij sherbimi per pajtimtaret kryhet sipas percaktimve te Rregullores dhe Udhezimeve per Z(P)B.

Paralelisht me heqjen e detyrimit te rregullimit te tarifave AKEP do te vazhdoje monitorimin e ecurise se tarifave te paketave standart dhe te tjera. Sic eshte theksuar me pare ne kete

proces do te kete rendesi trajtimi i pajtimtareve te Albtelcom me perdorim/te ardhura te uleta ne menyre qe ata te mos demtohen apo te mos zgjedhin heqjen dore nga sherbimi i telefonise fikse per shkak te rritjeve te pajustificuara te tarifave.

De-rregullimi i tarifave te Albtelcom synon te krijoje fleksibilitet per Albtelcom ne tarifimin e sherbimeve per plotesim me te mire te kerkesave te konsumatoreve dhe nxitje per investime ne linja te reja telefonike pra dhe rritje te penetrimit te telefonise fikse.

Kjo mase dhe masat e tjera rregulluese ne nivel me shumice jane ne linje dhe me rezoluten e Kuvendit per AKEP , ne te cilat Kuvendi midis te tjerave ka kerkuar qe AKEP te angazhohet ne zbatimin e politikave nxitese per nje penetrim me te madh te telefonise fikse dhe te nxise konkurrencen ne kete sektor, duke krijuar nje mjedis terheqes per rritjen e investimeve ne linjat fundore te abonenteve.


II. HYRJE

II.1. Panorame e sektorit të telefonisë fikse

Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse në fund të vitit 2011, ishte rreth 339 mijë, nivel i cili përbënte një rritje me rreth 7000 pajtimtare apo 2.2% në krahasim me rreth 332 mijë në fund të vitit 2010. Nderkohe numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse në fund të vitit 2012 pati rënie me rreth 27000 apo 8% në krahasim me vitin 2011. Rënia ka ardhur për shkak të reduktimit të numrit të pajtimtarëve të Albtelcom me rreth 29 mijë ndërsa numri i pajtimtarëve të operatoreve alternative nuk ka pasur ndryshime të ndjeshme. Tendanca në ulje të numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse duket se po ndjek atë të vendeve të BE, megjithatë norma e penetrimit të telefonisë fikse (11%) në Shqipëri vazhdon të jetë e ulët krahasuar me vendet e BE (me një mesatare prej rreth 35%) dhe vendet e rajonit.

Penetrimi³ i telefonisë fikse në fund të vitit 2012 është afërsisht 11 %, krahasuar me 12% që ishte në fund të vitit 2011.

Figura II.1 Ecuria e numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse 2000-2012



Megjithë rënien e numrit të pajtimtarëve, Albtelcom perseri zotëron rreth 74 % të këtij tregu me rreth 230 mijë pajtimtarë ndërsa operatorët alternativë rreth 26 % me rreth 81 mijë pajtimtarë.

Sektori i telefonisë fikse në Shqipëri karakterizohet nga një numër i lartë i sipermarresve të regjistruar për ofrim rrjete publik telefonik fikse. Në fund të vitit 2012 numri i sipermarresve të autorizuar për rrjete publike telefonike fikse ishte 73 në krahasim me 79 në fund të 2011.

³Numri i pajtimtarëve për 100 banorë. Numri i banorëve në Shqipëri i referohet të dhënave të Instat për numrin e popullsisë (për vitin 2011 e në vijim sipas Census 2011).

Ky numer eshte shume me i larte se ne vendet e rajonit, sic mund te vihet re nga te dhenat ne tabelen e meposhteme.

Country	Public fixed telephony network operators	
	Authorised operators	Operators active in the market
Croatia	17	12
Iceland	2	2
FYR Macedonia	11	8
Montenegro	2	2
Serbia	5	3
Turkey	1	1
Albania	82	76
Bosnia & Herzegovina	16	15
Kosovo*	3	2

Burimi: Cullen International Report (Prill 2013)

Nje pjese e madhe e ketyre operatoreve jane te vegjel dhe me presence shume te kufizuar rrjeti. Nga te dhenat e vitit 2012, vihet re se operatoret Abcom, ASC, Nisatel, Primo dhe AMC Fiks jane pese operatoret alternative me te medhenj qe zoterojne rreth 67 % te numrit te pajtimtareve te telefonise fikse te operatoreve alternative, apo e thene ndryshe zene rreth 17 % te totalit te pajtimtareve te telefonise fikse. Abcom dhe Nisatel rezultojne te jene dy prej operatoreve te cilet kane pasur rritje te numrit te pajtimtareve ne 2012 krahasuar me te dhenat e fund vitit 2011, respektivisht me 22 % dhe 11%.

Ecuria e numrit te pajtimtareve te telefonise fikse ne periudhen 2000-2012 paraqitet me rritje te ndjeshme pasi numri i tyre eshte me shume se dyfishuar. Tendenca ne rritje te vazhdueshme ka vazhduar deri ne 2009, ndersa ne 2009-2012 ka pasur tendenca rritje dhe renie ne intervalin 312-340 mije pajtimtare. Keto tendenca rritje apo qendrueshmerie te numrit te pajtimtareve jane te kunderta me tendencen ne vendet e BE ku numri i linjave fikse ka qene i qendrueshem ose ne renie. Megjithate norma e penetrimit te telefonise fikse per popullsine (numri i linjave per 100 banore) ne Shqiperi ne intervalin 10-12% eshte ne nivel shume me te ulet se ai ne vendet te BE dhe rajonit me nivel mesatar penetrimi prej 35-40%. Pra numri i linjave fikse ne Shqiperi eshte dyfishuar ne periudhen 2000-2012, por numri i tyre ne raport me popullsine apo numrin e familjeve eshte ende shume i ulet ne raport me vendet e BE dhe te rajonit.

Njekohesisht rritja e numrit te linjave fikse eshte shume me e ulet se rritja e numrit te perdoruesve celulare. Ne fund te vitit 2012 penetrimi i telefonise celulare arriti rreth 198% per karta SIM aktive dhe 125% per perdorues aktive. Ecuria e numrit te perdoruesve celulare dhe fiks si dhe normat e penetrimit te dy sherbimeve jane dhene ne figurat e meposhteme.

Figura II.2 Ecuria e numrit te perdoruesve të telefonisë celulare dhe fikse 2000-2012






Figura II.3. Ecuria e penetrimit të telefonisë celulare dhe fikse 2003-2012



Normat e penetrimit te sherbimeve te telefonise fikse dhe te aksesit apo linjave broadband jane shume me te uleta se ne vendet e BE, megjithte rritjen ne aksesin broadband, ndersa per telefonine celulare norma e penetrimit eshte mbi nivelin mesatar te vendeve te BE. Grafiku i meposhtem jep ne menyre krahasimore normat e penetrimit ne Shqiperi te sherbimeve te telefonise fikse, celulare dhe aksesit broadband me vendet e BE.

Figura II.4. Krahasimi i normave te penetrimit: Shqiperi 2012 vs mesatare e BE- 27 (2010/11)




Të ardhurat totale të sipërmarrësve ne tregun e komunikimeve elektronike për vitin 2012 ishin rreth 55377 milion lek te cilat perbejne nje rritje prej rreth 6.65 % ne krahasim me vitin 2011 kur te ardhurat ishin 51922 milion LEK. Rritja e te ardhurave te sektorit ka ardhur kryesisht nga rritja e te ardhurave te operatoreve celulare.

Peshen kryesore te ketyre te ardhurave e zene ato qe vijne nga rrjetet celulare, te cilat per 2012 jane 42.01 miliard leke, kundrejt 39.2 miliard leke qe ishin ne vitin 2011, pra sic vihet re ne sektorin celular ka nje rritje te te ardhurave per vitin 2012 rreth 7.2 %, krahasuar me vitin 2011.

Edhe ne te ardhurat qe vijne nga rrjete fikse (Albtelecom + OA) per vitin 2012, vihet re nje rritje, krahasuar me nje vit me pare 2011, nga 12.8 miliard leke ne rreth 13.4 miliard lek, apo e thene ndryshe ka nje rritje prej rreth 4.7%. Brenda vete sektorit te telefonise fikse vihet re nje rritje prej rreth 12 % ne te ardhurat e Albtelecom, krahasuar me 2011, por ka nje renie ne te ardhurat e 2012 per OA, renia e cila eshte afersisht prej rreth 15 % krahasuar me te ardhurat e vitit 2011.


Sipermarresit alternative nder me kryesoret sipas te ardhurave mund te vleresohen operatorët ABcom, ASC, Primo, Abissnet, Nisatel, IT-Tirana, ATU, etj, të cilët së bashku zene rreth 5 % të të ardhurave të sektorit, apo mbi 80% të peshes totale te te ardhurave te operatorëve alternative.

Figura II.5. Të ardhurat totale të operatorëve të komunikimeve Elektronike (2012)



Grafiku i mëposhtëm paraqet ecurinë e të ardhurave të Albtelcom, operatorëve alternativë dhe operatorëve celularë në periudhën 2008-2012.

Figura II.6. Të ardhurat totale të operatorëve të komunikimeve Elektronike (2008-2012)



II.2 Percaktimi i sipermarresve me Fuqi te Ndjeshme ne Treg

I. Objektivat e Ligjit dhe kuadri rregullator

Ligji 9918, ne nenin 1 te tij, percakton se qellimi i ligjit eshte qe nepermjet parimit te asnjanesise teknologjike te promovojë konkurrencën dhe infrastrukturë efçente në komunikimet elektronike dhe të garantojë shërbimet e duhura dhe të përshtatshme në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 7 i Ligjit 9918, Objektivat Rregullatore, percakton midis te tjerave:

AKEP-i nxit konkurrencën efçente për sigurimin e rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike, facilitetet shoqëruese dhe shërbimet e tjera:

a) për t'u krijuar mundësinë çdo kategorie përdoruesish të shërbimeve të komunikimeve elektronike, përfshirë edhe përdoruesit me aftësi të kufizuara, të kenë përfitime maksimale nga aksesit në shërbimet e komunikimeve elektronike, në kuptimin e zgjedhjes së çmimit dhe cilësisë;

b) për të mbrojtur interesat e përdoruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike, për të mbrojtur të dhënat personale dhe privatësinë e përdoruesve;

c) për të siguruar konkurrencën e lirë dhe efektive në sektorin e komunikimeve elektronike;

d) për të siguruar integritetin dhe sigurinë e rrjeteve të komunikimeve elektronike publike;

dh) për të nxitur investimet efçente në infrastrukturën e komunikimeve elektronike dhe zhvillimet e reja teknologjike për një cilësi të lartë të produkteve të tyre;

ë) për të siguruar mosdiskriminimin dhe barazinë në trajtimin e ofruesve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike.

Kapitulli VI, Rregullimi i Konkurrencës, permban percaktimet per rregullimin e konkurrencës ne tregun e komunikimeve elektronike, dhe perfshin ndermjet te tjerave detyrimin e AKEP per kryerjen e analizes se tregut per vleresimin e konkurrencës efektive dhe percaktimin e sipermarresve me fuqi te ndjeshme ne treg. Kreu VI, permban gjithashtu kriteret e perdorura nga AKEP per vleresimin e fuqise se ndjeshme ne treg, detyrimet/masat rregulluese ne rast te gjetjes se FNT.

Pika 4 e nenit 31, parashikon detyrimin per nje rregullore per analizen e tregjeve dhe percaktimin e FNT. AKEP me vendimin Nr.747, date 17.07.2009, ka miratuar Rregulloren per Analizen e Tregjeve (ne vijim referuara si Rregullorja). Rregullorja percakton midis te tjerave nje liste prej 18 tregje per tu analizuar nga AKEP per FNT, si dhe detyrimin per te kryer analizen e tre kriterëve per tregjet qe nuk jane pjese e rekomandimit Rekomandimit te Komisionit European, datë 11 Shkurt 2003. AKEP ka zhvilluar nje proces konsultimi publik per amendimin e kesaj rregulloreje, duke propozuar marrjen ne konsiderate te rekomandimit te vitit 2007 te KE per tregjet perkatese. AKEP eshte ne proces vendim-marrje per miratimin e mandimeve te kesaj rregulloreje pas komenteve te marra ne konsultim publik.

Ligji 9918 eshte ne linje me direktivat e KE te vitit 2003 dhe amendimet e tyre ne 2009 dhe metodologjia e analizes se tregjeve e percaktuar ne Ligj dhe ne Rregullore, percakton se AKEP duhet te marre ne konsiderate rekomandimet e Komisionit European si dhe BEREC.

Disa nga Rekomandimet dhe udhezimet e KE-se te marra ne konsiderate nga AKEP jane si më poshtë:

- Udhëzuesi e komisionit për analizën e tregut dhe vlerësimin e FNT (2002/C 165/03) sipas kuadrit rregullator për komunikimet elektronike, rrjetet dhe shërbimet të komunikimit elektronik (ne vijim referuar si Udhezimi i KE)

- Rekomandimi i Komisionit, datë 11 shkurt 2003, për produktet dhe shërbimet përkatëse të tregut brenda sektorit të komunikimeve elektronike të rregullara *ex ante* në përputhje me Direktivën 2002/21/EC të Parlamentit Europian dhe të Këshillit në një kuadër të përgjithshëm rregullator për rrjetet dhe shërbimet e komunikimit elektronik (2003/311/EC, OJ L 114, 8.5.2003, p. 45)
- Rekomandimi i Komisionit, datë 17 dhjetor 2007 për produktet dhe shërbimet përkatëse brenda sektorit të komunikimeve elektronike të rregulluara *ex ante* në përputhje me Direktivën 2002/21/EC të Parlamentit Europian dhe të Këshillit në një kuadër të përgjithshëm rregullator për rrjetet dhe shërbimet e komunikimit elektronik (2007/879/EC, OJ L 344, 28.12.2007, p. 65)

II. Procesi i Konsultimit

Ligji 9918 parashikon në Nenin 35 të tij, procedurën e keshillimit me palet e interesit për analizen e tregut duke vendosur si afat, periudhën kohore prej 60 ditësh. Njekohesisht nëni 36 përcakton se AKEP vendos, ndryshon, mban ose heq detyrime për FNT pas keshillimit me palet e interesuara.

Në bazë të përcaktimeve të Ligjit 9918 dhe praktikës së AKEP me analizat e tregjeve, konsultimi publik u zhvillua nga 3.08.2012 deri më 03.10.2012, dhe procesi i konsultimit u krye për statusin e FNT si dhe për detyrimet e propozuara për FNT.

Në fund të procesit të konsultimit, në AKEP erdhën komentet e paleve të interesuara si Albtelecom, AMC, Vodafone, Abcom dhe Neofone, për perfundimet në lidhje me FNT dhe detyrimet e propozuara nga AKEP për FNT në këtë dokument konsultimi publik.

Komentet e paleve të interesuara si dhe qëndrimi i AKEP në lidhje me këto komente publikohen nga AKEP, së bashku me këtë dokument final të analizës së tregut, në Aneks 2 të këtij dokumenti.

III. Bashkëpunimi me Autoritetin e Konkurrencës

Sipas Nenit 38 të Ligjit 9918 AKEP duhet të bashkëpunojë me Autoritetin e Konkurrencës. Gjithashtu AKEP dhe Autoriteti i Konkurrencës kanë nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi me datë 29.08.2007, ku midis të tjerave “Neni 6”, parashikon bashkëpunimin midis dy autoriteteve për përcaktimin e tregut, përcaktimin e dominancës / përcaktimi i FNT.

AK ka shprehur opinionin e vet në lidhje me perfundimet dhe propozimet e dokumentit “Analizë e Tregut të Telefonisë Fikse: Tregjet me pakice të aksesit dhe thirrjeve telefonike nga vendndodhje fikse dhe tregjet me shumice të terminimit, origjinimit dhe tranzitimit në rrjetet fikse: Konsultim Publik”, nepermjet shkresës së dërguar më 12.10.2012. AK mirepret zhvillimet e evidentuara në Analizë dhe treguesit e një tregu gjithnjë e më konkurrues. AK kërkon që për të nxitur dhe mbrojtur konkurrencën efektive në tregun e telefonisë fikse, tarifën e terminimit për operatorin me FNT të jenë objekt rregullimi nga AKEP si dhe vlerëson se është e nevojshme të përsosin instrumentat detyrues për realizimin e detyrimit të ndarjes së llogarive për shërbimet e ndryshme që ofrojnë operatorët me FNT, apo të vendosen afate kohore për zbatimin e tyre.

AKEP vlerëson kontributin dhe komentet e AK dhe i ka marrë ato në konsideratë edhe në këtë dokument final të analizës si dhe në detyrimet për FNT.

IV. Struktura e Dokumentit

Ky dokument permban analizen e tregjeve me pakice te aksesit dhe thirrjeve telefonike nga vendndodhje fikse dhe tregjeve me shumice te origjinimit, terminimit dhe tranzitimit ne rrjete fikse:

- 1) **Tregu i aksesit nje rrjet publik telefonik nga vendodhje fikse;**
- 2) **Tregu i thirrjeve telefonike te vlefshme per publikun nga vendodhje fikse.**
- 3) **Tregu me shumice i origjinimit te thirrjeve ne rrjetin telefonik publik te ofruara nga vendndodhje fikse .**
- 4) **Tregu me shumice i terminimit te thirrjeve per rrjete publike telefonike individuale te ofruara nga vendndodhje fikse.**
- 5) **Tregu me shumice i sherbimeve transite ne rrjetet telefonike publike fikse.**

Kjo analize e tregjeve te telefonise fikse eshte ne vijim te analizes se vitit 2010, proces i cili perfundoi me publikimin e Analizes se Tregut te Telefonise Fikse "Dokumenti Perfundimtar ne Korrik 2010 (ne vijim referuar Analize 2010), dhe Vendimin e Keshillit Drejtues te AKEP VKD nr.1348, date 26.07.2010, per shpalljen me FNT te Albtelecom ne tregjet perkates:

- te aksesit per dy kategorite e pajtimtareve (familjare dhe jo-familjare);
- te tregjeve te thirrjeve per sherbimet me pakice lokale, kombetare dhe nderkombetare per pajtimtaret (familjare dhe jo-familjare);
- te tregut me pakice per sherbimet telefonike nderkombetare te disponueshme per publikun te ofruara nga vendndodhje fikse, per klientet familjare;
- per tregjet e interkoneksionit (terminim; origjinim dhe tranzit kombetar);

Duke qene se kjo analize per telefonine fikse eshte ne ciklin e trete te saj, per efekt mosperseritje te argumenteve te njejte, lexuesit i jepen referenca me analizat e meparshme te tregut te telefonise fikse. Ky version final i Analizes eshte perditesuar me te dhenat me te fundit te tregut per Shqiperine, vendet e rajonit dhe BE.

Kapitulli III permban analizen e tregjeve me pakice, kapitulli IV analizon tregjet me shumice, ndersa masat rregullatore per FNT ne tregjet me shumice dhe me pakice trajtohen ne kapitullin V. Dokumenti permban dhe dy Aneks. Ne Aneks 1 jept lista e operatoreve alternative te percaktuar me FNT per terminimin e thirrjeve ne rrjetet e tyre fikse dhe ne Aneks 2 jane dhene komentet e paleve te interesuara per dokumentin e nxjerre ne konsultim publik dhe qendrimi i AKEP per komentet.

V. Perkufizimi i tregut perkates

Ne kuader te analizave te kryera nga nje rregullator per qellime te analizes se konkurrences efektive dhe percaktimit te sipermarresit/sipermarresve me FNT, analiza e nje tregu perkates fillon me shqyrtimin e produkteve dhe sherbimeve qe konsiderohen te jene pjese e te njejtit treg.

Ne Analize 2007, 2009-2010 ERT (AKEP) ka perdorur perkufizimin e tregut perkates te dhene ne Rregullore 2005, perkufizim i marre nga Ligji per Mbrojtjen e Konkurrences:

***Treg perkates-** jane produktet qe vleresohen si te zevendesueshme nga konsumatoret ose klientet e tyre, per sa u perket karakteristikave, cmimit dhe funksionit te tyre dhe qe ofrohen*

ose kerkohen nga ndermarrjet ne nje zone gjeografike me kushte te njejta konkurrence, zone kjo e cila veçohet nga zonat e tjera kufizuese.

Ky perkufizim i Ligjit nr.9121, date 28.7.2003 “Per Mbrojtjen e Konkurrences” i ndryshuar, neni 3, pika 7, eshte i ngjashem me perkufizimin e dhene ne Udhezimin e KE, pika 44⁴, udhezim i perdorur nga ERT ne Analize 2007. Per kete arsye si dhe duke gene se udhezimi i KE, eshte pjese e dokumentave te KE te referuara ne Rregullore per analizen e tregut te miratuar me VKD nr.747, date 17.07.2009, AKEP ne kete Analize do te perdore te njejten metodologji per percaktimin e produkteve/sherbimeve qe jane pjese e te njejtit treg perkates, si dhe ne Analize 2007, sic eshte shtjelluar dhe ne paragrafet ne vijim.

Perkufizimi i tregut per nje produkt/sherbim merr parasysh efektin e zevendesueshmerise se produktit/sherbimit (ne anen e kerkeses dhe ofertes), si edhe dimensionin gjeografik. Nje instrument ndihmes qe perdoret per identifikimin e tregjeve eshte parimi i monopolistit hipotetik.

Parimi i monopolistit hipotetik

Nje produkt konsiderohet te perbeje nje treg me vete nese “monopolisti” (hipotetik) qe ofron produktin mund te rrise çmimin e ketij produkti per nje periudhe kohe jo tranzitore dhe te mos kete renie ne shitje deri ne nivelin qe kjo te jete jo- fitimpruese. Pra, rritja e çmimit duhet te jete fitimpruese dhe e qendrushme-monopolisti te kete aftesine te mbaje çmimin mbi nivelin konkurrues.

Testi i monopolistit hipotetik kryhet per te analizuar produktet/sherbimet te cilat mund te bejne pjese ne te njejtin treg duke marre ne konsiderate efektin e zevendesueshmerise se produkteve ne anen e kerkeses dhe/ose ofertes. Nese monopolisti perballet me kufizime nga ana e kerkeses- konsumatorit do te zhvendosen drejt konsumit te nje produkti tjetër, qe do ishte zevendesues dhe, nga ana e ofruesve- ofrues te tjere do te futeshin ne kete treg per te ofruar produktin me çmim dhe perfitim te larte, atehere produktet e tjera qe jane zevendesues te ngushte te produktit te analizuar duhet te perfshihen ne kete treg.

Zevendesimi ne anen e kerkeses

Nese nje subjekt, qe eshte monopol ne ofrimin e nje produkti/sherbimi, do te rriste çmimin e ketij produkti, çfare mundesish kane konsumatorit te zevendesojne perdorimin e ketij produkti me nje tjetër ?

Produkti/sherbimi qe analizohet krahasohet me produkte te tjere, nese ato mund te zevendesohen nga ana e konsumatorit. Nese konsumatorit mund te zevendesojne produktin e ofruar nga monopolisti hipotetik me nje produkt apo produkte te tjera, keto te fundit duhet te perfshihen ne perkufizimin e tregut perkates.

Zevendesimi ne anen e ofertes

⁴ According to settled case-law, the relevant product/service market comprises all those products or services that are sufficiently interchangeable or substitutable, not only in terms of their objective characteristics, by virtue of which they are particularly suitable for satisfying the constant needs of consumers, their prices or their intended use, but also in terms of the conditions of competition and/or the structure of supply and demand on the market in question (32). Products or services which are only to a small, or relative degree interchangeable with each other do not form part of the same market (33). NRAs should thus commence the exercise of defining the relevant product or service market by grouping together products or services that are used by consumers for the same purposes (end use).

Nese monopolisti hipotetik do te rriste çmimin e produktit/sherbimit per nje periudhe kohe jo tranzitore, a do te kishte presion nga ofrues te tjere te mundshem te ketij sherbimi? Operatore te tjere, te cilet nuk e ofrojne sherbimin ne fjale, mund te zhvendosin burimet e tyre ne drejtim te ofrimit te ketij sherbimi.

Ne zevendesimin ne anen e ofertes duhet te merren parasysh vetem operoret, te cilet mund te zhvendosin burimet e tyre drejt ofrimit te sherbimit te marre ne konsiderate, per nje kohe te shkurter dhe pa kosto te larta te pakthyeshme. Pra, operatore te rinj qe nuk jane ne treg nuk mund te merren parasysh, pasi reagimi i tyre ndaj nje rritjeje te çmimit te produktit nuk do te ishte i shpejte (ne periudhe afatshkurter) por do te kerkonte kohe per investime kapitale qe kerkojne nje periudhe afatgjate. Ofruesit e mundshem jane operatore qe ofrojne sherbime te tjera dhe lehtesisht per nje periudhe kohe te shkurter mund te prodhojne edhe produktin, çmimi i te cilit eshte rritur.

Efekti i operatoreve te rinj ne treg, qe duhet te kryejne investime kapitale, merret ne konsiderate vetem ne analizen e fuqise se ndjeshme ne treg, pra te konkurrences se mundshme qe keta operatore mund te ushtrojne.

Kufizime te perbashketa ne tarifim

Nje faktor tjetër qe merret ne konsiderate ne perkufizimin e tregut perkates eshte nese ekzistojne kufizime te perbashketa ne tarifim (common pricing constraints) midis klienteve, sherbimeve apo zonave te ndryshme. Kjo do te thote qe operatori te mos jete i pavarur ne tarifimin e sherbimeve te ndryshme: s'ka mundesi te rrise çmimin e nje sherbimi pa reduktuar çmimin e nje sherbimi tjetër, i cili ne vetevete nuk eshte zevendesues per sherbimin tjetër.

VI. Fuqia e Ndjeshme ne Treg dhe masat rregulluese

Pekufizimi i FNT eshte dhene ne nenin 33 te ligjit:

Një sipërmarrës vlerësohet me fuqi të ndjeshme në treg nëse, i vetëm, apo së bashku me të tjerë, zotëron një pozitë të tillë ekonomike, që i mundëson një zgjerim të ndjeshëm, pavarësisht nga konkurrentët, klientët apo përdoruesit fundorë.

Ky perkufizimi eshte pothuajse i njejte me perkufizimin e Direktives Kuader te KE 2002, neni 14⁵ (EC 2002 Framework Directive).

Neni 33 i Ligjit percakton gjithashtu kriteret kryesore qe duhet merren ne konsiderate per analizen per FNT, duke bere nje ndarje per rastet kur ne treg dyshohet per nje sipermarres me FNT, qe do te thote dominance individuale, dhe per raste kur dyshohet per me shume se nje sipermarres me FNT apo dominance e bashkuar. Perkufizimi i dominances se bashkuar i dhene ne nenin 33 eshte si vijon:

Dy ose më shumë sipërmarrës vlerësohen se kanë një pozitë zotëruese nëse edhe në mungesë të lidhjeve strukturore apo të lidhjeve të tjera, veprojnë në treg në një strukturë dhe mënyrë të tillë, e cilat çon në një sjellje të bashkërenduar, në mënyrë të pavarur nga konkurrentët, klientët ose përdoruesit.

⁵an undertaking shall be deemed to have significant market power if, either individually or jointly with others, it enjoys a position equivalent to dominance, that is to say a position of economic strength affording it the power to behave to an appreciable extent independently of competitors customers and ultimately consumers”

Per percaktimin e FNT, dominace individuale apo e bashkuar, sic theksohet dhe ne pikat 79 dhe 98 te Udhhezimit te KE, kriteret e perdorur duhen marre te gjitha ne konsiderate dhe ne kombinim me njeri tjetrin dhe jo ne menyre te vecante per secilin kriter me vete, pasi evidenca e kriterëve te vecante mund te mos jete percaktuese e FNT.

Analiza krahas shqyrtimit te kriterëve per vleresimin e konkurrencës efektive ne treg ne te kaluaren, ben vleresin se si pritet te evoluojë tregu ne te ardhmen. Analiza kryhet per te shqyrtuar nese nje treg perkates vleresohet te jete ne konkurrenca efektive ne nje periudhe te pakten 2 vjecare, dhe mungesa e konkurrencës efektive ne nje treg perkates te justifikueshem per nderhyrje ex-ante eshte e barazvlefshme me ekzistencen e fuqise se ndjeshme ne treg, prej nje ose me shume sipermarresish.

Ekzistenca e FNT do te thote qe ne treg ka probleme te cilat identifikohehen dhe ne baze te problemeve te evidentuara, propozohet marrja masave rregulluese apo detyrimeve per tu zbatuar nga sipermarresi/sipermarresit me FNT. AKEP ne baze te nenit 34, ka detyrimin qe ne rast te gjetjes se FNT ne nje treg perkates te vendose nje disa apo te gjitha detyrimet e cilesuara ne nenet 39-45 dhe neni 56 te Ligjit. Vendosja e detyrimeve/masave rregulluese per FNT duhet te marre ne konsiderate objektivat rregullatore te percaktuar ne Ligj.

Nese nga analiza arrihet ne perfundimin se tregu perkates eshte ne konkurrenca efektive, pra nuk ka FNT, atehere AKEP nuk vendos detyrime dhe ne rast se ndaj sipermarresve jane vendosur detyrime (per shkak te statusit te meparshem me FNT) atehere AKEP i heq keto detyrime duke percaktuar dhe nje afat kohor jo me te gjate se 6 muaj per berjen efektive te tyre. Ky percaktim aplikohet edhe per tregjet e analizuara, por qe nuk permbushin testin e tre kriterëve per nevojen per nderhyrje ex-ante.

III. ANALIZA E TREGJEVE TE SHERBIMEVE ME PAKICE

III.1.Perkufizimi i tregjeve ne nivelin me pakice

Ne analizen e tregut pararendes ne vitin 2010 AKEP, vleresoi se tregjet perkatese ne telefonine fikse ishin gjashte:

- dy tregje te aksesit ne rrjet publik telefonik nga vendndodhje fikse duke dalluar per pajtimtaret familjare dhe biznes (jo-familjare);
- dy tregje te thirrjeve telefonike lokale/kombetare nga vendndodhje fikse duke dalluar per pajtimtaret familjare dhe biznes (jo-familjare);
- dy tregje te thirrjeve telefonike nderkombetare nga vendndodhje fikse duke dalluar per pajtimtaret familjare dhe biznes (jo-familjare);

Referenca ne analizat pararendese ne trajtimin e ketyre tregjeve ishte nga rekomandimi i KE, 2003/311/EC, ku tregjet e aksesit dhe thirrjeve dalese jane segmentuar sipas llojit te pajtimtarit dhe destinacionit te thirrjeve dalese.

Ne rekomandimin 2007/879/EC te vitit 2007 per tregjet perkates, KE ka reduktuar numrin e tregjeve perkates te telefonise fikse nga 6 ne 1, duke lene vetem tregun e aksesit ne rrjet publik publik telefonik nga vendndodhje fikse per pajtimtaret familjare dhe jo-familjare. Pra ne ndryshim nga rekomandimi i vitit 2003, rekomandimi i vitit 2007:

- nuk ka perfshire tregjet me pakice te telefonise fikse (per familjare dhe jo-familjare) si tregje perkatese;
- ka bashkuar tregun e aksesit si per familjare dhe jo-familjare.

Arsyet kryesore te ndryshimeve te mesiperme nga KE jane:

- kushtet kontraktuale per te dy llojet e pajtimtareve jane pothuajse te njejta, pavaresisht se mund te kete edhe paketa te ndryshme tarifore per secilen kategori;
- arsye praktike te mbledhjes se te dhenave ku shume operatore nuk i mbajnete detajuar keto te dhena pasi edhe nuk bejne dallim ne oferta;
- tregjet e thirrjeve telefonike jane me konkurruese dhe po tentojne drejt konkurrences efektive si pasoje e suksesit te nje sere faktoreve si implementimi dhe berja efektive i Z(P)B;

Nga rezultatet e analizave te tregjeve me pakice te telefonise fikse ne vendet e BE-se, vihet re se deri ne Maj 2013:

- ne 18 vende nuk ka FNT ne asnje nga 4 tregjet e thirrjeve telefonike sipas rekomandimit 2003;
- ne 4 vende nuk ka FNT ne 2 nga nga 4 tregjet e thirrjeve telefonike sipas rekomandimit 2003;
- ne 2 vende nuk ka FNT ne 2 tregjet e aksesit te rekomandimit 2003;

Nga rezultatet e analizave te tregjeve me pakice te telefonise fikse ne vendet e rajonit (Vendet Kandidade dhe Potenciale per anetaresim ne BE)⁶, vihet re se deri ne fund te Qershorit 2012:

⁶ Sipas te dhenave te Raport 2, Korrik 2012 te Cullen International.

- Kroacia: FNT dhe masa rregulluese ne nivel me shumice dhe pakice per tregun akses ne rrjet publik nga vendndodhje fikse (familjare dhe biznes) sipas tregut 1 Rekomandimi 2007, dhe tregjet e thirrjeve lokale/kombetare (tregjet 3 dhe 5, Rek.2003). Thirrjet nderkombetare (tregjet 4 dhe 6, Rek.2003) nuk plotesojne testin e 3 kritereve. Vendimet ne Prill-Korrik 2011.
- Islanda: FNT dhe masa rregulluese ne nivel me shumice dhe pakice per tregun akses ne rrjet publik nga vendndodhje fikse (familjare dhe biznes) sipas tregjeve 1 dhe 2 te Rekomandimit 2003, dhe FNT ne tregjet e thirrjeve lokale/kombetare/nderkombetare (tregjet 3-6, Rek.2003), por pa masa rregulluese ne nivel me pakice. Vendimet ne Dhjetor 2008.
- Maqedonia: FNT dhe masa rregulluese ne nivel me shumice dhe pakice per tregjet 1-6 te Rekomandimit 2003. Rregullimi i cmimeve me pakice ne formen e ndalimit te cmimeve agresive dhe ndalimit te paketimit te paarsyeshem (lejim per blerje te elementeve te vecante te shportave). Vendimet ne Tetor 2010.
- Mali i Zi: FNT dhe masa rregulluese ne nivel me shumice dhe pakice per tregun akses ne rrjet publik nga vendndodhje fikse (familjare dhe biznes) sipas tregut 1 Rekomandimi 2007, dhe tregjet e thirrjeve lokale/kombetare/nderkombetare (tregjet 3-6, Rek.2003). Rregullimi i cmimeve me pakice ne formen e ndalimit te cmimeve agresive dhe ndalimit te paketimit te paarsyeshem (lejim per blerje te elementeve te vecante te shportave). Vendimet ne Dhjetor 2011.
- Serbia: FNT dhe masa rregulluese ne nivel me shumice dhe pakice per tregun akses ne rrjet publik nga vendndodhje fikse (familjare dhe biznes) sipas tregut 1 Rekomandimi 2007, dhe tregjet e thirrjeve lokale/kombetare/nderkombetare (tregjet 3-6, Rek.2003). Rregullimi i cmimeve me pakice ne formen e ndalimit te cmimeve agresive dhe ndalimit te paketimit te paarsyeshem (lejim per blerje te elementeve te vecante te shportave), si edhe orientim ne kosto dhe/ose benchmark. Vendimet ne Nentor 2011.
- Turqia: FNT dhe masa rregulluese ne nivel me shumice dhe pakice per per tregjet 1-6 te Rekomandimit 2003. Vendimet ne Dhjetor 2009.
- Bosnja&Hercegovina: FNT dhe masa rregulluese ne nivel me shumice dhe pakice per per sherbime telefonike fikse (tregu sipas kuadrit rregullator 1998). Vendimet ne Dhjetor 2009.
- Kosova: FNT dhe masa rregulluese ne nivel me shumice dhe pakice per tregun akses ne rrjet telefonik nga vendndodhje fikse dhe tregjet e thirrjeve lokale/kombetare dhe thirrje nderkombetare. Vendimet ne Shkurt 2012.

Bazuar ne pervojat ne vendet e BE-se, si dhe rekomandimin e vitit 2007 te KE-se per tregjet perkatese si dhe duke marre shkas nga zhvillimet e tregut te telefonise fikse dhe te tregut te komunikimeve elektronike ne teresi ne keto dy vite si dhe pritshmerite per te ardhmen, AKEP gjykon te arsyeshme te rishikoje vleresimin e perkufizimit dhe detajimit te tregjeve perkatese me pakice te telefonise. Ne rishikimin e perkufizimit te tregjeve perkatese te analizuar AKEP ka marre ne konsiderate keta faktore:

- Aksesit dhe thirrjet duhet te vazhdojne te jene pjese te njejtut treg ose jo?
- A duhet te kete tregje te vecanta perkates per pajtimtaret familjare dhe jo-familjare?
- A duhet te percaktohen tregje perkates te vecante te thirrjeve telefonike sipas destinacionit lokale/kombetare dhe nderkombetare?
- A jane thirrjet nga rrjetet celulare ne te njejtin treg perkates me thirrjet nga vendndodhje fikse?

1. Aksesit dhe thirrjet duhet te vazhdojne te jene pjese te njejtit treg ose jo?

Eshte evident fakti qe grupi i sherbimeve te telefonise fikse nga pothuajse te gjithe ofruesit mundesohen ne paketa qe kane ne brendesine e tyre aksesin dhe perdorimin e sherbimeve qe mundesohen nga ky akses (grupe thirrjesh qe perفشijne destinacione te ndryshme sipas segmentimeve on-net, lokale, kombetare, drejt celulareve, nderkombetare, etj).

Ne dy analizat pararendese (2007 dhe 2010) eshte aritur ne konkluzionin qe: *Tregu i aksesit dhe tregu i thirrjeve ne telefonine fikse jane dy tregje te ndryshme, te ndara dhe mund te konsiderohen si dy tregje plotesuese per njeri-tjetrin.*

AKEP gjykon se gjate ketyre viteve nuk kane ndodhur ndryshime te tilla qe te justifikojne bashkimin e tregjeve perkates te thirrjeve dhe te aksesit ne nje treg perkates te vetem. Kjo ndarje e tregjeve eshte ne linje edhe me rekomandimet 2003 dhe 2007 te KE si dhe me praktiken me te mire ne vende te rajonit dhe te BE. Pra si perfundim per kete ceshtje:

Tregu i aksesit dhe tregu i thirrjeve ne telefonine fikse jane dy tregje perkates te ndryshem.

2. A duhet te kete tregje te vecanta perkates per pajtimtaret familjare dhe jo-familjare?

KE ne rekomandimin e 2007, thekson se dallimi ndermjet kategorive te perdoruesve (familjare dhe jo-familjare) po behet gjithnje e me i vogel, dhe vet ofruesit e sherbimeve ne treg shpesh nuk bejne dallim midis kategorive si dhe zevendesueshmeria ne anen e ofertes eshte e lehte: pra nje ofrues per pajtimtare familjare mund te ofroje sherbim edhe per pajtimtare biznes dhe vice-versa, ne rast te rritjes se cmimit te sherbimit tjetere. Gjithashtu termat kontraktuale shpesh jane te njejta si per familjare dhe jo-familjare.

Keto tendenca vihen re edhe ne Shqiperi. Te gjithe operoret e rrjeteve te telefonise fikse ofrojne sherbime si per pajtimtaret Familjare dhe Jo-Familjare (Biznes). Shumica e operoreve madje nuk bejne dallim edhe ne paketa tarifore. Gjithashtu edhe kontratat e miratuara nga AKEP per Albtelcom per pajtimtaret Familjare dhe Te Tjere (Jo-Familjare) jane te njejta ne permbajtje me ndryshime shume te vogla.

Pra, kriteri i zevendesueshmerine ne anen e kerkese/ofertes vazhdon te behet gjithnje e me bindes, dhe per kete sjellim ne vemendje keto faktore:

- kushtet kontraktuale parashikojne te njejtat te drejta dhe detyrime;
- sherbimet dhe produktet qe ofrohen kane te njejtat karakteristika dhe cilesi;
- nuk ka barriera ne hyrje per dy kategorite e pajtimtareve;
- ne anen e ofertes nuk vihet re te kete barriera per furnizimin e dy kategorive;

Aktualisht tarifat e Albtelcom per pajtimtaret Familjare dhe Te Tjere (Jo-Familjare) nuk jane te njejta, dhe pajtimtaret Jo-Familjare kane tarifa me te larta se ata familjare, dhe kjo ka cuar ne tendence te shume bizneseve te vegjel te blejne paketen Familjare te Albtelcom, pra kane bere dhe bejne zevendesim ne anen e kerkeses.

Per sa me siper AKEP gjykon qe te mos beje me dallim ne tregjet perkates ne Familjare dhe Jo-Familjare. Ne vijim edhe te perfundimit per ndarjen e tregjeve ne tregje aksesit dhe thirrje telefonike:

Tregu perkates i Aksesit ne rrjet publik telefonik nga vendndodhje fikse perfshin pajtimtaret familjare dhe jo-familjare;

Tregu perkates i Thirrjeve telefonike te disponueshme per publikun nga vendndodhje fikse perfshin pajtimtaret familjare dhe jo-familjare;

3. A duhet te percaktohen tregje perkates te vecante te thirrjeve telefonike sipas destinacionit lokale/kombetare dhe nderkombetare?

Perdorimi i kriterit te zevendesueshmerise ne anen e kerkeses eshte bere edhe dallimi me i madh ndermjet llojeve te thirrjeve (lokale dhe kombetare apo nderkombetare), apo karakteristikave te tjera te cilat nuk lejojne zevendesueshmeri te plote ne anen e kerkeses.

Ne anen e kerkeses nga pajtimtaret nuk ka zevendesueshmeri midis thirrjeve drejt destinacioneve te ndryshme, por nese do te bazoheshim vetem tek ky kriter atehere segmentimi do te ishte shume me i detajuar, pasi pajtimtari nuk mund te zevendesojte as thirrjet drejt personave te ndryshem.

Ne rekomandimin 2007 te KE-se, eshte vene ne dukje fakti qe aksesit nga nje vendndodhje fikse ne nje rrjet publik duhet te percaktohet me nje perkufizim me te gjere (me perfshires), ku te cilesohet akses per "sherbime telefonike te vlefshme per publikun", si dhe duke marre ne konsiderate faktin qe evoluimi i teknologjive qe mundesojne akses do te sjelle edhe evoluim te games se sherbimeve qe perfitohen nga ky akses ne vendndodhje fikse. Arsyet per konvergjence tregjesh behen gjithnje e me te vlefshme, nese merret ne konsiderate fakti qe thirrjet zanore qe mundesohen nga platforma qe mbeshteten nga interneti po gjejne gjithnje e me shume perdorim dhe kjo ka bere te mundur qe ofruarit e rrjeteve dhe sherbimeve te telefonise fikse te rivlersojne prioritetet e tyre ne kete drejtim per sherbimet qe mundesohen nga platforma interneti broadband dhe PSTN, duke identifikuar si dallimet dhe elementet e perbashketa ndermjet tyre, vleresimin e mundesise se zevendesueshmerise se tyre, zevendesueshmeri i cila kryesisht varet nga nje numer faktoresh si:

- karakteristikat e produktit qe kane per baze funksionalitetin;
- kualiteti i sherbimeve;
- tarifimi i sherbimeve;
- shkalla e penetrimit te sherbimit;
- konkurrueshmeria ne furnizimin me sherbime;
- sjelljet konsumatore te orientuara nga sherbimi; etj

Nje nder arsyet e konvergjences se tregjeve ne nivelin e pakices vjen edhe nga fakti qe mundesite nga ofruarit e sherbimeve per diferencim ndermjet sherbimeve qe perfitojne konsumatorit nga platforma te ndryshme te jene gjithnje e me te vogla. Rasti i zevendesueshmerise se sherbimeve te platformes PSTN me sherbime te platformave qe kane per baze internet broadband, favorizon arsyetimin per konvergjence per thirrjet ne tregun e pakices. Gjitashtu tendenca ne rritje per ofrim te thirrjeve telefonike me paketa qe perfshijne thirrje drejt destinacioneve te ndryshme si lokale, kombetare dhe nderkombetare si dhe kufizimi i diferencave te tarifave kombetare dhe nderkombetare perben argument shtese per perfshirje ne nje treg te vetem te thirrjeve drejt destinacioneve te ndryshme.

Bazuar ne sa me siper, AKEP vlereson se:

Thirrjet lokale/kombetare dhe thirrjet nderkombetare nga vendndodhje fikse jane pjese e te njejtin treg perkates.

4. A jane aksesi/thirrjet nga rrjetet celulare ne te njejtin treg perkates me aksesi/thirrjet nga vendndodhje fikse?

Ne analizat pararendese eshte konkluduar qeaksesi dhe thirrjet nga vendndodhje e levizshme (celulare) nuk jane pjese e tregjeve te aksesit dhe thirjeve dalese nga vendndodhje fikse.

AKEP vazhdon te qendroje ne te njejtin linje arsytimi perseri, pavaresisht ndryshimeve te ndodhura, sepse ka disa faktore qe e bejne te pamundur te vleresohet ne kete faze qe thirrjet nga vendndodhje fikse jane ne te njejtin treg me thirrjet nga telefoni e levizshme (celulare), duke i konsideruar ne kete menyre si tregje plotesuese te njeri-tjetrit.

Diferenca kryesore ne kete rast ka te beje me karakteristikat e ndryshme te sherbimit “levizshmeria” per telefonine celulare, e cila konsiderohet si nje faktor i rendesishem qe perben avantazh te ndjeshem ndaj “vendndodhjes fikse”. Pavaresisht avancimeve te teknologjise qe sherbimet mund te duken te ngjashme, mungesa e faktorit “levizshmeri” per sherbimet fikse i ben ato te ndryshme nga sherbimet celulare.


Aktualisht zevendesueshmeria e thirrjeve nga celulare dhe rrjete fikse vleresohet me shume se ekziston ne nje drejtim: thirrjet celulare zevendesojne thirrjet nga rrjete fikse por jo e kunderta. Pra mund te konsiderohet si zevendesueshmeri asimetrike apo me nje drejtim. AKEP ka arritur ne konkluzionin se thirrjet nga rrjete fikse nuk jane pjese e tregut perkates te thirrjeve nga rrjete celulare (Analizat celulare 2010-2012), dhe ky eshte nje perfundim i mirepranuar kudo edhe ne vende te tjera. Per sa i perket perfshirjes se thirrjeve nga celulare ne nje treg perkates me thirrjet nga vendndodhje fikse vlen te theksohet se ka argumenta pro dhe kunder te cilet trajtohen ne vijim.

Ecuria e numrit te pajtimtareve dhe trafikut

Qe te kete zevendesueshmeri ne anen e kerkeses duhet qe perdoruesit e telefonise fikse te zevendesojne aksesin/thirrjet nga vendndodhje fikse me akses/thirrje nga rrjete celulare ne rastet kur ka nje rritje te vogel por te ndjeshme te tarifave te sherbimeve aksesit/thirrjeve nga vendndodhje fikse nga monopolisti hipotetik (testi SSNIP).

Nese do ti referoheshim grafikeve dhe te dhenave te tregut per numrin e pajtimtareve (kapitulli Hyrje) dhe thirrjeve telefonike celulare dhe fikse vihet re numri i pajtimtareve dhe thirrjet nga rrjetet celulare jane rritur ndjeshem ne krahasim me numrin dhe thirrjet nga rrjete fikse. Figura e meposhteme paraqet ecurine e trafikut te thirrjeve nga rrjetet celulare dhe thirrjeve nga Altelecom.

Figura III.1: Ecuria e thirrjeve nga rrjetet fikse dhe celulare 2003-2012⁷



Nga figura mund të veme re se thirrjet e kryera nga rrjete celulare janë rritur ndjeshëm në periudhën 2008-2012 dhe që prej vitit 2007 ato janë me të mëdha se thirrjet nga Albtelecom. Kjo figure si dhe ecuria e numrit të pajtimtareve mund të përbejnë argumenta se ka zëvendësueshmëri të thirrjeve nga rrjete fikse me thirrje nga rrjete celulare, megjithatë:

- Diferenca e madhe e trafikut dales në 2009-2012 shpjegohet edhe me rritjen dhe numrin shumë më të madhë të përdoruesve celulare se numri i përdoruesve të Albtelecom që aktualisht në 2010-2011 ka pasur rënie;
- Ecuria e trafikut të Albtelecom në vitet 2007-2009 nuk ka ardhur në rënie, ndërsa në vitet 2010 dhe 2012 është vënë re reduktimi i trafikut dales. Megjithatë kjo periudhë është shoqëruar edhe me reduktim të numrit të pajtimtareve të Albtelecom.
- Një rol të madh në rritjen e madhë e trafikut dales celular rezultojnë se ka luajtur rritja e konkurrencës midis operatorëve celulare dhe reduktimi i ndjeshëm të tarifave të operatorëve celulare.
- Zëvendësimi i thirrjeve fikse me thirrje nga celulari (për përfshirje në një treg përkatës të këtyre llojeve thirrjeve) do të mund të evidentohet nëse nga një rritje e vogël e tarifave të thirrjeve nga rrjete fikse, kur çdo gjë tjetër e pandryshuar (përfshirë tarifën celulare, numrin e përdoruesve celulare etj) do të kishim rritje të thirrjeve celulare.

Tarifimi

Përveç sa më sipër në zëvendësueshmëri të shërbimeve ndikon edhe faktori çmim. Reduktimi i ndjeshëm i tarifave celulare sidomos për thirrjet brenda grupeve të mbyllura mund të krijojë efekte zëvendësimi të thirrjeve telefonike nga fikse me thirrjet nga rrjete celulare. Megjithatë pavaresisht uljes së ndjeshme të tarifave në telefoninë celulare, perseri

⁷ Te dhenat e trafikut dales të Albtelecom për vitin 2011 janë korrigjor në krahasim me dokumentin e nxjerrë në konsultim publik.

thirrjet nga telefonia fikse jane me te lira se thirrjet nga telefonia celulare, sidomos ne paketat standarte dhe kohet e fundit edhe ne paketat e tjera. Njekohesisht vlen te theksohet se me migrimin drejt rrjeteve NGN/NGA thirrjet nga rrjetet fikse do te jene akoma me te lira pasi do te shfrytezohen mundesite e rrugezimit me IP, qe ka kosto shume me te lira se TDM.

Nje faktor i rendesishem ne vleresimin e kesaj lloj zevendesueshmerie, eshte fakti se sherbimet celulare konsumohen si pakete sherbimesh qe perfshin lloje te ndryshme thirrjesh (drejt destinacioneve te ndryshme si brenda rrjetit, jashte rrjetit dhe nderkombetare) dhe krahasimi i zevendesueshmerise se bazuar ne tarifa te llojeve te caktuara te thirrjeve celulare dhe fikse nuk do te ishte i plote.

Per sa me siper, AKEP gjykon se komentet e Albtelecom ne lidhje me tarifat e uleta te thirrjeve celulare brenda grupeve, eshte nje ceshtje qe mund te kerkoje adresim ne kuader te sigurimit te konkurrences se qendrueshme te tregut celular. Nderkohe Autoriteti i Konkurrences ka hapur nje hetim te thelluar per tregun me pakice celular.

Ofrimi sherbimeve GSM Fiks

Vodafone dhe AMC jane pajisur me numeracion gjeografik fikse per te ofruar sherbime te telefonise fikse duke perdorur rrjetin GSM. Vodafone nuk eshte prezent ne kete treg, por AMC per vetem 1 muaj aktivitet ne ofrimin e sherbimit te telefonise fikse me numra fikse duke perdorur rrjetin GSM ka arritur te kape 2% pjese tregu (referuar te dhenave te fundvitit 2011), ndersa sipas te dhenave te vitit 2012, vihet re se numri i pajtimtareve te AMC fikse eshte reduktuar me rreth 20%.

Megjithate ofrimi i sherbimit te telefonise fikse nga operatoret celular, GSM fikse, megjithese ka disa ndryshime nga telefonia fikse tradicionale, AKEP e konsideron si sherbim publik telefonik fikse dhe ne kete rast nuk mund te flasim per zevendesueshmeri celular-fiks.

Aksesi

Diskutimi i mesiperme eshte perqendruar tek thirrjet telefonike, por ai vlen edhe per aksesin fikse dhe celular. Ne kete ceshtje vlen te permendet se megjithese diskutimi eshte perqendruar ne thirrjet telefonike, pjese e tregjeve perkates jane edhe sherbimet e lidhura me to, dhe sherbimet e tjera te telefonise fikse dhe celulare jane krejt te ndryshme.

Per sa me siper AKEP vlereson se telefonia celulare dhe rritja e konkurrences se saj ndikon ne zevendesueshmeri te sherbimeve por jo ne nivel te tille qe ajo te konsiderohet zevendesuese e afert per aksesin/thirrjet telefonike nga rrjete fikse (per perfshirje ne tregun perkates te thirrjeve fikse), pra:

Aksesi/thirrjet nga rrjetet celulare nuk jane pjese e tregjeve perkates te aksesit/thirrjeve nga vendndodhje fikse

Dimensioni gjeografik i sherbimeve te telefonise fikse

Duke u bazuar ne perfundimet e analizave pararendese, ku keto tregje u percaktuan me dimension kombetar, si dhe ne faktin se nuk kane ndodhur apo pritet te ndodhin ndryshime te tilla qe te ndikojne ne ndryshimin e perfundimit per dimensionin gjeografik, AKEP gjykon se

Dimensioni gjeografik i tregjeve perkatese te aksesit ne rrjet publik telefonik dhe thirrjeve telefonike nga vendndodhje fikseeshte kombetar.

Perfundim mbi perkufizimin e tregjeve perkates te pakices

Per sa eshte trajtuar ne kete seksion, vleresohet e arsyeshme qe tregjet perkatese ne nivelin me pakice te propozuara nga AKEP te justifikueshme per nderhyrje ex-ante dhe pert'u analizuar jane:

- **Tregu i aksesit ne rrjet publik telefonik nga vendodhje fikse (per pajtimtare familjare dhe jo –familjare);**
- **Tregu i sherbimeve publike telefonike te ofruara nga vendodhje fikseper pajtimtare familjare dhe jo –familjare).**

Dimensioni gjegrafik i ketyre tregjeve eshte kombetare dhe perfshijne sherbimet e ofruara per perdoruesit.

III.2. Analiza per FNT e tregjeve me pakice

Ne analize 2010 AKEP percaktoi Albtelecom si operator me FNT ne tregjet perkates me pakice te meposhtem:

- 1) Tregu me pakice i aksesit ne rrjet telefonik publik nga vendndodhje fikse per klientet familjare;
- 2) Tregu me pakice i aksesit ne rrjet telefonik publik nga vendndodhje fikse per klientet jo-familjare;
- 3) Tregu me pakice per sherbimet telefonike lokale dhe/ose kombetare te disponueshme per publikun te ofruara nga vendndodhje fikse per klientet familjare.
- 4) Tregu me pakice per sherbimet telefonike nderkombetare te disponueshme per publikun te ofruara nga vendndodhje fikse per klientet familjare.
- 5) Tregu me pakice per sherbimet telefonike lokale dhe/ose kombetare te disponueshme per publikun te ofruara nga vendndodhje fikse per klientet jo-familjare.
- 6) Tregu me pakice per sherbimet telefonike nderkombetare te disponueshme per publikun te ofruara nga vendndodhje fikse per klientet jo-familjare.

Ne seksionin e meparshem AKEP argumentoi se tregjet perkates jane:

- Tregu i aksesit ne rrjet publik telefonik nga vendodhje fikse (per pajtimtare familjare dhe jo –familjare);
- Tregu i sherbimeve publike telefonike te ofruara nga vendodhje fikse per pajtimtare familjare dhe jo –familjare).

Ndryshimi nga 2010 eshte vetem ne segmentimin e tregjeve perkates pasi sherbimet e perfshira jane te njejta: akses dhe sherbime telefonike te disponueshme per publikun nga vendndodhje fikse.

Ne kete kapitull paraqiten ndryshimet kryesore qe kane ndodhur ne tregun me pakice te ofrimit te sherbimeve te telefonise fikse ne vitet 2010- aktualisht dhe efektet qe ato kane pasur ne treg, sidomos ne dominancen apo FNT ne treg te Albtelecom. Analizimi i ndryshimeve kryhet ne te njejten kohe me analizimin e kriterëve per FNT ne tregjet perkates me pakice te sherbimeve te telefonise fikse.

1. Pjeset e tregut

Pjesa e tregut është një ndër faktorët e rëndësishëm që vlerëson FNT dhe ky tregues është matur në ecurinë e tij në vite. Por në vlerësimin e FNT, kriteri i pjesëve të tregut do të përdoret i kombinuar dhe i arsyetuar së bashku me kritere të tjera, pasi vetëm pjesa e tregut nuk është kriter përfundimtar.

Në vlerësimin e pjesëve të tregut për aksesin në rrjet telefonik nga vendndodhje fikse një ndër elementet e përdorur është numri i pajtimtarëve të rrjetit. Ky tregues është matur ndër vite edhe është përdorur si referencë edhe në analizat pararendëse. Referuar të dhënave të fundit vitit 2011, rezultojnë që telefonimi fikse në ndryshim nga vitet e fundit ka shënuar rritje të vogël në numrin e pajtimtarëve në rreth 339 mijë në 2011, ndërsa në vitin 2012 numri i përdoruesve ka shënuar rënie me 8% duke arritur në rreth 312 mijë.

Për periudhën 2010-2012, rezultojnë që numri i pajtimtarëve si dhe shpërndarja e tyre sipas rrjeteve është si në tabelën më poshtë:

Tabela III.1: Ecuria e numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse sipas operatorëve (2010-2012)

	Albtelecom	Abcom	ASC	Nisatel	Primo	AMC Fiks	OA të tjere	Total
2012	230,397	33,000	7,649	5,500	2,584	6,119	26,412	311,661
2011	258,943	27,167	10,129	4,950	3,300	7,565	26,790	338,844
2010	277,763	19,975	7,408	5,900	3,678	-	16,778	331,502
Ndryshimi 2012/2011	-11%	21%	-24%	11%	-22%	-19%	-1%	-8%


Albtelecom në fund të vitit 2012, kishte rreth 230 mijë pajtimtarë ndërsa operatorët alternativë rreth 81 mijë. Rënia e numrit të pajtimtarëve të Albtelecom (me 17% në dy vjet) dhe rritja e numrit të pajtimtarëve të operatorëve alternativë ka çuar në reduktimin e pjesës së tregut të Albtelecom nga 84% në 2010 në 74% në 2012.

Abcom, ASC, Nisatel, Primo dhe AMC Fiks janë pesë operatorët alternativë me të cilët medhenj që zotërojnë rreth 67% të numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse të të gjithë operatorëve alternativë. Abcom dhe Nisatel kanë rritjen më të madhe vjetore në 2012 me 22% dhe 11% respektivisht.

Abcom vazhdon të jetë operatori më i madh alternativ fikse me rreth 33 mijë pajtimtarë. Vlen të theksohet se Abcom dhe ASC si dy operatorët alternativë me të cilët medhenj janë prezent në treg me oferta 'triple play' duke ofruar Internet broadband, telefoni dhe TV.

Megjithatë rënia e numrit të pajtimtarëve të Albtelecom, perseri zotëron rreth 74 % të këtij tregu me rreth 230 mijë pajtimtarë ndërsa operatorët alternativë rreth 26 % me rreth 81 mijë pajtimtarë.

Figura III.2: Pjeset e tregut te numrit të pajtimtarëve të telefonise fikse (2012)



Ne tabelen e meposhtme paraqiten pjeset e tregut per aksesin dhe thirrjet telefonike dalese ne total, per periudhen 2007-2012 per sherbimet e telefonise fikse, per numrin e pajtimtareve ne total, volumin e trafikut dales ne total, si dhe pjeset e tregut per volumin e te ardhurave ne total te klasifikuar per Albtelcom dhe Operoret Alternative (perfshire edhe AMC Fiks).

Tabela III.2:Pjeset e tregut te treguesve kryesore te telefonise fikse 2007-2012

Treguesit e pjeseve te tregut		2007	2008	2009	2010	2011	2012
Pajtimtare ne total	Alternative	12%	13%	13%	16%	24%	26%
	Albtelcom	88%	87%	87%	84%	76%	74%
Trafiku dales ne total	Alternative	7%	7%	11%	6%	8%	11%
	Albtelcom	93%	93%	91%	94%	92%	89%
Te Ardhura nga telefonua fikse	Alternative	5%	5%	7%	18%	16%	24%
	Albtelcom	95%	95%	93%	82%	84%	76%

Nga te dhenat e tabelës vihet re se:

- Pjesa e tregut te Albelecom per pajtimtare eshte reduktuar ne 2012 me 10 pike perqindje ne krahasim me 2010, duke arritur ne 74% ne fund te vitit 2012;
- Pjesa e tregut te Albtelcom per thirrjet dalese paraqesin luhajte por ne nivel te qendrueshem rreth 90% per disa vite rresht.
- Pjesa e tregut te Albtelcom ne te ardhura eshte reduktuar nga 95% ne 2007-2008 ne 84% ne 2011 dhe ne 76% ne 2012.

Pjeset e tregut te Albtelcom per tregun e aksesit dhe te thirrjeve telefonike nga vendodhje fikse, krahasuar me operoret alternativemegjithese kane tendence renie krahasuar me vitet e meparshme, rezulton qe te jete nje tregues qe tregon dominance ne tregun e aksesit dhe thirrjeve telefonike.

Ne Udhezimin e BE, shprehet qarte se pjesa e tregut me e madhe se 50 per qind eshte nje tregues i padiskutueshem i fuqise se ndjeshme ne treg dhe, vetem ne raste te rralla mund te ndodhe qe nje operator me pjese tregu te tille te mos kete fuqi te ndjeshme ne treg⁸.

Ne lidhje me strukturen e thirrjeve dalese te pajtimtareve te Albtelecom, vihet re se ruhet i njejti trend si ne fund te vitit 2011, ku thirrjet lokale perbejne nje pjese te konsiderueshme te thirrjeve dalese mbi 75%, ndersa thirrjet nderkombetare dhe drejt rrjeteve celulare perbejne nje pjese shume te vogel me me pak se 10%. Struktura e thirrjeve dalese nuk paraqet ndryshime nga periudhat e meparshme.

2. Barrierat per hyrje ne treg

Arsyetimi i AKEP ne lidhje me kete faktor ngelet i pandryshuar edhe ne kete dokument si ne analizen pararendese 2010, per te cilen eshte konkluduar qe, pjesa e tregut e nje operatori mund te mos jete tregues i fuqise se ndjeshme ne treg, ne rast se nuk plotesohen nje sere kushtesh te tjera. Nje nder keto kushte eshte edhe ekzistenca e barrierave ne treg. Nese nje operator ka pjese te madhe ne treg, por nderkohe tregu eshte i hapur ndaj operatoreve te rinj, te cilet mund te hyjne dhe dalin nga tregu pa kufizime ligjore dhe kosto ekonomike, atehere aftesia e nje operatori me pjese te madhe tregu per te ndikuar ne kete treg eshte e kufizuar. Aktualisht per te hyre ne tregjet e telefonise fikse ne nivel pakice nuk konsiderohet te kete barriera te natyres ligjore, por kjo nuk do te thote qe keto tregje nuk kane barriera te natyres ekonomike dhe teknike.

Faktoret e konsideruar ne analizat pararendese, si:

- ekonomi shkalle;
- ekonomi e densitetit;
- avantazhet e shtrirjes se infrastruktures dhe trashegimia e saj;
- integrimi vertikal;

pavaresisht periudhes dy vjecare te kaluar qe nga kryerja e analizes pararendese 2010, si dhe zhvillimeve te ndodhura ne tregjet e nivelit te pakices gjate kesaj periudhe, perseri secili prej faktoreve te grupuar me siper nuk duhet konsideruar inekzistent ne rritjen edominances individuale te Albtelecom ne tregjet e pakices ne telefonine fikse.

Pavaresisht zbehjes se dominances se Albtelecom ne tregjet e nivelit te pakices, perseri vazhdon te kete avantazhe ndaj operatoreve te tjere (edhe pse me te limituara) per shkak te ekonomive te shkalles, ekonomive te densitetit, integritimit vertikal dhe horizontal (prezent ne telefoni fikse dhe celulare), duke ndikuar pozitivisht ne aftesine ndikuese te Albtelecom ne tregjet e aksesit dhe thirrjeve telefonike nga vendndodhje fikse.

3. Konkurrenca e mundshme

Nder faktoret qe pritet te kene ndonje efekt ne reduktimin apo eliminimin e dominances se Albtelecom ne te ardhmen eshte edhe konkurrenca e mundshme qe mund te vije:

⁸ According to established case-law, very large market shares — in excess of 50 % — are in themselves, save in exceptional circumstances, evidence of the existence of a dominant position (78). An undertaking with a large market share may be presumed to have SMP, that is, to be in a dominant position, if its market share has remained stable over time.

- nga operatoret aktuale ne tregun e telefonise fikse.
Abcom eshte operatori alternativ qe ka pasur rritjen me te madhe te numrit te pajtimtareve ne keto vite si dhe AMC Fiks vihjet re se ka rritje te madhe per nje kohe te shkurterne fillim te ofrimit te GSM fikse, por qe ka pasur rritje me pas ne 2012. Efekti i ketyre dy operatoreve ne te ardhmen, si faktore qe mund te ulin dominacen e Albtelecom, mund te rritet pasi:
 - o Abcom konkurren ne treg me oferta triple play dhe eshte operatori alternativ me shtrirjen me te madhe gjeografike dhe kjo mund te perbeje avantazh ndaj Albtelecom;
 - o AMC ka mundesine te ofroje sherbimin AMC Fiks ne te gjitha Shqiperine ku ka mbulim me rrjet GSM dhe ky mbulim eshte shume me i madh se mbulimi i rrjetit te Albtelecom.
 - o Me implementimin e portabilitetit te numrit fikse ne 2012 aftesite konkurruese te operatoreve alternative normalisht jane me te medha se me pare.
- Nga operatoret celulare.

Konkluzioni i perkufizimit te tregut perkates ishte qe aksesit/thirrjet telefonike nga rrjete celulare nuk jane pjese e te njejtit treg perkates me aksesin/thirrjet telefonike nga vendndodhje fikse pasi nuk mund te konsiderohen zevendesues te afert. Megjithate AKEP vlereson se midis sherbimeve ka zevendesuesmeri dhe kjo eshte me e theksuar ne zevendesimin e aksesit/thirrjeve fikse me akses/thirrje celulare se e kunderta. Kjo zevendesuesmeri e sherbimeve, megjithese jo ne mase te tille per te qene ne nje treg perkates, ndikon ne zvogelimin e dominances aktuale te Albtelecom.

Por a eshte kjo zevendesuesmeri/konkurrenca nga sherbimet celulare e tille qe te reduktoje dominancen e Albtelecom deri ne mungese FNT?

Vleresimi i AKEP duke marre ne konsiderate edhe ecurine e tarifave celulare dhe te telefonise fikse eshte se:

- Ekzistenca e tarifave shume te uleta ose ne nivel zero te aksesit (pajtimi mujor/lidhje) per telefonine celulare ndikon ne vendimet e familjeve per te hequr dore nga ose per te mos blere nje linje telefonike fikse;
- Reduktimi i ndjeshem i tarifave celulare ka ndikuar ne rritjen e ndjeshme te trafikut celular dhe ne rritjen e zevendesuesmerise se thirrjeve fikse me thirrje celulare pasi ato po behen te krahasueshme ne nivelin e tarifave. Megjithate zevendesuesmeria e thirrjeve nga rrjete fikse me thirrje nga rrjete celulare ka qene gjithmone e pranishme dhe perdoruesit jane te gatshem te zevendesojne thirrjet fikse me thirrje nga celulare edhe duke paguar nje tarife/kosto shtese per keto thirrje per shkak te konvencences se kryerjes qe krijojne thirrjet nga celulare krahasuar me ato nga fikse.

Nje faktor tjeter ndikues ne konkurrenca ne tregun me pakice te telefonise fikse eshte edhe implementimi efektiv i detyrimeve te vendosura ndaj Albtelecom ne nivel me shumice. AKEP gjate ketyre dy viteve ka marre vendime per implementimin e Z(P)B ne rrjetin Albtelecom si dhe per hapjen e qarkut lokal. Keto detyrime jane reflektura ne ndryshimin e RIO per perfshirjen e Z(P)B dhe pergatitjen e RUO. Keto sherbime tashme jane prezente ne treg. Perdorimi i ketyre sherbimeve me shumice nga operatoret e tjere do te beje te mundur rritjen e konkurrenca ne tregun me pakice te thirrjeve telefonike dhe reduktimin e dominances se Albtelecom ne kete treg.

Konkurrenca e mundshme nga rritja dhe forcimi i pozitive te operatoreve kryesore alternative ne treg si dhe nga mundesite e perdoruesve fiks per te zevendesuar thirrje fikse me thirrje nga celulare me tarifa te cilat jane ulur dhe po ulen ndjeshem, ndikon ne reduktimin e pozites dominuese te Albtelecom.

4. Tarifimi i sherbimeve me pakice

Albtelecom ofron sherbimin e telefonise fikse me paketat standarte 'Familjare' dhe 'Te Tjere' si dhe paketa te tjera tarifore si Fol Fix. Bazuar ne VKD nr.1348, date 26.07.2010 dhe analizen 2010 dy paketat standarte jane nen-rregullim ndersa Albtelecom ka mundesine qe te ofroje paketa te tjera tarifore te cilat nuk jane nen-rregullim ex-ante, por me kusht qe te mos cenojne konkurrencen ne treg.

Tarifimi i sherbimeve te telefonise fikse ne keto dy vite ka njohur ndryshime te rendesishme ne krahasim me vitet e meparshme per sa i perket paketave tarifore me shporta minutash dhe shporta me sherbime te ndryshme qe perfshijne edhe Internet apo ne disa raste edhe programe TV. Kjo eshte bere e mundur nga futja e teknologjive te reja dhe avancimi i sherbimit te aksesit ne Internet.

- Ecuria e Tarifave te Albtelecom

Paketat Standarte "Familjare" dhe "Te Tjere"


Struktura e pajtimtareve te Albtelecom, sipas llojit te pajtimtareve Familjare dhe Te tjere (bisnes) ka qene e qendrueshme ne vite, ku pajtimtaret Familjare perbejne rreth 93% te numrit total te pajtimtareve. Kjo strukture reflektohet edhe ne strukturen e thirrjeve dales, ku pajtimtaret familjare gjenerojne rreth 90% te trafikut dales.

AKEP me VKD nr.1348, date 26.07.2010, i amendur, percaktoi tarifat maksimale per keto dy paketa duke filluar nga 1.09.2010. Tarifat e dy paketave standarte nuk kane pasur ndryshime ne periudhen 2010-aktualisht. Sic eshte bere e qarte edhe ne analizen pararendese ne lidhje me tarifat e sherbimeve ne niveline pakices per Albtelecom, mbi historikun e tyre nder vite si tarifa jo te balancuara, apo jo te orientuara drejt koston, mund te themi qe pas kalimit te nje periudhe dy vjecare qe nga analize 2010, rezulton qe pavaresisht qe eshte avancuar pozitivisht ne kete drejtim , perseri nglelet akoma evident nje problem i tille. Pas perfundimit te aplikimit te metodologjise se rregullimit te tarifave te Albtelecom, te cilat u miratuan nga Keshilli i Ministrave nepermjet VKM Nr.854, date 18.06.2008, rezulton qe, perseri jemi ne kushtet e mos-ribalancimit te plote te tarifave per sherbimet qe ofrohen ne tregjet e pakices nga Albtelecom. Per nje diskutim me te detajuar dhe historikun e ecurise se tarifave per paketat Familjare dhe Te Tjere te Albtelecom, lexuesi mund ti referohet dokumentit te Analizes se telefonise fikse 2010, qe eshte e publikuar ne faqen e Internetit te AKEP www.akep.al ne seksionin Konsultime te Perfunduara.

Nderkohe ne vijim paraqitet krahasimi i tarifave te Albtelecom me vendet e rajonit dhe te BE si dhe pervoja ne vendet e tjera per ribalancimin e tarifave. Krahasimi eshte perqendruar ne paketen tarifore Familjare.

Krahasimi i tarifave te paketave standarte te Albtelecom me vendet e rajonit dhe BE-se⁹

Figura III.6: Ecuria e tarifës së pajtimit mujor Familjare: Shqipëri dhe SEE 2006-2012¹⁰



Burimi: Cullen International Report 3, April 2013

Figura e mësipërme paraqet ecurinë e tarifës së pajtimit mujor për kategorinë Familjare në vendet e rajonit SEE për 2006-2012, ndërsa Tabela III.3 paraqet tarifën e pajtimit mujor për paketat standarte dhe të përdorimit të vogël për Familjare si dhe pajtimin mujor Biznesin.

Tarifa e pajtimit mujor (me TVSH) në Shqipëri është më e ulëta ndërsa në vendet e tjera të rajonit varion nga 5.24 euro ne Serbi në rreth 9.91-10.15 Euro në Turqi dhe Kroaci dhe 10.8 euro ne Islande, nga ku rezulton se tarifa mesatare pa TVSH është 796 lek/muaj. Serbia ka pasur pajtimin mujor shumë më të ulët se në Shqipëri në 2006 por në vitin 2011 kjo tarifë është më e lartë. Bosnja Hercegovina në tre kontetë ka pajtim mujor 5.8-6.7 euro në muaj. Vendet si Kroacia, Turqia dhe Maqedonia kanë nivelet më të larta të pajtimit mujor 8-10 euro ne muaj, dhe këto nivele janë aplikuar që prej vitit 2005.

Ndërkohë nga të dhënat e tabelës së mëposhtëme dhe Figura III.7, vihet re pajtimi mujor në paketën standart për Familjare, shoqërohet me përfshirje të minutave falas, vlera monetare e të cilave varion nga 1.10 euro në Mal të Zi, në 6.6 euro në Turqi, ndërsa Kosova përfshin thirrje pa limit brenda rrjetit për pajtimin mujor 9.36 euro. Maqedonia dhe Islanda nuk përfshijnë thirrje brenda pajtimit mujor prej 7.64 dhe 10.8 euro përkatësisht. Gjithashtu në shumë vende përveç Turqisë dhe Islandës, ka edhe opsion për tarife për përdorim të ulët që varion nga 2.62 euro në Serbi në 4.68 euro në Kosovë. Mesatarisht tarifa standarte per

⁹ Krahasimi i tarifave ne kete seksion te Anlizes finale eshte bere sipas publikimeve te Cullen International Raport 2, Korrik 2012. Ne dokumnetin e konsultimit publik, krahasimi i referohej te dhenave te Raport1, Nentor 2011 te Cullen International.

¹⁰ Tarifat me pakicë të referuara në këtë seksion për familjare janë të shprehura në Euro me TVSH, ndërsa për Biznes paraqiten në Euro pa TVSH.

Familjare eshte rreth 8.2 Euro/muaj (me TVSH) duke pershire thirrje me vlere monetare rreth 2 euro/muja (me TVSH).


Tabela III.3. Tarifat e pajtimit mujor Familjarë dhe Biznes: Shqipëri dhe SEE 2012

Country	Standard residential monthly rental	Low usage residential monthly rental	Business monthly rental
Albania	€3.73	-	€11.25
Serbia	€5.24 (including €1.62 of calls)	€2.62 (including €1.62 of calls)	€4.44
Bosnia & Herzegovina	€5.8-€6.7 (including €2.3-€2.8 of calls)	€2.51 (including €1.6-€2 of calls)	€8.39 (including €1.9-€2.3 of calls)
Montenegro	€5.97 (including €1.10 of calls)	€3.04	€5.10
FYROM	€7.64	€4.21	€11.35
Croatia	€9.91 (including €2.28 of calls)	€4.95 (including €3.31 of calls)	€9.40
Kosovo	€9.36 (incl. unlimited local calls Mon-Fri)	€4.68	€17.99 (incl. unlimited local calls Mon-Fri)
Turkey	€10.15 (including €6.60 of calls)	-	€7.54 (including €5.69 of calls)
Iceland	€10.80	-	€10.30

Table O.1 - Monthly subscription fees

Burimi: Cullen International Report 2, July 2012


Figura III.7. Tarifa e pajtimit standart me minuta te perfshira (me TVSH)



Burimi: Cullen International Report 3, 2013

Figura e mëposhtme paraqet tarifat e pajtimit mujor te shprehura edhe ne PPP, ku vihet re se kjo tarife në Shqipëri është nën nivelin mesatar të BE edhe me PPP (CI komenton se është nen-kosto).

Figura III.7. Tarifa e pajtimit mujor Familjare në Euro dhe Euro/PPP: Shqipëri dhe SEE 2010¹¹



Burimi: Cullen International Report 2010

Nga të dhënat e figurave dhe tabelave të mësipërme për pajtimin mujor mund të evidentojmë se:


- Shqipëria ka nivelin më të ulët të pajtimit mujor madje edhe se Serbia që e ka pasur shumë më të ulët këtë tarifë në vitin 2006. Vlera e pajimit mujor në Euro e matur edhe me PPP është rreth 9 euro/muaj dhe është më e ulët se mesatarja e BE prej 15 euro/muaj;
- vendet më të zhvilluara dhe me progresin më të madh për anëtarisimin në BE, Kroacia, Turqia dhe Maqedonia kanë nivelet më të larta të pajtimit mujor 8-10 euro në muaj;
- tendenca e vendeve të tjera të SEE ka qënë dhe është për rritje të tarifës së pajtimit mujor. Në të njëjtën kohë në shumë vende aplikohen paketa me tarifa më të ulëta të pajtimit mujor për përdorim të ulët.

Tarifat e thirrjeve:

Figura 3 paraqet ecurinë e tarifave të thirrjeve lokale ne vendet e rajonit dhe krahasimin me mesataren e BE. Krahasimi është bërë duke matur shpenzimin për një thirrje lokale 3 minuta në kohën pik dhe e shprehur në euro me TVSH. Tarifa e thirrjeve lokale është më e ulët se mesatarja e BE dhe në Turqi dhe Kroaci, por më e lartë se në vende të tjera të rajonit. Ndërkohë kostoja minimale e një thirrje lokale është ndër më të ulëtat në rajon për shkak të tarifimit për sekondë.

¹¹ Te dhenat e tarifave me euro ne PPP jane per 2010. Megjithate tarifa e pajtimit mujor te Albtelcom nuk ka ndryshim nga 2010, ndersa ne 4 shtete te rajonit ka pasur rritje te tarifes nominale dhe ne 2 ka pasur renie (figura III.6).

Figura III.8. Kostoja e një thirrje lokale 10 minuta: Shqipëri dhe SEE 2006-2012 (euro me TVSH)





Burimi: Cullen International Report 3, April 2013

Figura 4 paraqet krahasimin e tarifave të thirrjeve kombëtare në distancë të gjatë (brenda rrjetit dhe drejt rrjetit celular) e matur me shpenzimet për një thirrje me kohëzgjatje 10 minuta. Tarifat e thirrjeve kombëtare si edhe thirrjet drejt rrjeteve celulare janë me të ulëta se mesatarja e BE por ndër më të lartat në rajon, megjithëse vihet re gjithashtu se tarifat e këtyre thirrjeve në Shqipëri kanë pasur reduktime të ndjeshme nga nivelet e mëparshme të tyre.

Figura 5 paraqet krahasimin e tarifave për thirrje ndërkombëtare duke matur shpenzimet për një thirrje 10 minuta drejt rrjeti fiks në MB (UK). Nga krahasimi vihet re se tarifat e thirrjeve ndërkombëtare në Shqipëri janë më të ulëta se niveli mesatar në vendet e BE dhe shumë më të ulëta se në vendet e tjera të rajonit, përveç Turqisë.


Figura III.9. Kostoja e një thirrje kombëtare 10 minuta: Shqipëri dhe SEE 2008-2012





Burimi: Cullen International Report 3, April 2013

Figura III.10. Kostoja e një thirrje ndërkombëtare 10 minuta drejt MB dhe SHBA: Shqipëri dhe SEE 2008-2012



Burimi: Cullen International Report 3, April 2013

Paketa te tjera tarifore

Albtelecom gjate kesaj periudhe 2010-aktualisht ka filluar te ofroje paketa te tjera tarifore me zgjedhje per pajitmtaret. Keto paketa jane fokusuar ne ofrimin e shportave te thirrjeve me nje tarife fikse si dhe ne ofrime te shportave me thirrje dhe akses ne Internet. Pershkrimi i disa prej ketyre paketave tarifore te Albtelecom eshte dhene ne vijim.

Paketat per telefonine fikse

Albtelecom duke filluar nga nentor 2010 ka filluar ofrimin e paketave Fol Fix, te cilat per nje pagese fikse mujore ofrojne minuta te perfshira ne pakete. Albtelecom aktualisht ofron dy paketa te tilla: **FolFix 1000 dhe FolFix 1500.**

Paketa **FolFix 1000** ofron 1000 minuta/muaj brenda rrjetit Albtelecom (çdo dite 00:00 – 23:59) per pagese mujore 1000lek/muaj me TVSH.

Paketa **FolFix 1500** ofron 1500 minuta/muaj brenda rrjetit Albtelecom, 30 minuta/muaj thirrje nderkombetare me shtete te Z.1 dhe 30 minuta/muaj me operatoret mobile (kombetar) per pagese mujore 1500lek/muaj me TVSH.

Per te dy paketat pajtimi mujor eshte i perfshire ne pagesen fikse dhe thirrjet e bisedave telefonike te tjera, dhe te trafikut mbi limitin e lejuar me lart, jane sipas tarifave te paketave standarte ne fuqi.

Albtelecom njekohesisht ofron paketa bundle te sherbimeve te telefonise fikse dhe aksesit ne internet, me nje cmim te vetem. Keto paketa permbajne ne nje pagese te vetme pajtimin mujor per telefonine dhe akses ne Internet dhe nje numer te caktuar thirrjesh telefonike (si paketat FolFix me lart).

Paketa **“Bundle 1999”** e aplikuar gjate periudhes 3 Janar – 31 Mars 2012, me pagese mujore *1,999 leke (me TVSH) perfshinte* sherbimin ADSL 2 mbps Unlimited dhe pajtimin mujor PSTN. Bisedat telefonike jane sipas tarifave standarte ne fuqi.

Paketa **I-Fiks 2399**qe eshte kombinim i paketes FolFix 1000 & ADSL 2 mbps Unlimited, me pagese mujore *2,399 leke (me TVSH) perfshin* 1000 min/muaj lokale, rajonale dhe kombetare brenda rrjetit Albtelecom 00:00–23:59 dhe sherbimin ADSL 2 mbps Unlimited.

Paketa **I- Fiks 3599**qe eshte kombinim i paketes FolFix 1500 dhe ADSL 4 mbps unlimited) , me pagese mujore *3,599 leke (me TVSH) perfshin* 1500 min/muaj thirrje brenda rrjetit Albtelecom, 30 minuta nderkombetare dhe 30 minut drej rrjeteve celulare kombetare si edhe sherbimin ADSL 4 mbps Unlimited.

Nga te dhenat e Albtelecom rezulton se numri i pajtimtareve Familjare qe kane marre keto paketa me zgjedhje deri ne fund te Qershor 2012 eshte afersiht 30% pajtimtareve Familjare dhe numri i pajtimtarve qe zgjedhin keto paketa ka tendenca rritjeje nga muaji ne muaj.

Tarifa te operatoreve te tjere

Nder operatoret alternative kryesore dhe konkurrues te Albtelecom permendim Abcom dhe AMC me sherbimin AMC Fiks.

Abcom:

Tabela III.4. Tarifat me pakice telefonike te Abcom 2012

Pajtimi Mujor	300 lek/muaj
Thirrjet telefonike drejt:	(lekë/minute)

numrave brenda rrjetit ABCOM	FALAS
numrave Fiks në Tiranë	3.5
numrave fiks të Shqipërisë (operatori Albtelecom/AMC fiks)	7.5
numrave fiks të Shqipërisë (operatorët Alternativ)	9.6
numrave Celularë (AMC/Vodafone/Eagle mobile)	22
numrave Celularë (Plus mobile)	34
Zona 1	8
Zona 2	20
Zona 3	25
Zona 4	30
Zona 5	50

TVSH është e përfshirë në të gjitha çmimet e mësipërme.

Abcom ofron paketen triple Play 3N1 (Internet+Televizion+Telefoni) e cila përfshin:

- Paketa DIGITALB Bazë
- Shërbim Interneti 2 Mbps.
- 1 Numër Telefoni + 500 lekë kohë bisede + Aparatin e telefonit Dhuratë, pa Tarifën e abonimit mujor.
- Pa Kosto Instalimi, vetëm Tarifë Regjistrimi.
- Për të gjitha abonimet 3N1, përfitoni Paketën Mikro TV dhuratë për TV-n e dytë + Dekoderin SD kundrejt vlerës të garancisë.

Të gjitha këto shërbime, me një pagesë të vetme **2.499 Lekë/muaj (me TVSH)**.

Tabela III.5. Tarifat me pakicë telefonike të AMC Fiks 2012

	Paketa		
	Bazë	Bazë+	Ekstra
Minuta falas drejt AMC Fiks	100 min/muaj	1000 min/muaj off-peak*	minuta pa limit**
Telefonata drejt AMC, rrjete fiks kombëtare dhe ndërkombëtare (zona 1)	-	-	30 min/muaj
Pajtimi mujor	299 lekë kontratë 1 vit	599 lekë kontratë 1 vit	899 lekë kontratë 1 vit
	249 lekë kontratë 2 vjet	499 lekë kontratë 2 vjet	699 lekë kontratë 2 vjet
Çmimi i aparatit	3500 lekë kontratë 1 vit	2000 lekë kontratë 1 vit	1000 lekë kontratë 1 vit
	1500 lekë	1000 lekë	Falës aparati me

	kontratë 2 vjet	kontratë 2 vjet	kordon 500 lekë aparati pa kordon për kontratë 2 vjet
--	-----------------	-----------------	---

Tarifat AMC Fiks (pas minutave falas të secilës paketë)	
Tarifa për telefonatë	0.5 lekë
Drejt AMC Fiks	2 lekë/min
Drejt rrjeteve fikse kombëtare	6 lekë/min
Drejt rrjeteve celulare kombëtare	20 lekë/min
Drejt rrjeteve ndërkombëtare	
Zona 1	12 lekë/min
Zona 2	30 lekë/min
Zona 3	60 lekë/min
Zona 4	150 lekë/min
Zona 5	540 lekë/min

Çmimi i aparatit dhe pajtimi mujor janë me TVSH, të gjitha tarifat e tjera janë pa TVSH.

Nderkohe pervec paketave te mesiperme me kontrate AMC ofron edhe paketa me parapagim per AMC Fiks, pra pa pajtim mujor.

Nga ecuria e tarifave vihet re se:

- Paketat standarte te Albtelecom nuk kane pasur ndryshime dhe kane probleme per orientimin ne kosto te tarifes se pajtimit mujor per Familjare dhe te disa tarifave te thirrjeve drejt destinacioneve te caktuara si drejt celulare;
- Tarifat e operatoreve alternative megjithese nuk kane qene ndonjehere nen-rregullim vihet re se karakterizohen nga pajtim mujor i ulet dhe tarifa te larta te thirrjeve telefonike, pra te ngjashme me paketen standarte Familjare te Albtelecom. Kjo mund te shpjegohet me dy arsye:
 - o Konkurrenca ne telefonine fikse eshte e modleit oligopol me nje kompani dominante dhe shume kompani te vogla qe ndjekin strategjine e kompanise leader;
 - o Konsumatorët jane me te interesuar ne shpenzime te vogla fikse per pajtim mujor dhe perdorim te ulet te thirrjeve telefonike fikse duke i dhene nje kontroll me madh per shpenzimet mujore (si tarifat me parapagim ne telefonine celulare).
- Albtelecom ka hedhur ne treg paketa te reja tarifore me zgjedhje dhe perzgjedhja e tyre nga nje numer i madh pajtimtaresh te Albtelecom tregon se ato jane me atraktive per perdoruesit se paketa standart. Tendenca e perdorimit te ketyre paketave eshte ne rritje dhe deri ne mesin e vitit 2012 ato perdoren nga rreth 30% e pajtimtareve Familjare te Albtelecom;

- Paketat tarifore te konkurrenteve kryesore te Albtelecom ne telefonine fikse permbajne paketa me pajtim mujor te ulet si dhe me tarifa te uleta brenda rrjetit si edhe paketa te integruara te telefonise, Internet dhe televizion.
- Perfshirja ne paketat e sherbimeve telefonike e sherbimit te aksesit ne Internet nga Albtelecom dhe nga operatore alternative, dhe perzgjedhja e tyre nga nje numer i madh pajtimtaresh tregon se konkurrenca midis operatoreve te telefonise fikse tashme nuk eshte vetem ne drejtim te sherbimeve telefonike por edhe me sherbimine Intrenetit.
- Evolimi i teknologjise dhe sjelljes konsumatore ne drejtim te paketave te integruara dhe te thjeshta (me perfshirje te minuatve ne pagese mujore) jane tregues se Albtelecom ndeshet me presion konkurrues nga operoret e tjere ne tarifimin e sherbimeve telefonike.

5. Perfitimet e perdoruesve fundore

Eshte bere e qarte edhe ne analizat pararendese qe ne tregjet me konkurrence efektive, perfituesit me te medhenj jane perdoruesit fundor, apo perfituesit e produkteve dhe sherbimeve , sic eshte ofrimi i nje game te gjere sherbimesh dhe cilesore, mundesite e zgjedhjes, dhe cilesia e informacionit per perdoruesit fundore.

Ne tabelen e meposhtme, paraqiten disa tregues konsumi mujor te thirrjeve te perdoruesve te Albtelecom. Perdorimi eshte matur sipas trafikut total dalese dhe hyres (thirrje te marra perfshijne edhe thirrjet brenda rrjetit Albtelecom, lokale dhe kombetare), pjestuar me numrin mesatar vjetor te perdorueve te Albtelecom. Rreshti i fundit paraqet totalin e minutave te komunikimit (Minutes of Usage-MOU) nga nje perdorues i Albtelecom, thirrje dalese dhe te marra.

Nga tabela vihet re se konsumi i thirrjeve dalese eshte ne trend zbrites pervec vitit 2010 ku eshte vene re rritje rritje ne thirrjet dalese totale si dhe ne thirrjet e marra (hyrese), e cila reflektohet edhe tek MOU.

Tabela III.6: Perdorimi mesatar mujor i sherbimeve te Albtelecom 2008-2012/1

	2008	2009	2010	2011	2012
Thirrje dalese¹²	164	136	151	116	106
Lokale dalese	136	112	112	88	79
Mobile	11	10	7	9	5
Kombetare drejt fiks	9	41	21	21	14
Nderkombetare	6	5	4	6	3
Thirrje te marra	191	181	204	160	152
MOU	355	317	356	276	258

Mesatarisht konsumi i thirrjeve te kryera ne gjashtemujorin e pare 2012 ishte 106 minuta ne muaj thirrje dalese si dhe 152 minuta ne muaj thirrje te marra, qe do te thote qe nje perdorues i Albtelecom gjate viti 2012 ka shpenzuar mesatarisht 258 minuta apo afersisht 4 ore ne komunikim me telefon fiks.

¹² Ne thirrjet dalese perfshihen edhe thirrjet drejt numrave te tjere jo-gjeografike.

Disa nga zhvillimet e tjera pozitive qe ndikojne ne drejtim te rritjes se perfitimeve te perdoruesve fundore te telefonise fikse:

- **Z(P)B:**

Mundesia e perdoruesve te Altelecom per perdorimin e Z(P)B per kryerjen e thirrjeve telefonike nepermjet bartesve te thirrjeve rrit perfitimet e tyre. Kjo mundesi tashme eshte e disponueshme prej fundit te vitit 2011, megjithate deri tani asnje operator nuk ka aplikuar per Kod Bartesi dhe perdoruesit e Albtelcom ende nuk kane filluar te nxjerrin perfitim nga ky sherbim;

- **LLU:**

Mundesia e perdoruesve te Altelecom per perdorimin e sherbimin LLU, per akseisn ne Internet dhe kryerjen e thirrjeve telefonike nepermjet operatoreve te tjere qe marrin akses ne rrjetin Altelecom per LLU, rrit perfitimet e tyre. Kjo mundesi tashme eshte e disponueshme prej mesit te vitit 2012, dhe perfitimet e perdoruesve te Altelecom nga kjo mundesi pritet te fillojne me lidhjen e marrveshjeve te operatoreve me Altelecom per LLU sipas ofertes RUO te miratuar nga AKEP me 31.05.2012.

- **Portabiliteti i numrit Fiks:**

Ky sherbim per telefonine fikse filloi te ofrohet prej muajit Shtator 2012. Kjo lehtesi i krijon mundesine pajtimtareve te Altelecom dhe te operatoreve te tjere qe te bartin numrin e tyre fikse drejt operatorit qe ata vleresojne si me atraktiv per sherbimet telefonike fikse, pa ndryshuar numrin e telefonit. Ashtu si edhe portabiliteti i numrit celular, implementimi i portabilitetit te numrit fikse do te rrise konkurrencen midis operatoreve dhe perfitimet e perdoruesve fundore.

Faktoret e mesiper m rrisin presionin konkurrues ndaj Altelecom duke ndikuar ne reduktimin e dominances se Altelecom per sherbimet telefonike me pakice te aksesit dhe thirrjeve telefonike.

Perfundim per FNT

Duke u bazuar ne analizen e kryer, AKEP vlereson se:

- Pjesa e tregut te Altelecom per aksesin (numri i pajtimtareve) dhe thirrjet telefonike nderkombetare ka pesuar reduktim dhe eshte ne nivele 70-75%, ndersa per llojet e tjera te thirrjeve telefonike, perfshire thirrjet ne total, pjesa e tregut eshte shume e larte mbi 85% dhe kjo ka qene e qendrueshme gjate 5 viteve te fundit. Gjithashtu edhe pjesa e tregut ne te ardhura nga sherbimet telefonike megjithese ka pasur renie eshte e larte ne nivel rreth 76%.
- Per sa i perket avantazheve te Altelecom ndaj operatoreve alternative qe vijne nga madhesia e Altelecom duket se megjithese Altelecom ka humbur pjese tregu dhe disa operatore alternative kane rritur ndjeshem numrin e abonenteve, Altelecom vazhdon te kete avantazhe ndaj operatoreve te tjere dhe keto avantazhe mund te rriten me migrimin e plote drejt NGN/NGA si duke qene prezent ne telefoni fikse dhe telefoi celulare njekoheisht.
- Konkurrenca e mundshme nga rritja dhe forcimi i pozitive te operatoreve kryesore alternative ne treg si dhe nga mundesite e perdoruesve fikse per te zevendesuar thirrje

fikse me thirrje nga celulare me tarifa te cilat jane ulur dhe po ulen ndjeshem, ndikon ne reduktimin e pozites dominuese te Albtelecom.

- Masat rregullatore te implementuara deri me tani si Z(P)B, portabiliteti i numrit fiks dhe LLU ndikojne ne rritjen e konkurrences ne treg dhe reduktimin e dominances se Albtelecom ne telefonine fikse.
- Paketat standarte te Albtelecom nuk kane pasur ndryshime ne 2010-aktualisht dhe kane akoma probleme per orientimin ne kosto te tarifes se pajtimit mujor per Familjare dhe te disa tarifave te thirrjeve drejt destinacioneve te caktuara si drejt celulare;
- Evolimi i teknologjise dhe sjelljes konsumatore ne drejtim te paketave te integruara dhe te thjeshta (me perfshirje te minutave ne pagese mujore) jane tregues se Albtelecom ndeshet me presion konkurrues nga operatoret e tjere ne tarifimin e sherbimeve telefonike.

Megjithatë faktoret që ndikojnë në reduktimin e dominancës së Albtelecom në tregjet me pakicë të telefonisë fikse, pjesët e tregut të Albtelecom në nivele 75%-85% për pajtimtardhje të ardhura dhe mbi 85% për thirrjet telefonike janë tregues të Albtelecom ka FNT e tregjet me pakicë të aksesit dhe thirrjeve telefonike.

Per sa me siper AKEP gjykon se sipermarresi Albtelecom sh.a. permbush kushtet per FNT ne tregjet perkatese:

- **Tregu i aksesit ne rrjet publik telefonik nga vendodhje fikse;**
- **Tregu i thirrjeve telefonike te vlefshme per publikun nga vendodhje fikse.**

IV. ANALIZA E TREGJEVE TE SHERBIMEVE ME SHUMICE: ORIGJINIMI, TRANZITIMI DHE TERMINIMI I THIRRJEVE NE RRJETET FIKSE

IV.1. Perkufizimi i tregjeve te interkoneksionit

Sherbimet ne nivelin me shumice jane sherbime te nevojshme per operatorët e rrjeteve fikse dhe celulare dhe ofruesit e sherbimeve qe te ofrojne sherbimet te telefonise perdoruesve fundore, pra ne nivelin me pakice. Ne perkufizimin e sherbimeve te telefonise fikse ne nivelin me pakice, ne kapitullin III, u be nje ndarje e ketyre sherbimeve ne akses dhe thirrje telefonike te disponueshme per publikun nga vendndodhje fikse. Ne nivelin me shumice sherbimet e nevojshme te operatoreve per te ofruar thirrje drejt rrjeteve te tjera jane origjinimi, terminimi dhe tranzitimi i thirrjeve te cilat jane elemente te nevojshme per te ofruar thirrje telefonike pajtimtareve te rrjeteve fiks, thirrje drejt pajtimtareve te rrjeteve fiks dhe per te vijuar thirrjet drejt ketyre pajtimtareve. Njekohesisht keto sherbime sherbejne si inpute edhe per ofrimin e thirrjeve nga rrjetet celulare drejt rrjeteve fikse.

Ne analizen pararendese te vitit 2010 AKEP ka bere perkufizimin e tregjeve perkates te terminimit, tranzitimit dhe origjinimit si me poshte


- **Tregu i terminimit te thirrjeve zanore ne rrjetin Albtelecom, sherbim i ofruar nga sipermarresi Albtelecom sh.a;**
- **Tregu i terminimit te thirrjeve zanore ne rrjetin publik alternativ fiks A¹³, sherbim i ofruar nga sipermarresi A sh.a;**
- **Tregu i origjinimit te thirrjeve zanore ne rrjetet fikse, sherbim i ofruar nga sipermarresit e rrjeteve publike fiks;**
- **Tregu i tranzitimit te thirrjeve zanore ne rrjetet fikse, sherbim i ofruar nga sipermarresit e rrjeteve publike fikse;**

Dimensioni gjeografik i tregjeve te terminimit, origjinimit dhe tranzitimit te thirrjeve zanore eshte zona operimit (mbulimit me rrjet) te operatorit perkates ofrues te sherbimit(territori i Republikës së Shqipërisë për Albtelecom).

Ne lidhje me segmentimin e tre sherbimeve terminim, origjinim dhe tranzitim AKEP ka perdorur skemen e meposhteme:

¹³ Cdo sipermarres qe eshte pajisur me autorizim te pergjithshem nga AKEP per ofrimin e rrjeteve publike telefonike fikse dhe eshte aktiv ne treg.

Figura IV.1: Skema e elementeve (inputeve) me shumice per realizimin e thirrjeve telefonike



Sipas skemes se paraqitur ne figure IV.1 elementet perberes te thirrjes telefonike mund te klasifikohen ne :

- origjinimi i thirrjeve (nga perdoruesi tek centrali lokal apo (RSU));
- tranzitimi i thirrjeve midis centraleve tranzite dhe nga centrali lokal ne central tranzit dhe central tranzit deri ne central lokal;
- terminimi i thirrjeve (centrali lokal tek perdoruesi).

Skema e mesiperme IV.1 paraqet elementet perberes te nje thirrje telefonike brenda rrjetit fiks. Ne rastet e interkonektimit me nje rrjet tjetër, operatori tjetër (fiks ose celular) ka nevojë për elemente të ndryshme në varesi të pikës së interkonektimit dhe destinacionit (origjinim - për bartësit e thirrjeve) të thirrjeve në rrjetin fiks. Rrjetet mund të interkonektohen për të terminuar dhe origjinuar thirrje midis njëri tjetrit ose drejt operatoreve të tjere (tranzitim).

Për një diskutim më të detajuar për perkufizimin e tregjeve perkates të terminimit/tranzitimit/origjinimit të thirrjeve në rrjetet fikse, lexuesi mund të referohet dokumentit të Analizes së telefonisë fikse 2010, që është e publikuar në faqen e Internetit të AKEP www.akep.al në seksionin Konsultime të Perfunduara. Në vijim paraqitet një diskutim mbi ndryshimet e ndodhura në 2010-2012 dhe të pritshme që mund të kenë një impakt në perkufizimin e tregjeve perkates.

Zhvillime pas Analize 2010 dhe zhvillime të pritshme në vitet në vijim

Ndër zhvillime që kanë ndodhur në këte periudhë 2010-2012 dhe që pritet të ndodhin në të ardhmen e afert dhe që mund të ndikojnë në perkufizimin e tregjeve të terminimit, origjinimit dhe tranzitimit në rrjetet fikse, mund të permendim:

1. Procesi i migrimit nga teknologjia PSTN/TDM drejt NGN/NGAe rjetit te Albtelecom;
2. ofrimi nga AMC i AMC Fiks dhe pajisja e Vodafone me numeracion Fiks per te ofruar sherbime telefonike fikse;
3. mosperfishirja ne tregun e terminimit te thirrjeve ne rjetet individuale celulare e terminimit te thirrjeve hyrese nderkombetare;
4. portabiliteti i numrit fikse


1. Procesi i migrimit nga teknologjia PSTN/TDM drejt NGN/NGA

Sipas informacionit te derguar nga Albtelecom ne Mars 2012 dhe komenteve te sjella per dokumentin e Analizes qe ishte ne konsultim publik, Albtelecom ka nje rjet te kombinuar me teknologjine TDM/PSTN dhe NGN/NGA. Rjeti i Albtelecom eshte i perbere nga 3 pjese:

- Rjeti qendror
- Rjeti transmetimit
- Rjeti aksesit

Nje skeme e ketyre rjeteve eshte dhene ne Figuren e meposhteme IV.1.

Figura IV.2: Skema e struktures kryesore dhe topologjia e rjetit Albtelecom



Burimi: Albtelecom sipas Pershkrimit te Rjetit te derguar ne AKEP ne Mars 2012

Nderkohe Albtelecom me 10.04.2013, ne komunikime me operatorët e interkonektuar ne rrjetin e tij si dhe ne kerkesen e derguar ne AKEP për amendimin e Ofertës Referencë të Interkoneksionit, ka kërkuar reduktim të numrit të pikave të interkoneksionit, bazuar në përfundimin e procesit të migrimit në rrjetin NGN. Megjithate, ne komentet per Analizen e tregut fiks si dhe dokumentacionin e derguar per kostot, citon se per nje periudhe tranzitore (deri ne 2015) do te vazhdoje interkoneksionin ne nivel TDM. Nderkohe vazhdimi i interkonektimit tradicional per trafikun zanor nga operatorët fiks incumbent dhe celular, edhe ne kushtet e migrimit te plote te rrjetit kryesor ne IP (pra NGN), eshte nje praktike e ndeshur edhe ne vende te tjera. BEREC dhe ITU kane publikuar dokumenta per implikimet e mundshme te NGN ne interkoneksion dhe ka modele te ndryshme te diskutuara per interkoneksionin dhe kalimin e tij nga interkonektim rrjetesh tradicionale ne interkonektim ne nivel IP apo kombinime te tyre. Ky ndryshim i menyres se interkonketimit me rrjetin NGN te Albtelecom eshte nje proces shume i rendesishem dhe do te duhet te diskutohet edhe me operatorët e tjere, pasi ai bart nje sere implikimesh ne menyren e interkonektimit, pikat e interkonektimit, menyren e pageses, cilesine e sherbimit, standartet e perdorura etj, dhe sic shprehet edhe vet Albtelecom kjo do te kerkoje nje periudhe tranzitore te bashkekzistences se te rrjetit NGN me interkonektimin ne nivel TDM.

Sic eshte shprehur edhe ne VKD nr.2325, date 28.06.2013, AKEP do të nisë një proces diskutimi me palët e interesuara për ndryshime të mundshme në interkoneksion që do të duhet të kryhen në të ardhmen, në kushtet e kalimit të plotë në rrjetin NGN/NGA të Albtelecom.

Procesi i migrimit ne NGN megjithese mund te kete efekt ne segmentet e vecanta te sherbimeve (lokal/njefish/dyfish) si dhe ne menyren e interkonektimit me SS7 apo IP, ai nuk ka impakt ne perkufizimin e tregjeve perkates te terminimit/tranzitimit/origjinimit te thirrjeve ne rrjete fikse, per sa kohe vazhdon modeli Calling Party Pays.

2. Nderkohe per sa i perket ofrimit nga AMC i AMC fiks, qe eshte ofrim sherbimi telefonik nga vendndodhje fikse, me numeracion fiks neprmjet rrjetit GSM, ky sherbim konsiderohet sherbim publik telefonik fiks, dhe terminimi i thirrjeve ne rrjetin AMC drejt numrave AMC Fiks si terminim i thirrjeve ne rrjet fiks. Duke qene se AMC ka filluar ofrimin e ketij sherbimi, pra eshte aktiv ne treg, ***terminimi i thirrjeve ne rrjetin AMC drejt numrave gjeografike AMC fiks perben treg perkates te terminimit te thirrjeve.***

Vodafone Albania ne menyre te ngjashme me AMC ka marre numra gjeografike fiks per te ofruar sherbim te ngjashem, por nuk eshte ende aktiv ne treg, dhe ne kete menyre ***terminimi i thirrjeve ne rrjetin Vodafone Albania drejt numrave fiks te Vodafone Albania nuk mund te konsiderohet se perben treg perkates ne kete moment kohor.***

3. AKEP ne analizen e tregut celular te vitit 2012, te miratuar me VKD nr.2118, date 4.07.2012, arriti ne perfundimin se terminimi i thirrjeve hyrese nderkombetare nuk eshte pjese e tregut perkates te terminimit te thirrjeve ne rrjetet individuale celulare. AKEP duke ndjekur praktikat e meparshme per trajtim te njejte rregullator te terminimit te thirrjeve gjykon se edhe per telefonine fikse duhet te ndiqet i njejti parim: ***terminimi i thirrjeve ne rrjetet individuale publike telefonike fikse nuk perfshin terminimin e thirrjeve hyrese nderkombetare.***
4. Implementimi i portabilitetit të numrave celularë ne 2011 u pasua me disa ndryshime nga AKEP ne ofertat reference te interkoneksionit te operatoreve celulare, ne lidhje me perkufizimin e terminimit te thirrjeve. Ofertat reference të interkoneksionit përmbanin

përcaktime të cilat identifikonin si abonent/pajtimtar të një rrjeti celular pajtimtarët që zotërojnë numeracion te alokuar nga AKEP operatorit perkates celular. Ndryshimet e kryera me 20.04.2011 ne ofertat reference hoqen kete lidhje abonent-numeracion si per opearatorin celular dhe per operoret e tjere qe inetrkonektohen me keta operatore. Ndryshime te tilla u reflektuan edhe ne oferten reference te Albtelecom. Implementimi edhe i portabilitetit fiks qe filloi ne Shtator 2012 nuk ndikon ne perkufizmin e tregjeve perkates te terminimit pervec ndryshime te perkufizmit te termit abonent/pajtimtar te operatorit X, i cili do te jete:

“Abonent/pajtimtar i rrjetit te Operatorit X”: abonentet/pajtimtarete e rrjetit Operatorit X qe:

1. Kane numer qe i perket serive numerike të alokuar nga AKEP Operatorit X, numer i cili nuk eshte portuar ne rrjetin e nje operatori tjetere, ose

2. Kane numer qe nuk i perket serive numerike te alokuar nga AKEP Operatorit X, por qe eshte portuar ne rrjetin e Operatorit X.

Dimensioni gjeografik i tregut

Si edhe ne analizat e meparshme ne lidhje me dimensionin gjeografik te tregut perkates, edhe e klete analize AKEP i referohet Udhezimit te KE, paragrafet 56, 59 dhe 60 qe citojne midis te tjerave se dimensionin gjeografik i tregut perkates perfshin zonen gjeografike ne te cilen operojne sipermarresit ofrues dhe kerkues te sherbimeve, zone e cila ka kushte te ngjashme te konkurrences, si dhe praktiken tradicionale te percaktimit te tregjeve te sherbimeve te komunikimeve elektronike ne baze te zonave te mbuluara nga rrjeti.

Operoret e rrjeteve te telefonise fikse ne baze te regjimit te autorizimeve te pergjithshme, kane te drejte te ofrojne sherbimet e tyre ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise. Megjithate vetem nje numer i vogel i ketyre operatoreve operojne ne te gjithe territorin e Shqiperise. Albtelecom dhe AMC jane te vetmit operatore te pajisur me numeracion gjeografik fiks per te gjithe territorin RSH, dhe si te tille tregjet perkates per keta dy operatore konsiderohen kombetare (edhe Vodafone eshte pajisur me numeracion gjeografik fiks per te gjithe territorin RSH, por qe nuk eshte ende aktiv ne kete treg). Perkufizimi i dimesionit gjeografik si territori i Republikes se Shqiperise nuk eshte nje perkufizim realist.

AKEP gjykon se *Dimensioni gjeografik i tregjeve te terminimit, origjinimit dhe tranzitimit te thirrjeve zanore eshte zona operimit (mbulimit me rrjet) te operatorit perkates ofrues te sherbimit (territori i Republikes se Shqiperise per Albtelecom dhe AMC)*.

Perfundim mbi tregjet perkates

AKEP vlereson se tregjet perkates te interkoneksionit ne rrjetet fikse jane:

- **Tregu i terminimit te thirrjeve zanore ne rrjetin Albtelecom, sherbim i ofruar nga sipermarresi Albtelecom sh.a;**
- **Tregu i terminimit te thirrjeve zanore ne rrjetin publik fiks te operatorit alternativ X, sherbim i ofruar nga sipermarresi X¹⁴;**

¹⁴Lista e operatoreve alternative eshte dhene ne Aneks 1.

- **Tregu i terminimit te thirrjeve zanore ne rrjetin publik AMC drejt numrave gjeografike te AMC (pajtimtareve AMC Fiks), sherbim i ofruar nga sipermarresi AMC sh.a.;**
- **Tregu i origjinimit te thirrjeve zanore ne rrjetet fikse, sherbim i ofruar nga sipermarresit e rrjeteve publike fikse;**
- **Tregu i tranzitimit te thirrjeve zanore ne rrjetet fikse, sherbim i ofruar nga sipermarresit e rrjeteve publike fikse;**

Dimensioni gjeografik i tregjeve te terminimit, origjinimit dhe tranzitimit te thirrjeve zanore eshte zona operimit (mbulimit me rrjet) te operatorit perkates ofrues te sherbimit (territori i Republikes se Shqiperise per Albtelcom dhe AMC) .

IV.2. Analiza per FNT e tregjeve te interkoneksionit

1 Terminimi i thirrjeve ne rrjetet fikse

Per te analizuar ekzistencen apo jo te fuqise se ndjeshme ne treg, neni 33 percakton nje sere kriteresh qe duhet te merren ne konsiderate. Sipas perkufzimit te tregjeve perkates te terminimit te thirrjeve ne rrjetet fikse, çdo operator fiks eshte monopolist ne ofrimin e sherbimit te terminimit te thirrjeve ne rrjetin e vet, dhe mund et konkludohet se secili prej tyre ka FNT. Megjithate, terminimi i thirrjeve eshte nje sherbim i cili i ofrohet operatoreve te tjere te rrjeteve, dhe per te arritur ne perfundimin se nje operator ka FNT, qe do te thote aftesi ndikuese ne percaktimin e cmimit te ketij sherbimi pavaresisht operatoreve te tjere apo konsumatoreve, eshte e rendesishme te analizohen edhe disa faktore te tjere qe ndikojne ne kete aftesi ndikuese.

Ne Analize 2007 dhe 2010, AKEP ka arritur ne konkluzionin se Albtelecom plotesonte kriteret per FNT ne tregun perkates te terminimit ne rrjetin e vet, ndersa operatoret alternative nuk plotesonin kriteret per FNT, megjithese secili operator rrjeti publik fiks zoteron 100% te tregut perkates (sipas perkufzimit). Arsyeya kryesore te ketij perfundimi ne dy analizat e meparshem ka qene fakti se secili prej operatoreve alternative ndeshet me fuqi te larte kundervepruese nga Albtelecom dhe operatoret celulare, qe rezultonte ne aftesi te ulet ndikuese te operatoreve alternative per tarifat e terminimit ne rrjetet e tyre.

AKEP si edhe ne analizat e meparshme per terminimin e thirrjeve (ne rrjete fikse dhe celulare) edhe ne ne kete analize ka trajtuar faktoret/kriteret e konsideruar me te rendesishem si pjeset e tregut, fuqia kundervepruese e blereseve te sherbimit dhe tarifimi i sherbimit te terminimit.

Pjeset e Tregut

Kontrolli 100% i rrjetit terminues nga secili ofruer i sherbimit te terminimit te thirrjeve ne rrjetin e tij, perben ne kete menyre edhe 100% pjese tregu, duke e identifikuar si monopolist ne ofrimin e ketij sherbimi. Ky percaktim mbi pjesen e tregut ne masen 100% nga secili operator i telefonise fikse ruan te njejten linje arsyetimi te perdorur edhe ne analizat pararendese ne 2007 dhe 2010. Pjesa e tregut te terminimit te thirrjeve drejt abonenteve te rrjetit nuk varet nga madhesia e rrjetit, pasi pavaresisht madhesises apo numrit te pajtimareve ne rrjet, secili operator eshte monopolist ne ofrimin e terminimit te thirrjeve drejt aboneteve te vet.

Pjesa e tregut prej 100% qe secili operator ka ne terminimin e thirrjeve ne rrjetin e tij, nuk pritet te ndryshoje pasi nuk ka as alternative teknike per zevendesimin e tij:

- Teknikisht nuk ka asnje mundesi per terminimin e thirrjeve nga nje rrjet A ne nje rrjet B pa nderveprimin e operatorit qe zoteron pajtimtarete drejt te cileve eshte destinuar thirrja.
- Barrierat e natyres teknike jane te paevitueshme per te mundesuar sherbimin e terminimit te nje rrjeti tjetere ne mungese te koordinimit dhe gjetjes se nje vije sjellje te perbashket ne negociatat qe mund te zhvillohen.

Percaktimin si monopolist ne ofrimin e sherbimit te terminimit te thirrjeve per cdo operator te telefonise fikse e gjejme edhe nga perkufizimi i tregjeve perkates te identifikuar ne seksionin e meparshem, sipas te cilit cdo operator fiks eshte monopolist ne ofrimin e sherbimit te terminimit te thirrjeve ne rrjetin e vet, dhe mund te konkludohet se secili prej tyre ka FNT.

Megjithate, terminimi i thirrjeve eshte nje sherbim i cili i ofrohet operatoreve te tjere te rrjeteve, dhe per te arritur ne perfundimin se nje operator ka FNT, qe do te thote aftesi ndikuese ne percaktimin e cmimit te ketij sherbimi pavaresisht operatoreve te tjere apo konsumatoreve, kjo e percakton si te rendesishme te analizohen edhe disa faktore te tjere.

Fuqia Kundervepruese dhe konkurrenca e mundshme ne tregun e terminimit

Sic u theksua me siper, ne Analize 2007 dhe 2010, AKEPka arritur ne konkluzioninoperatoret alternative nuk plotesonin kriteret per FNT, pasi secili prej operatoreve alternative konsidrohej se ndeshej me fuqi te larte kundervepruese nga Albtelecom dhe operatoret celulare, qe rezultonte ne aftesi te ulet ndikuese te operatoreve alternative per tarifat e terminimit ne rrjetet e tyre.

Nderkohe ne sjelljet e operatoreve alternative per ofrimin e sherbimit te terminimitne periudhen 2010-2012, edhe pse ne pesha te ndryshme ne raport me numrin e pajtimtareve ne rrjetet e tyre rezulton te jne shafqur problematika ndermjet rrjeteve te operatoreve alternative dhe rrjeteve te medha te cilet kane status me FNT ne tregun e terminimit. Keto problematika kane cuar ne mosmarreshje per tarifen e terminimit ne rrjetet e operatoreve alternative ne 2010-2012, te cilat kane gjetur zgjidhje jashte procesit te negocimit ndermjet ketyre rrjeteve, me procedura e mosmarrveshjeve nga AKEP. Mosmarrveshje te tilla me object traifen e e terminimit ne rrjetin e nje operatori alternative nuk ka pasur ne periudhat e meparshme.

Ne aspektin e vleresimit te negociatave vihet re se te gjithë operatoret alternative nuk konsiderohen si negociatore “pa peshe” ne percaktimin e tarifes se terminimit ne rrjetet e tyre, pasi rezulton se kjo tarife terminimi ne shumicen e rasteve eshte me larte se ne rrjetin e Albtelecom. Gjithashtu nga proceset e zgjidhjes se mosmarrveshjeve AKEP ka vene re se operatoret alternative ne disa raste kane aplikuar tarifa te ndrsyhme terminimi ne rrjetin e tyre me operatore te ndryshem: tarifa te ndryshe terminimi per thirrjet nga rrjetet celulare (madje edhe midis operatoreve te ndrsyhem celulare) dhe tarifa te ndrsyhme termimi per thirrjet nga Albtelecom apo thirrjet e tranzituara nga Albtelecom. Tarifa te tilla te ndryshme, perfshire edhe faktin se shpesh operatore te ndrsyhem alternative kane tarifa te ndryshme terminimi ne rrjtet e tyre, krijojne problem ne tarifimin e thirrjeve me pakice te operatoreve per thirrjet drejt rrjeteve fikse alternative.

Nje aspekt tjetër qe eshte vene re ne lidhje me tarifat e terminimit ne rrjetet e operatoreve alternative eshte se ato duke qene jashte rregullimit nuk duket se kane tendence drejt konvergences me tarifat e terminimit ne rrjetin Albtelecom, qe eshte edhe rekomandimi i KE.

Kohevonesa ne zgjidhjen e mosmarrveshjeve, sjell efekte negative si tek palet ne mosmarreshje, por edhe tek sherbimi ndaj pajtimtareve ne te dy rrjetet respective, pasi shpesh palet ne mungese te marrveshjes se nenshkruar nderpresin sherbimet e interkoneksionit me njera-tjetren.

Ekzistenca e:

- tarifave te ndryshme te terminimit ne rrjetete e operatoreve alternative per operatore te ndryshem origjinues (fiks dhe celulare);
- tarifa te ndryshme terminimi per operatore te ndryshem alternative;
- mos-reduktimi apo mos-eliminimi i asimetrise midis tarifave te terminimit ne rrjetet e operatoreve alternative dhe Albtelecom

jane tregues te aftesise ndikuse te operatoreve alternative ne tarifimin e terminimit ne rrjetet e tyre.

Ecuria e tarifave te terminimit ne rrjetet fikse

Struktura e tarifimit per sherbimin e terminimit ne rrjetin fiks te telefonise per Albtelecom vazhdon te ruaje segmentimin e meparshem (lokale, njefishte dhe dyfishte).

Terminim ne segment lokal: terminimi i thirrjeve qe dorezohen ne pike lokale interkoneksioni dhe terminohen tek perdoruesit e Albtelecom, serite numerike te te cileve i perkasin centralit lokal ne te cilen ndodhet pika e interkoneksionit.

Terminim ne segment njefish: terminimi i thirrjeve qe dorezohen ne piken e interkoneksionit rajonale dhe terminohen tek perdoruesit e Albtelecom, serite numerike te te cileve i perkasin centraleve lokale te lidhur me centralin rajonal ne te cilin ndodhet pika e interkoneksionit.

Terminim ne segment dyfish: terminimi i thirrjeve qe dorezohen ne piken e interkoneksionit dhe terminohen tek perdoruesit e Albtelecom serite numerike te te cileve i perkasin centraleve lokale te lidhur me nje central rajonal te ndryshem nga centrali rajonal ne te cilen ndodhet pika e interkoneksionit.

Tarifat e terminimit te thirrjeve ne rrjete fikse te Albtelecom dhe operatoreve alternative percaktohen ne marreveshjet e interkoneksionit, direkte dhe indirekte, te lidhura midis ketyre operatoreve dhe operatoreve celulare. Marreveshjet aktuale te interkoneksionit me Albtelecom jane lidhur ne baze te RIO te Albtelecom. Tabela me poshte paraqet tarifat e terminimit per Albtelecom dhe OA (kryesoret) aktualisht.

Ne tabelen me poshte gjendet nje krahasim i tarifes se terminimit ndermjet OA dhe Albtelecom (OA kryesore).

Tabela IV.1: Tarifat e terminimit te thirrjeve ne rrjetet operatoreve alternative dhe Albtelecom (2013)

Segmenti/operatori	Lokal	Njefish	Dyfish
Albtelecom	1.5	2.5	3.5
OA	1.95	3.25	3.5
		2.5	
		1.5/1.54	
AMC Fiks		1.5	
		2.5	

Shenim: Tarifat jane pa TVSH, ne lek/minute dhe ne shumicen e rasteve perfshijne edhe 0.83 lek/thirrje


Ne marreveshjet aktual te interkoneksionit me Albtelecom, 32 operatore aplikojne vetem segmentin njefish, 17 aplikojne segmentin lokal dhe njefish dhe 7 operatore aplikojne vetem segment lokal. Vetem nje operator aplikon tarifa simetrike me Albtelecom ne tre nivele dhe nje operator tjeter aplikon segment njefish dhe dyfish.

Nga te dhenat e tabelës vihet re se:

- operatorët alternative shpesh kanë tarifa të ndryshme sipas operatorit origjinal;
- operatorët alternative aplikojnë segmente të ndryshme një ose dy segmente terminimi
- asimetria e aplikuar OA-Albtelecom vazhdon të jetë 30% si edhe shumë vite më parë;
- AMC ofron vetëm një segment terminimi pavarësisht se është operator kombëtar dhe ka numeracion gjeografik në të gjithë RSH, si dhe ka aktualisht dy tarifa të ndryshme terminimi në rrjet për operatorë të ndryshëm.


Në tre figurat e mëposhtme, paraqitet ecuria e tarifave të terminimit në rrjetet fikse inkumbent në vendet e rajonit në tre nivelet e terminimit: lokal, njëfish dhe dyfish. Tarifat janë të shprehura në eurocent për TVSH dhe i referohen kohës peak.

Figura IV.3: Ecuria e tarifave të terminimit në rrjetet fikse inkumbent në SEE 2008-2012: segment lokal




Burimi: Cullen International, Report 3, April 2012

Figura IV.4: Ecuria e tarifave të terminimit në rrjetet fikse inkumbent në SEE 2008-2012: segment njëfish



Burimi: Cullen International, Report 3, April 2012

Figura IV.5: Ecuria e tarifave të terminimit në rrjetet fikse inkumbent në SEE 2008-2012: segment dyfish



Burimi: Cullen International, Report 3, April 2012

Nga te dhenat e mesiperme duhet mbajtur parasysh se:

- Kosova ka vetem nje tarife terminimi ne vleren 4 eurocent (5.48 lek/minute) dhe kjo duhet te jete pjese e figurave per segmentin lokal dhe dyfish (qe CI nuk e ka perfshire).
- Mali i Zi ka dy nivele tarifash lokal dhe njefish, dhe vlera e segmentit njefish (1.07 eurocent) duhet te perfshihet edhe ne segmentin dyfish (qe CI nuk e ka perfshire).
- Serbia ka reduktuar ndjeshem tarifat e terminimit ne tre segmentet por vetem per thirrjet fix-fix, ndersa per mobile-fix, tarifat e periudhes se fundit (aktuale) jane ato te Oct-09, shume me te larta se fix-fix.
- Turqia, Serbia dhe Kosova per terminimin e thirrjeve mobile-fix aplikojne tarifa me te larta se fix-fix te paraqitura ne figurat e mesiperme.
- Shumica e vendeve te rajonit aplikojne tarifa te njejta terminimi si ne rrjetet e operatorit incumbent dhe ne rrjetet e operatoreve alternative

Perfundime mbi FNT ne tregjet e terminimit:

Bazuar ne perfundimet e ketij seksioni:

- Secili nga Operatoret Alternativ ka 100 % pjese tregu ne sherbimine terminimit te thirrjeve zanore ne rrjetin e tij;
- Aplikimi i tarifave te ndryshme te terminimit ne rrjetet e operatoreve alternative ne varesi te operatoreve origjinues si dhe mbajtja e tarifave te terminimit mbi nivelin e tarifave te Altelecom per nje kohe te gjate tregon per mundesine e dominances individuale ne secilin nga rrjetet individuale per sherbimin e terminimit ne kete rrjet;

AKEP vlereson se Altelecom dhe te gjitha operatoret alternative, perfshire AMC jane operatore me FNT ne terminimin e thirrjeve ne rrjetet e tyre:

- *Altelecom sh.a. permbush kushtet per t'u shpallur sipermarres me FNT ne tregun e terminimit te thirrjeve drejt pajtimtareve te rrjetit fiks Altelecom;*
- *Sipermarresi X permbush kushtet per t'u shpallur sipermarres me FNT ne tregun e terminimit te thirrjeve drejt pajtimtareve te rrjetit fiks alternativ X;*

- *Sipermarresi AMC sh.a. permbush kushtet per t'u shpallur sipermarres me FNT ne tregun e terminimit te thirrjeve drejt pajtimtareve te AMC Fiks;*

Lista me operatoret alternative (te referuar me siper si Sipermarresi X) te percaktuar me FNT per terminimin ne rrjetet e tyre eshte dhene ne Aneks 1 te ketij dokumenti final te analizes. Lista hartuar duke u bazuar ne te dhenat e Rregjistrimit te Autorizimit te pergjithshem deri me 30.07.2013 si dhe te dhenat e rregjistrimit te AI per sipermarresit e pajisur me numeracion gjeografik Fiks deri me 30.07.2013. Pra sipermarresit qe percaktohen me FNT jane sipermarresit qe kane njoftuar per ofrim rrjeti public telefonik fiks (rrjet public fiks dhe telefoni fikse) sipas te dhenave te Rregjistrimit te AP deri me 30.07.2013 dhe qe njekohesisht jane pajisur me numeracion gjeografik fiks deri me 30.07.2013. Ky selektim eshte ne perputhje me selektimin e nxjerre ne konsultim publik, me ndryshimin qe lista eshte perditesuar deri me 30.07.2013, duke shtuar sipermarres te rinj dhe njekohesisht duke hequr ata qe jane ç'rregjistruar nga rregjistrimi i AP. Lista eshte kontrolluar edhe per daten e deklaruar te fillimit te sherbimit qe ajo te jete deri me 30.07.2013.

2 Origjinimi i thirrjeve ne rrjetet fikse

Pas identifikimit dhe perkufizimit te tregut te origjinimit te thirrjeve ne nivel te shumices ne rrjetet e telefonise fikse, percaktimit te aktoreve aktive qe bejne pjese ne kete treg, dimensionit gjeografik ku shtrihet ky treg, eshte e nevojshme te behet vleresimi i konkurrences ne kete treg si dhe analiza per FNT per te identifikuar ne se ka apo jo operator me FNT.

AKEP, identifikoi si operatore aktive qe ofrojne sherbimin e origjinimit te thirrjeve zanore ne rrjetet fikse te telefonise jane:

- Albtelecom sh.a;
- Operatoret Alternative te rrjeteve te telefonise fikse;
- AMC Fiks;

Sipas praktikës se ndjekur edhe ne analizat pararendese faktoret themelore qe do te merren ne konsiderate per te analizuar per FNT jane:

- Pjeset e Tregut;
- Fuqia Kundervepruese e blesves;
- Vleresimi i Konkurrences potenciale ne treg, nder te tjera, vleresimine nivelit te perqendrimit te tregut; kontrolli mbi infrastrukturen si dhe vleresimi mbi mundesite e ekzistences se barrierave ne kete treg, kriteret keto te cilat krijojne nje tablo me te qarte mbi nivelin konkurrences etj;

Pjeset e tregut

Pjeset e tregut perbejne padiskutim nje faktor themelor per identifikim te dominances ne nje treg, per te percaktuar ose jo FNT. Nje gje e tille eshte e percaktuar edhe ne udhezuesin e KE-se, sipas te cilit pjeset e tregut mbi 50%, jane tregues i padiskutueshem i dominances. Por gjithashtu ky kriter keshillohet te mos merret si i vetem, por te konsiderohet ne menyre kumulative se bashku me kriteret e tjere.

Pjeset e tregut per kete sherbim maten ne baze te thirrjeve te origjinuara nga operatoret e rrjeteve fikse. Ne baze te te dhenave te trafikut dales te operatoreve te rrjeteve fikse drejt

numrave gjeografike dhe jo-gjeografike jane perlogaritur pjeset e tregut te Albtelecom dhe te gjithë operatoreve alternative ne total, te cilat jane pasqyruar ne tabelen me poshte.

Tabela IV.3: Pjeset e tregut te origjinimit te thirrjeve ne rrjete fikse 2007-2012

	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Alternative	7%	7%	11%	6 %	8 %	11%
Albtelecom	93%	93%	91%	94 %	92 %	89%

Racionaliteti i perkufizimit te ketij tregu, si sherbim i ofruar ne treg, eshte se origjinimi i thirrjeve ne rrjet fikse perben nje treg te justifikueshem per nderhyrje ex-ante dhe ky sherbim eshte input i perdorur nga bartesit e thirrjeve per te ofruar thirrje telefonike pajtimtareve te rrjeteve fikse.

- *Pjesa e tregut e Albtelecom, ne nivelin rreth 90% dhe te qendrueshem ne vite, eshte tregues i qarte i aftesise ndikuese te Albtelecom ne kete treg.*

Nder faktoret/kriteret e tjere te rendesishem per t'u konsideruar jane konkurrenca e mundshme, fuqia kundervepruese e bleresve te sherbimit te origjinimit etj.

Nje faktor tjetër qe tregon tendencen drejt konkurrenca efektive apo jo eshte edhe treguesi i perqendrimit te tregut HHI¹⁵, ku niveli i larte i perqendrimit te tregut shpreh faktin se ka FNT.

Vleresimi i pjeses se tregut si dhe nivelit te perqendrimit te tregut, jane tregues dominancë ne kete treg dhe sherbejne si zanafille e vleresimit te dominancës, por gjithesesi per te percaktuar llojin e dominancës kerkohen te konsiderohen edhe faktore te tjere shtese qe vleresojne konkurrenca potenciale dhe fuqine e bleresve ne kete treg, te afte ose jo per te ushtruar FNT.

HHI per 2010 dhe 2011 eshte pothuajse i pandryshueshem afersisht 8872, nje tregues shume i larte qe shpreh nivelin e perqendrimit te tregut, tregues i matur mbi pjeset e tregut te origjinimit te thirrjeve.

Integrimi Vertikal

Pesha e cdo operatori dhe ndikimi ose jo me FNT, lidhet edhe me faktin ne se operatori eshte i integruar vertikalisht ose jo.

Albtelecom gjendet i integruar vertikalisht ne ofrimin e sherbimit te origjinimit te thirrjeve dhe rrjedhimisht, konsiderohet me ndikim ne kete treg.

Kjo perben nje tregues shtese te peshes se Albtelecom ne kete treg.

Fuqia Kundervepruese e Bleresve

Ekzistenca ose jo e fuqise kundervepruese te bleresve ne tregun e origjinimit te thirrjeve eshte nje faktor i rendesishem qe ndihmon zhvillimin e konkurrenca ne kete treg, pasi rritet mundesia e influencimit ne peracktimin e tarifave dhe si e tille gjykohet nje shtyese e rendesishme ne zhvillimin e negociatave qe favorizojne bleresin e produktit (thirrjeve te origjinuara).

¹⁵ Treguesi HHI matet si shuma e katrore te pjeseve te tregut.

Ne tregun e origjinimit te thirrjeve ne telefonine fikse, pesha e blesit te thirrjeve apo prezenca ose jo e fuqise kundervepruese identifkohet qartesisht nga ekzistenca ose jo e barteseve te thirrjeve CS apo C(P)S.

Por gjithesesi, ne lidhje me fuqine kundervepruese te blesve, mund te konkludohet qe eshte e paperfillshme ne kete treg, pasi Albtelcom ka kontroll te plote mbi linjat e aksesit ne kete treg, mundesite e infrastrukturave paralele me Albtelcom jane pothuajse te paperfillshme, keshtu qe natyrshem mund te vleresohet qe faktori i fuqise kundervepruese te blesve eshte i paperfillshem.

- *Albtelcom ne ofrimin e origjinimit te thirrjeve ne rrjetin e vet nuk ndeshet me fuqi kundervepruese nga operatore te tjere, dhe ne mungese te nderhyrjes se AKEP, Albtelcom nuk do te ofronte akses per origjinimin e thirrjeve.*

Zhvillime pas analizes 2010

Tregu i origjinimit te thirrjeve eshte konsideruar nder te tjera si nje mundesi per sherbimin e kartave me parapagim, te cilat konsiderohen nder te tjera edhe si mundesi per rritjen e konkurrences ne tregun e pakices per thirrjet telefonike. Per kete qellim edhe ne analizat pararendese eshte vene ne dukje rendesia e perkufizimit te bartesit te thirrjeve, duke e parashikuar dhe duke i perfshire edhe ne dokumente rregullatore dhe RIO-t perkatese si sherbimin e origjinimit te thirrjeve, gjithashtu edhe te drejten e zgjedhjes dhe parazgjedhjes se bartesit te thirrjeve.

Keshtu qe bazuar ne statusin me FNT te Albtelcom te percaktuar sipas analize 2010, si dhe detyrimet rregullatore per t'u implementuar ne periudhen post analize ka patur vendimarrje rregullatore ne kete drejtim dhe konkretisht:

- VKD nr. 1650 dt. 29.06.2011 "Për miratimin e dokumentacionit për implementimin dhe Rregulloren e Zgjedhjes dhe Parazgjedhjes së Bartësit"
- Rregullore Nr. 23 datë 29.06.2011 "Për Zgjedhjen e Bartësit dhe Parazgjedhjen e Bartësit".
- VKD Nr. 1778, datë 20.02.2012 "Për miratimin e tarifave te Albtelcom sh.a për ofrimin e shërbimeve te Zgjedhjes dhe Parazgjedhjes së Bartësit"

Konkluzioni paraprak ne tregun e origjinimit te thirrjeve:

Pas vleresimit te pjeses se tregut per Albtelcom , OA dhe AMC Fiks, rezulton se niveli i larte i pjeseve te tregut rreth 90% dhe qendrueshmeria ne vite e ketyre pjeseve ne treg, treg ne te cilin HHI eshte 8872, tregon pozicion dominues te Albtelcom ne kete treg.

Albtelcom eshte furnizues i tregut te origjinimit te thirrjeve ne nivel shumice, duke konsideruar edhe vetefurnizimin (vetofrimi i origjinimit te thirrjeve te nje operatori te integruar vertikalisht nga niveli me shumice ne nivel me pakice per thirrjet dalese te pajtimatreve te vet) i cili eshte pjese e ketij tregu.

Nga vleresimi i faktoreve te fuqise kundervepruese te blesve, si dhe vleresimeve mbi mundesite e zhvillimit te konkurrences ne kete treg, prezences se barrierave te hyrjes ne kete treg etj, AKEP gjykon se :

Albtelcom sh.a. permbush kushtet per t'u shpallur sipermarres me FNT ne tregun perkates te origjinimit te thirrjeve nga vendndodhje fikse.

3. Tranzitimi i thirrjeve ne rrjetet fikse

Tranzitimi i thirrjeve sherben per te lidhur dy rrjete qe nuk kane lidhje direkte me njeri-tjetrin apo kur kjo lidhje direkte nuk konsiderohet ekonomike nga palet. Per tranzitimin e thirrjeve kombetare Albtelecom aktualisht eshte operator me FNT dhe tarifat e tranzitimit kontrollohen dhe rregullohen nga AKEP. Sherbimi i tranzitimit kerkohet nga operatoret e rrjeteve fiks per te kompletuar thirrjet telefonike te perdoruesve te tyre drejt rrjeteve te tjera (jo te interkonektuar direkt).

Ne RIO-n e publikuar nga Albtelecom, perkufizmi i sherbimit te tranzitimit ne Albtelecom eshte si me poshte:

Sherbimi Tranzitimit te Albtelecom: Eshte percjellja e thirrjeve telefonike nga Albtelecom midis pikes se interkoneksionit me Operatorin Perfitues deri ne piken e Interkoneksionit te nje Operatori Tjeter Perfitues te cilet nuk jane te interkonektuar direkt midis tyre.

Tranzitim ne Segment Njefish Tranzitimi ne te cilin Pikat e Interkoneksionit midis Operatoreve te tranzituar nga Albtelecom ndodhen ne te njejten zone Rajonale te Rrjetit Albtelecom.

Tranzitim ne Segment Dyfish Tranzitimi ne cilin Pikat e Interkoneksionit midis Operatoreve te tranzituar nga Albtelecom ndodhen ne Zone te ndryshme Rajonale te Rrjetit Albtelecom.

Pjeset e tregut

Per te vleresuar ne se ka FNT ne tregun e tranzitit kombetar te thirrjeve ne rrjetet fikse, nje nder faktoret e marre ne konsiderate ka te beje me peshen e trafikut te tranzituar, apo pjesen e tregut.

Pjesa e tregut mbi 50% eshte nje tregues qe reflekton dominancane ne kete treg. Historiku i sherbimit te tranzitit kombetar edhe sipas analizes pararendese tregon per dominancane e padiskutueshme te Albtelecom ne raport me operatoret e tjere. Arsyet e dhena jane te lidhura kryesisht me faktin qe sherbimi i tranzitit kombetar kerkon investime me te medha se sherbimi i tranzitit nderkombetar.

Por ne dy vitet e fundit, pas ndryshimeve ligjore ne lidhje me sherbimin e tranzitimit gjenden edhe operatore te tjere qe mundesojne kryerjen e ketij sherbimi edhe pse kryesisht eshte i perqendruar si tranzit lokal dhe me pak i fokusuar ne segmente te tjera te tranzitimit (rajonal apo kombetar).

Bazuar ne te dhenat e evidentuara per sherbimin e tranzitimit kombetar nga Albtelecom dhe OA per vitet 2010-2012, rezulton qe pjesa e tregut te Albtelecom eshte reduktuar nga 95% ne 2010 ne 62% ne 2012.

Tabela IV.4: Trafiku kombetar i tranzituar nga Albtelecom dhe OA (2010-2012)

	2010	2011	2012
Albtelecom	95 %	87.5 %	62%
OA	5 %	12.5 %	38%

Pas heqjes se barrierave ligjore ne ofrimin e sherbimit te tranzitimit te thirrjeve kombetare, rezulton qe ne kete treg aktualisht jane futur edhe operatore te tjere alternative, te cilet ne

total kane mundur te rrisin pjeset e tyre te tregut. Kjo rritje vleresohet te kete ardhur nga zgjerimi i zonave te mbulimit te operatoreve alternative.

Megjithatë renien e pjeses se tregut, Albtelecom vazhdon te kete nivel te larte prej 62% pjese tregu per tranzitimin e thirrjeve kombetare.

Barriera per hyrjen ne tregun e tranzitit kombetar

Pavaresisht heqjes se barrierave ligjore per hyrjen ne tregun e tranzitimit te thirrjeve, gje e cila reflektohet edhe nga rritja e numrit te ofruesve te ketij sherbimi dhe rritja e pjeses se tregut te tyre, perseri ky treg ndodhet nen efektin e barrierave te rendesishme me natyre ekonomike, pasi mbulimi me infrastrukturen e nevojshme te territorit apo edhe zona te konsiderueshme per ofrimin e ketij sherbimi kerkon investime te medhe. Nje gje e tille nuk eshte e lehte, per me teper kur gjykohet nga investitoret si nje investim me kosto te pakthyeshme ne nje periudhe afatgjate. Megjithese disa operatore alternative kane zgjeruar zonat e mbulimit me rrjet, duke u krjuar mundesi per transit te thirrjeve kombetare, perseri mbulimi eshte me i vogel se rrjeti Albtelecom. Nje numer I mdh operatoresh alternative me presence te kufizuar gjeografike varen teresisht nga sherbimet e tranzitimit te Albtelecom per te kryer thirrje drejt rrjeteve te tjera fikse dhe celulare ne Shqiperi. Nje faktor i tille, krijon avantazh per Albtelecom si operatori kryesor dhe qe rrit aftesine dominuese te tij ne kete treg.

Fuqia Kundervepruese

Ne mungese te nderhyrjes rregullatore per te rregulluar sherbimin e tranzitit kombetar, aftesia qe operatori Albtelecom te demonstroje dominancen e tij do te ishte e padiskutueshme, kjo pasi mundesia qe zbehja e dominances se Albtelecom ne kete treg te vinte si rezultat fuqise kundervepruese nga palet blerese te ketij sherbimi do te ishte relativisht e vogel. Per rrjedhoje ky faktor do te ishte ne disavantazh te konkurrences efektive ne kete treg.

Konkluzioni per tregun e tranzitit kombetar

Pas vleresimit te pjeses se tregut per Albtelecom dhe OA, rezulton se megjithese niveli i pjeses se tregut te Albtelecom eshte reduktuar ndjeshem ne 2010-2012, ai eshte ende I larte ne 62% dhe avantazhet e Albtelecom ne madhesine e rrjetit (mbulim dhe presence gjeografike) ne raport me operoret e tjera fikse, numri I larte I operatoreve alternative me presence te kufizuar gjeografike, rrisin aftesine dominues te Albtelecom ne kete treg.

Nga vleresimi i faktoreve te fuqise kundervepruese te bleresve te ketij sherbimi, si dhe vleresimeve mbi mundesite e zhvillimit te konkurrences ne kete treg, prezences se barrierave te hyrjes ne kete treg etj, AKEP gjykon se :

Albtelecom sh.a. permbush kushtet per t'u shpallur sipermarres me FNT ne tregun perkates te tranzitimit kombetar te thirrjeve.

V. MASAT RREGULLUESE PER OPERATORET ME FNT

Ne baze te analizes se kryer per tregjet e telefonise fikse, rezulton qe ne dy nivelet e tregjeve te pakices dhe te shumices, ka sipermarres me FNT dhe konkretisht:

- **Sipermarresi Albtelecom sh.a** vleresohet se permbush kushtet per t'u shpallur me FNT ne tregjet perkates te meposhtem:

Tregje me pakice:

- *Tregu i aksesit ne rrjet publik telefonik nga vendodhje fikse (per pajtimtare familjare dhe jo –familjare);*
- *Tregu i sherbimeve publike telefonike te ofruara nga vendodhje fikse per pajtimtare familjare dhe jo –familjare).*

Tregje me shumice:

- *Tregu me shumice i terminimit te thirrjeve ne rrjetin publik telefonik Albtelecom te ofruar nga vendndodhje fikse.*
- *Tregu me shumice i origjinimit te thirrjeve ne rrjetin telefonik publik te ofruara nga vendndodhje fikse .*
- *Tregu me shumice i sherbimit tranzit kombetar ne rrjetet telefonike publike te ofruara nga vendndodhje fikse.*

- **Sipermarresi X** i rrjetit alternativ X vleresohet se permbush kushtet per t'u shpallur me FNT ne tregun e shumices te terminimit te thirrjeve zanore ne rrjetin e tij, konkretisht ne tregun:

- *Tregu me shumice i terminimit te thirrjeve ne rrjetin publik telefonik te operatorit X te ofruar nga vendndodhje fikse.*

- **Sipermarresi AMC Fiks** vleresohet se permbush kushtet per t'u shpallur me FNT ne tregun e shumices te terminimit te thirrjeve zanore ne rrjetin e tij, konkretisht ne tregun:

- *Tregu me shumice i terminimit te thirrjeve ne rrjet publik telefonike AMC drejt numrave gjeografike te ofruara nga vendndodhje fikse (per pajtimtaret e AMC Fiks).*

Ne baze te parashikimeve te ligjit 9918, **neni 34**,

Nëse AKEP-i përcakton se një ose disa sipërmarrës kanë fuqi të ndjeshme në treg, në tregun përkatës, pra nuk ka konkurrencë efektive, atëherë ajo vendos ndaj tyre një, disa ose të gjitha detyrimet e veçanta të nevojshme, të cilësuar në nenet 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45 e 56 të këtij ligji.

Ne analizen 2010 me VKD 1348 date 26.07.2010, AKEP shpalli me FNT sipermarresin Albtelecom sh.a dhe percaktoi nje set detyrimesh rregullatore te konsideruara proporcionale me problemet e identifikuar ne dy nivelet e tregjeve, te pakices dhe shumices.

Problemet kryesore te identifikuar ne tregjet e analizuara ishin:

- konkurrenca jo-efektive ne treg;
- tarifat jo te balancuara te Albtelcom: tarifa me te larta per disa sherbime dhe tarifa me te uleta per disa sherbime te tjera se niveli i tarifave qe do rezultonin ne nje treg me konkurrence efektive;
- mungesa e investimeve te mjaftueshme;
- mungesa e implementimit te masave rregullatore per CS dhe C(P)S;

Si probleme jo te lidhura me tarifat e interkoneksionit, pavaresisht qe Albtelecom kishte ne implementim percaktimet e RIO-se, gje qe shume prej problemeve te konsideruara si jo te lidhura direkt me tarifat e sherbimeve te interkoneksioni u gjykuan te arsyeshme te mbahen nen efektin e masave rregullatore dhe konkretisht probleme te tilla si:

- refuzimi per te dhene akses ne rrjet per sherbimet e interkoneksionit;
- vonesat per dhenien e aksesit;
- mosdhenie e informacionit;
- aplikimi i kushteve diskriminuese midis operatoreve te ndryshem;
- aplikimi i kushteve te padrejta ne marreveshje interkoneksioni.

Me qellim eliminimin e problemeve te mesiperme AKEP percaktoi edhe masat rregullatore ne reference me ligjin 9918, duke marre parasysh objektivat rregullatore qe detyrimet ndaj operatoreve me FNT duhet te jene proporcionale me masen e problemit dhe te mos jene barre e tepert per operatorin dhe konkretisht percaktoi:

- Detyrimin e mosdiskriminimit, sipas nenit 39 te ligjit nr. 9918.
- Detyrimin e transparencies, sipas nenit 40 te ligjit nr. 9918.
- Detyrimi për ndarjen e llogarive, sipas nenit 41 te ligjit nr. 9918.
- Detyrimin për akses dhe interkoneksion dhe përdorimin e përbashkët te faciliteteve te rrjetit, sipas nenit 42 te ligjit nr. 9918.
- Detyrimi per zgjedhjen e bartesit dhe parazgjedhjen e bartesit (neni 43)
- Detyrimin per kontroll te tarifave dhe sistemin e mbajtjes se llogarive, sipas nenit 45 te ligjit nr. 9918.

AKEP nder te tjera percaktoi ne menyre te detajuar per secilin nga detyrimet e mesiperme , elemente konkrete per detyrimin e mosdiskriminimit (Publikikimi RIO-s me ndryshimet perkatese), per detyrimin e kontrollit te tarifave ne dy nivelet e tregjeve (per dy kategorite e pajtimtareve per aksesin dhe thirrjet telefonike) si dhe tarifat e sherbimeve te interkoneksionit ne nivel shumice.

Nje sere prej ketyre detyrimeve u plotesuan me zbatimin e vendimit nr.1348, date 26.07.2010 si dhe vendimeve te tjera te AKEP si vendimet per implementimin e Z(P)B, dhe publikimin e RIO se Albtelecom dhe amendimet e kryera kohe pas kohe.

Nderkohe problemet qe vijne nga FNT ne tregjet e analizuara me shumice te terminimit jane te njejta me ato te pershkruara ne analizat e meparshme, si edhe problemet e pershkruara ne kete anlyze per terminimin ne rrjetet e operatorev alternative.

V.1. Masat rregullatore te propozuara per tregjet me shumice te interkoneksionit

1. Masat rregullatore te propozuara per Albtelecom

AKEP gjykon se problemet e tregjeve me shumice nga FNT e Albtelecom ruajne te njejten natyre me problemet e identifikuara nga analize 2010, keshtu qe ndaj operatorit me FNT Albtelecom propozohet qe detyrimet aktuale te qendrojne dhe te vazhdohet implementimi i tyre dhe konkretisht:

- 1. Detyrimi i Mosdiskriminimit (neni 39)**
- 2. Detyrimi i transparencës (Neni 40)**
- 3. Detyrimi për ndarjen e llogarive (Neni 41)**
- 4. Detyrimi për akses dhe interkoneksion dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit (Neni 42)**
- 5. Detyrimi per zgjedhjen e bartesit dhe parazgjedhjen e bartesit (neni 43)**
- 6. Detyrimi për kontroll të tarifave dhe sistemin e mbajtjes së llogarive (Neni 45)**

- Nenet 46 dhe 52 permbajne detyrime per sipermarresit me FNT ne lidhje me aksesin/interkoneksionin, ndersa 55-59, permbajne percaktime ne lidhje me detyrimet per kontrollin dhe rregullimin e tarifave dhe zbatimin e tyre.

- AKEP, gjykon se per te realizuar objektivat rregullatore te AKEP, te listuara ne piken 3 te nenit 7 te Ligjit 9918, per FNT per terminimin, origjinimin dhe tranzitimin e thirrjeve ne rrjetin Albtelecom, te gjitha masat e cituara jane te nevojshme per Albtelecom.

- Pervec detyrimeve te citura me siper, Albtelecom duhet te zbatojne dhe detyrimet e Ligjit 9918 per akses dhe interkoneksionin, perfshire afatet kohore te dhenies se ofertes se aksesit kerkuesve dhe dorezimin ne afat te MI-ve.

- Detajime te detyrimeve te operatoreve me FNT ne lidhje me interkoneksionin jane pjese e rregullores te Akses dhe Interkoneksionit.

- Ne lidhje me detyrimin per zgjedhjen e bartesit dhe parazgjedhjen e bartesit (neni 43), Albtelecom duhet te implementoje detyrimet e percaktuara nepermjet kuadrit rregullator te percaktuar nepermjet vendimarrjeve me reference si me poshte:

- VKD nr. 1650 dt. 29.06.2011 “Për miratimin e dokumentacionit për implementimin dhe Rregulloren e Zgjedhjes dhe Parazgjedhjes së Bartësit”
- Rregullore Nr. 23 datë 29.06.2011 “Për Zgjedhjen e Bartësit dhe Parazgjedhjen e Bartësit”.
- VKD Nr. 1778, datë 20.02.2012 “Për miratimin e tarifave te Albtelecom sh.a për ofrimin e shërbimeve te Zgjedhjes dhe Parazgjedhjes së Bartësit”

- Albtelecom duhet te publikoje gjithashtu marreveshje te Nivelit te Sherbimit (Service Level Agreement-SLA) si dhe Tregues Kryesore te Performances (Key Performance Indicators - KPI) per interkoneksionin sipas percaktimeve te Rregullores se Akses dhe Interkoneksionit.

- Zbatimi i detyrimit te ndarjes se llogarive dhe mbajtjes se llogarive (nenet 42 dhe 45) dhe zbatimi i detyrimit te orientimit ne kosto te tarifave te interkoneksionit (neni 59), nga Albtelecom, do te kryhet ne baze te percaktimeve te mevonshme te AKEP. Per zbatimin e

detyrimeve per AS/CA, AKEP ka filluar nje projekt me konsulence nderkombetare ne 2013 per hartimin e rregullave/udhezimeve per AS/CA, projekt i cili pritet te perfundoje ne fund te 2013.

Rregullimi i tarifave me shumice te interkoneksionit te Albtelecom

Albtelecom ne varesi te topologjise se rrjetit PSTN per efekt te anes funksionale per sherbimet e interkoneksionit, ka aktualisht te pefshira ne oferten reference te interkoneksionit 68 pika interkonesioni lokale, 12 rajonale dhe dy pika kombetare ne te cilat mundesohet interkonektimi per transportim trafiku, gje e cila ka bere te mundur qe edhe tarifimi i sherbimeve te interkoneksionit te kete segmentim (lokal, njefishte dhe dyfishte) per terminimin dhe origjinimin e thirrjeve, dhe (segment te njefishte dhe dyfishte) per tranzitim thirrjesh. Nje tarifim i tille sipas arkitektures aktuale te Albtelecom dhe detyrimeve te vendosura nga AKEP ne lidhje me pikat e interkoneksionit, eshte i lidhur jo vetem me tarifimin e sherbimeve te interkoneksionit (terminim, origjinim dhe tranzitim), por edhe me percaktimin e tarifave te thirrjes per perdoruesin fundor, ku aktualisht ka nje kategorizim lokal, rajonal dhe kombetar.

Per te vleresuar rregullimin e tarifave me shumice te interkoneksionit te Albtelecom ne periudhat e mevonshme, AKEP vlereson se eshte e rendesishme te merren ne konsiderate zhvillimet e ndodhura ne periudhen 2010-aktualisht si dhe pritshmerite per zhvillime te ardhshme. Nder keto zhvillime mund te permendim procesin e migrimit te rrjetit te Albtelecom nga PSTN/TDM drejt NGN/NGA, tendencen e struktures se tarifave me pakice te telefonise fikse, procesin e konsultimit publik te AKEP per rishikimin e planit te numeracionit gjeografik, si dhe njekohesisht komentet dhe kerkesat e Albtelecom te lidhura me keto procese si dhe per propozimin e AKEP te dhene ne konsultim publik te dokumentit te Analizes se tregut fiks.

Migrimi nga PSTN/TDM drejt rrjetit NGN/NGA

Nje nder ndryshimet e ndodhura ne 2010-2012 dhe qe ka vazhduar edhe ne 2013 eshte procesi i migrimit te rrjetit te Albtelecom nga topologjia tradicionale PSTN/TDM drejt rrjetit NGN/NGA. Ne seksionin e perkufizimit te tregjeve perkates AKEP theksoi se ky ndryshim nuk ndikon ne perkufizimin e tregjeve perkates por ne menyren e trajtimit te segmenteve te terminimit/tranzitimit/origjinimit si dhe menyren e interkonektimit TDM (SS7) dhe/ose IP.

Kalimi ne rrjetin NGN/NGA nder te tjera con ne menyre me te perqendruar te komutimit e trafikut si per trafikun e interkoneksionit edhe per trafikun e abonenteve te Albtelecom si dhe me e rendesishmja ne eliminimin e hierarkise se centraleve. Nje sere centralesh lokale/RSU eliminohen dhe komutimi i trafikut nuk ndjek rrjedhen e komutimit me TDM por perqendrohet ne nje apo dy pika ne rrjet dhe shperndahet tek abonentet duke shfrytezuar rrjetin NGN dhe transportimin ne nivel IP si dhe transportimi i te dhenave.

Sic eshte theksuar edhe me siper ne dokument, BEREC dhe ITU kane publikuar dokumenta per implikimet e mundshme te NGN ne interkoneksion dhe ka modele te ndryshme te diskutuara per interkoneksionin dhe kalimin e tij nga interkonektim rrjetesh tradicionale ne interkonektim ne nivel IP apo kombinime te tyre. Ky ndryshim i menyres se interkonketimit me rrjetin NGN te Albtelecom eshte nje proces shume i rendesishem dhe do te duhet te diskutohet edhe me operatoret e tjere, pasi ai bart nje sere implikimesh ne menyren e interkonektimit, pikat e interkonektimit, menyren e pageses, cilesine e sherbimit, standartet e

perdorura etj, dhe sic shprehet edhe vet Albtelecom kjo do te kerkoje nje periudhe tranzitore te bashkekzistences se te rrjetit NGN me interkonektimin ne nivel TDM.

Megjithese procesi i ndryshimit te menyres se interkonektimit me rrjetin NGN te Albtelecom do te jete objekt diskutimi me palet e interesuara, tendenca ketij procesi (si dhe ne vende te tjera) do te jete per reduktim te numrit te segmenteve te terminimit dhe te pikave te interkonektimit.

Tendenca e struktures se tarifave me pakice te telefonise fikse

Kalimi ne NGN/NGA dhe ndryshimi i struktures se kostove te komutimit te thirrjeve brenda rrjetit con ne reduktimin deri ne eliminimin e ndryshimeve te tarifave brenda rrjetit, duke cuar ne nje tarife te vetme apo maksimumi ne dy nivele: lokale dhe kombetare. Aktualisht Albtelecom ka tre nivele te tarifimit me pakice ne paketat standarte: lokale, rajonale dhe kombetare. Nga rishikimi i tarifave te paketave alternative te Albtelecom dhe tarifave te opeatoreve te tjere vihet re se tendenca eshte per tarifim te thirrjeve brenda rrjetit me nje segment. Nderkohe nga tarifat e opeatoreve alternative per thirrjet drejt Albtelecom vihet re se keto tarifa ne shumicen e rasteve jane ne ose te ndara me dy nivele (lokale dhe kombetare) ose edhe me nje nivel, pa bere dallim per vendodhjen e pales se thirrur.

Keto tendenca perbejne argument pro reduktimit te segmenteve te terminimit ne rrjetin Albtelecom.

Rishikimi i Planit te Numeracioni (ndarjes se Zonave te Numeracionit)

Pervec migrimit te rrjetit te Albtelecom nga PSTN ne NGN, nje faktor tjetër ndikues per rishikimin e segmenteve te terminimit, i diskutuar ne dokumentin e nxjerre ne konsultim publi ishte edhe inisiativa e AKEP per ndryshime te mundshme ne planin e numeracionit per ndarjen ne zona gjeografike, duke pare mundesine e reduktimit/bashkimit te disa zonave NDC ne nje te vetme. Kjo inisiative e AKEP ka ardhur per shkak te fenomenit te viteve te fundit ne lidhje me “zhdukjen e kufinjve gjeografike”, ne zonat shume afer qyteteve te medha ndermjet zonave urbane dhe rurale. Aktualisht jane rreth 170 zona te vecanta numeracioni e cila duket se perben pengese ne caktimin e numrave te pajtimtareve nga opearet. Per kete qellim si dhe efektet qe mund te sjelle kalimi ne NGN, AKEP ka kontaktuar gjate vitit 2012 eksperte te ITU-se per dhenie mendimi per arsyet e cituara me siper. AKEP ne muajin Shkurt 2013, nxorri per konsultim publik dokumentin “Ndryshime në Planin Kombëtar të Numeracionit”, ne te cilin jepet propozimi i AKEP per ndryshimet ne planin e numeracionit gjeografik si dhe arsyet kryesore per keto ndryshime.

Ndryshimet e propozuar perfshijne bashkimin e disa zonave gjeografike (locale) te numeracionion ne nje te vetme (rajonale), çka do te lejonte nje perdorim me fleksiibel te numeracionit nga opearet ne kushtet e reja te zhvillimeve te demografike dhe te tregut te komunikimeve elektronike ne Shqiperi.

Ky propozim (dhe zhvillimet e ndodhur qe arsyetojne ndryshimet) perben argument per reduktim te segmenteve te terminimit.

Per sa me siper AKEP ne dokumentin e nxjerre ne konsultim publik propozoi nje ri-konfigurim te segmenteve te terminimit (dhe tranzitimit/origjinimit per analogji) te Albtelecom duke marre ne konsiderate zhvillimet e ndodhura dhe te pritshme ne treg. Keto ndryshime u propozuan te kryhen duke imponuar sa me pak ndryshime per opearet e tjere dhe madje me synimin e perfitimit te reduktimit te kostove per keta opeare nga migrimi drejt NGN/NGA.

Ne dokumentin e Analizes se nxjerre ne Konsultim Publik, AKEP propozoi:

- Reduktimin e pershkallezuar te tarifave bazuar ne reduktimin e segmenteve per terminimin dhe origjinimin nga 3 ne 2 (duke filluar nga Dhjetor 2012) dhe ne fund me 1(ne Shtator 2014);
- Reduktimin e segmenteve te tranzitimit nga 2 ne 1 (duke filluar ne Dhjetor 2012);
- Vlerat mesatare te tarifave te terminimit ne vendet e BE dhe te rajonit por duke pasur parasysh se me migrimin drejt NGN kostot e terminimit reduktohen ndjeshem. Vlera ne fazen e fundit per terminimin/origjinimin u propozua te jete 1.03 lek/minute e njejte me tarifen aktuale mesatare ne vendet e rajonit per segmentin lokal dhe njekohesisht sa vlera mesatare e tre tarifave mesatare te segmenteve local, njefish dhe dyfish ne vendet e BE, e ponderuar me trafikun e terminuar ne Albtelcom ne 2011 (sipas tre segmenteve). Vlerat u propozuan te jene objekt rishikimi nga AKEP duke marre ne konsiderate kostot e Albtelcom qe duhet te perlllogariten nga Albtelcom¹⁶, ndryshimet e rrjetit dhe vlerat mesatare ne vendet e rajonit dhe te BE.

Tabela e meposhteme jep tarifat maksimale te terminimit, tranzitimit dhe origjinimit te thirrjeve ne rrjetin Albtelcom te propozuar nga AKEP ne konsultimin public te dokumentit te Analizes te publikuar ne Gusht 2012.

Tabela V.1: Vlerat maksimale te tarifave tarifave të terminimit, origjinimit dhe tranzitimit në rrjetin Albtelcom 2012-2014 (propozim Konsultim Publik)

	Aktuale- 30.11.2012	Faza I	Faza II	Faza III	Ndryshimi	
		1.12.2012- 31.08.2013	1.09.2013- 31.08.2014	1.09.2014-	Faza I/Aktuale	Faza III/Aktuale
Terminim – Origjinim (lek/minute)						
Lokal	1.50	1.34	1.19	1.03	-11%	-31%
Njefish	2.50	1.34	1.19	1.03	-46%	-59%
Dyfish	3.50	2.68	1.85	1.03	-24%	-71%
Tranzitim(lek/minute)						
Njefish	1.50	1.71	1.32	0.93	14%	-38%
Dyfish	2.50	1.71	1.32	0.93	-32%	-63%
Tarifë fikse për thirrje ¹⁷(lek/thirrje)						
Tarife per thirrje	0.83	0.53	0.38	0.23	-36%	-72%

Shenim: Tarifat jane pa TVSH.

¹⁶ AKEP ne kushtet e avancimit te Albtelcom per migrimin e rrjetit drejt NGN/NGA i ka kerkuar Albtelcom perlllogaritjen e kostove te sherbimeve te tij bazuar ne strukturen e re te rrjetit te tij

¹⁷ Aplikohet per terminimin, origjinimin dhe tranzitimin e thirrjeve.

Nderkohe pas konsultimit publik per dokumentin e Analizes, AKEP ka marre ne konsiderate komentet e paleve te intersuara dhe sidomos Albtelecom, informacionin e Albtelcom per kostot dhe kerkesen e Albelecom per rishikim te RIO, te cilat pershkruhen me poshte.

Komentet e Albtelecom per konsultimin Publik

Ne komentet per analizen e tregut ne konsultim publik, Albtelecom ka theksuar ndermjet te tjerave se:

- Reduktimi i segmenteve te terminimit nga 3 ne 2 duhet te kryhet ne nje afat me te mevonshem se Dhjetor 2012 i propozuar nga AKEP dhe se kalimi ne 1 segment duhet te diskutohet ne 2015 dhe jo te hyje ne fuqi ne 2014;
- Pavaresisht migrimit ne NGN/NGA do te kete nevojte per nje periudhe tranzitore per bashkekzistence te NGN dhe TDM per interkoneksionin dhe kalimi ne 1 segment duhet te kryhet pas testimit te plote te NGN;

Depozitimi nga Albtelecom i Kostove te Sherbimeve

Albtelecom ne zbatim te kerkeses se AKEP (komunikimet e AKEP me Albtelecom ne periudhen Mars-Qershor 2012) per perlllogaritjen e kostove te sherbimeve te ofruara prej tij duke marre ne konsiderate edhe ndryshimet e ndodhura ne rrjetin Albtelecom, me date 5.11.2012 ka depozituar ne AKEP dokumentin "Top down cost model of Albtelecom network". Nepermjet shkreses shoqeruese "Paraqitja e kostove te sherbimeve te Albtelecom", Albtelcom sqaron se ka perlllogaritur kostot e sherbimeve te tij me konsulente nderkombetare dhe ne dokumentin e dorezuar ka dhene pershkrim te modelit te perdorur per keto perlllogaritje. Pra Albtelecom ne zbatim te pikes 1 te nenit 59 te ligjit 9918, perpiqet te provoje qe tarifat e sherbimeve te ofruara prej tij jane rrjedhoje e kostove eficente, duke mundesuar nje norme te arsyeshme fitimi.

Albtelecom ne dokumentacionin e depozituar shprehet se kostot jane perlllogaritur me model Top Down LRIC dhe FAC nga kompani konsulente nderkombetare. Dokumenti "*Top down cost model of Albtelecom network*" jep detaje te modelit te kostove dhe perlllogaritjeve te tyre. Albtelecom shprehet se modeli eshte "Top Down" pasi perdor kostot aktuale (2011) te Albtelecom per perlllogaritje e kostove te produkteve/sherbimeve te vecanta. Dokumenti citon se modeli ka perlllogaritur kostot per 2011 bazuar ne kostot dhe sherbimet e 2011 dhe se modeli eshte ndertuar per te zbatuar rekomandimet e KE¹⁸ dhe ERG¹⁹. Njekohesisht dokumenti permban edhe analiza ndjeshmerie per perlllogaritje kostoje per 2012 (bazuar ne ndryshime te kerkeses) si dhe me zhvillimin e NGN. Sherbimet e modeluara jane sherbime me shumice dhe me pakice.

Zbatimi nga Albtelecom i detyrimit te mesiperm, solli zbatimin e pikes 5 te nenit 59 te ligjit 9918, sipas te ciles, ne raste te tilla (kur operatori depoziton kostot e llogarituar), AKEP, ose

¹⁸ Source: THE COMMISSION OF THE EUROPEAN COMMUNITIES (September 2005) - COMMISSION RECOMMENDATION of 19 September 2005 on accounting separation and cost accounting systems under the regulatory framework for electronic communications (2005/698/EC)

¹⁹ Source: ERG (2005) - ERG COMMON POSITION: Guidelines for implementing the Commission Recommendation C (2005) 3480 on Accounting Separation & Cost Accounting Systems under the regulatory framework for electronic communications (ERG (05) 29)

një ekspertizë e kualifikuar e pavarur, e përzgjedhur nga AKEP-i, ka të drejtë të kryejë auditimin (verifikimin) vjetor të përputhshmërisë me sistemin e llogaritjes së kostos.

AKEP me Urdherin nr. 908, date 16.11.2012, ngriti një Grup Pune me eksperte të AKEP për “Shqyrtimin e dokumentit të sipërmarrësit Altelecom sh.a. mbi kostot e shërbimeve”. GP ka shqyrtuar dokumentacionin e paraqitur nga Altelecom, ka kërkuar informacione dhe dokumente shtese si dhe ka zhvilluar një takim me Altelecom dhe konsulentin e Altelecom me 11.02.2013. Për verifikimin e kostove të paraqitura nga Altelecom, GP i është referuar rekomandimeve të KE, ERG/IRG dhe BEREK dhe praktikave me të mira për AS/CA, apo me specifikisht për kostot TD LRIC të cilat janë përgatitur nga Altelecom. GP, gjykoj se sqarimet e dhena në dokumentacion si dhe në takim dhe në informacionin shtese të dërguar nga konsulenti i Altelecom, nuk janë bindese për të vërtetuar se modeli dhe rezultatet e modelit të paraqitur nga Altelecom, paraqesin kostot efiçente të ofrimit të shërbimeve të Altelecom.

Kërkesa e Altelecom për rishikim të RIO

Në kërkesën e tij me 10.04.2013, Altelecom ka kërkuar që në kuadër të përfundimit të migrimit të rrjetit në NGN/NGA të ketë vetëm dy pika interkoneksioni në Tiranë dhe Durrës, duke eliminuar pikat e tjera të interkoneksionit lokal dhe rajonale dhe se segmentet aktuale të terminimit lokal/rajonal të aplikohen vetëm në këto dy zona ndërsa për të tjerat të aplikohet terminim dyfish dhe detyrimi për interkonektim vetëm në këto dy pika. Kjo kërkesë e Altelecom nuk u pranua nga AKEP nëpërmjet vendimit Nr. 2325, datë 28.06.2013. Disa nga arsyet kryesore janë dhënë më poshtë.

Përfundim për Tarifën me shumicë nen-rregullim të Altelecom

Duke marrë në konsideratë gjithë faktorët e mësipërm, AKEP gjykon se:

- Pavarësisht migrimit të plotë në rrjetin NGN të Altelecom, për një periudhë tranzitore deri në kalimin e plotë në interkonektim në nivel IP, do të ketë bashkëzistencë të dy rrjeteve PSTN/TDM dhe NGN/NGA dhe sic është theksuar më parë në këtë dokument ky është një konstatim i Altelecom dhe praktike edhe në vende të tjera.
- Ndryshimet që duhet të kryhen në interkoneksion për kalimin e plotë të tij në nivel IP kanë një sërë implikimesh që do të duhet të diskutohen edhe me operatorët e tjerë në treg, të tilla si mënyra e interkonektimit (TDM-IP; IP-IP etj), pikat e interkonektimit, mënyrën e pagesës (CPP/RPP/Bill and Keep), çelësine e shërbimit, standartet e përdorura etj.
- Reduktimi i segmenteve të terminimit/origjinimit nga 3 në 2 si dhe tranzitimit nga 2 në 1 mund të kryhen duke filluar nga 1 Janar 2014 nënkohë kalimi në 1 segment terminimi/origjinimi do të diskutohet edhe me lojtarët e tregut dhe në kuadër të ndryshimeve në interkoneksion për kalimin në nivel IP.
- Vlerat e tarifave të interkoneksionit të Altelecom të jenë sipas vlerave të propozuara në konsultim publik, duke eliminuar fazën e tretë ku arrihej me një segment si dhe duke zhvendosur në kohë Fazën I dhe II. Faza I do të fillojë me 1.01.2014.

Tabela V.1/1: Vlerat maksimale te tarifave tarifave të terminimit, origjinimit dhe tranzitimit në rrjetin Albtelecom 2013-2015 (Finale)

	Aktuale- 31.12.2013	Faza I	Faza II	Ndryshimi	
		1.01.2014- 31.08.2014	1.09.2014- deri ne nje Vendim tjetër te AKEP	Faza I/Aktuale	Faza II/Aktuale
Terminim – Origjinim (lek/minute)					
Lokal	1.50	1.34	1.19	-11%	-21%
Njefish	2.50	1.34	1.19	-46%	-52%
Dyfish	3.50	2.68	1.85	-24%	-47%
Tranzitim(lek/minute)					
Njefish	1.50	1.71	1.32	14%	-12%
Dyfish	2.50	1.71	1.32	-32%	-47%
Tarifë fikse për thirrje ²⁰(lek/thirrje)					
Tarife per thirrje	0.83	0.53	0.38	-36%	-54%

Shenim: Tarifat jane pa TVSH.

Procesi i reduktimit te segmenteve shoqerohet edhe me reduktimin e pikave te Interkoneksionit duke eliminuar nevojën per interkonektim ne pike lokale interkoneksioni. Albtelecom do te kete detyrimin te ruaje/vazhdoje te jape akses per interkoneksion ne 12 pikat rajonale dhe 2 pikat kombetare te interkoneksionit por jo ne 68 pikat lokale te interkoneksionit.

Reduktimi i pikave te interkoneksionit te Albtelecom (eliminimi i pikave lokale) nuk do te jete barre per operatorët alternative pasi:

- Aktualisht bazuar ne RIO-n e Albtelecom cdo operator duhet te jete i lidhur ne te pakten nje nga 12 pikat rajonale ose ne nje nga 2 pikat kombetare te interkoneksionit, me qellim qe te dergoje trafik drejt te gjithë abonenteve te Albtelecom dhe rrjeteve te tjera.
- 12 pikat rajonale te interkoneksionit do te sherbejne si pika lokale interkoneksioni per te derguar trafik drejt te gjithë abonentve te zones rajonale (te rajonit perkates) me tarife terminimi lokal (nga terminim segment njefish me pare) dhe ne segment dyfish per pajtimtaret jashte ketyre zonave rajonale (pra si me pare).

²⁰Aplikohet per terminimin, origjinimin dhe tranzitimin e thirrjeve.

2. Masat rregullatore te propozuara per terminimin ne rrjetet e OA dhe AMC Fiks

AKEP ka vleresuar nepermjet analizes, gjetjen me FNT operatoret alternative per sherbimin e terminimit te thirrjeve ne rrjetet e tyre. Arsyet e detajuara dhe vleresimi per FNT eshte dhene ne seksionin perkates.

Bazuar ne problematiken e evidentuar me tarifat e aplikuara nga operatoret alternative, kushtet e tregut te telefonise fikse si dhe nga pervoja ne vendet e rajonit dhe te BE, AKEP gjykon qe masat rregulluese ndaj operatoreve Alternative te jene:

1. **Detyrimi i Mosdiskriminimit (neni 39)**
2. **Detyrimi i transparencës (Neni 40)**
3. **Detyrimi për akses dhe interkoneksion dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit (Neni 42)**
4. **Detyrimi per kontroll tarife**

Detyrimi i mosdiskriminimit perfshin ndalimin e aplikimit te tarifave te ndryshme te terminimit te thirrjeve hyrese kombetare per operatore te ndryshem kombetar origjinues te thirrjeve te terminuara ne rrjetin e operatorit alternativ. Pra nepermjet kletij detyrimi nje operator alternativ nuk mund te aplikojte tarifa te ndryshme terminimi per operatore te ndryshem si celulare ashtu edhe fikse. Operatoret alternative nuk kane detyrimin te publikojne oferte reference interkonesioni.

Detyrimi i transparences perfshin publikimin nga operatori alternative te tarifes/tarifave te terminimit ne rrjetin e tij si dhe te adreses se pikes se interkoneksionit me kete rrjet. Ne kushtet e mos-vendosjes se detyrimit per publikim RIO ky detyrim gjykohet i nevojshme per zbatimin e mos-diskriminimit ne tarifa.

Detyrimi i dhenies akses per interkoneksion eshte detyrim qe operatoret rrjeteve publike telefonike te japin akses per terminim ne rrjetet e tyre me qellim realizimin e interkoneksionit te rrjeteve publike telefonike.

Per sa i perket detyrimit te kontrollit te tarifes, AKEP ne dokumentin e nxjerre ne konsultim publik, propozoi qe tarifat e terminimit te operatoreve alternative dhe AMC per AMC Fiks te rregullohen sipas vlerave te tabelave te meposhtme (te lidhura me propozimin per tarifat e Albtelecom):

Tabela V.2: Vlerat maksimale te tarifave të terminimit ne rrjetet e operatoreve alternative fikse 2012-2015(propozim Konsultim Publik)

	Aktuale- 30.11.2012	Faza I	Faza II	Faza III	Faza IV
		1.12.2012- 31.08.2013	1.09.2013- 31.08.2014	1.09.2014- 31.08.2015	1.09.2015
OA qe aktualisht tarifojne me dy					

segmente(lek/minute)					
Lokal	1.95	1.68	1.43	1.20	1.03
Njefish	3.25	3.16	2.11	1.20	1.03
OA qe aktualisht tarifojne nje segment (lek/minute)					
Dyfish	2.50	2.42	1.77	1.20	1.03
Tarife fikse për thirrje (lek/thirrje)	0.83	0.53	0.38	0.23	0.23

Shenim: Tarifat jane pa TVSH.

Tabela V.3:Vlerat maksimale te tarifave të terminimit ne rrjetin AMC per thirrjet drejt AMC Fiks 2012-2014(propozim Konsultim Publik)

	Aktuale- 30.11.2012	Faza I	Faza II	Faza III
		1.12.2012- 31.08.2013	1.09.2013- 31.08.2014	1.09.2014-
Terminimi per operatoret qe paguajne aktaulisht 1.5 lek/minute	1.50	1.43	1.20	1.03
Terminimi per operatoret qe paguajne aktualisht 2.5 lek/minute	2.50	1.43	1.20	1.03

Shenim: Tarifat jane pa TVSH.

Bazuar ne ndryshimet e vendosura per tarifat e Albtelecom, AKEP gjykon qe fazat e rregullimit te tarifave te terminimit per operatoret alternative dhe per AMC (AMC Fiks) te ndryshohen duke i bere te njejta me ato te Albtelecom. Nderkohe per vlerat e tarifave te terminimit ne fazat e rregullimit, AKEP gjykon te arsyeshme te kryeje disa ndryshime nga ato te paraqitura ne Konsultim Publik ne tabelat e mesiperme. Vlerat e tarifave te terminimit per tu aplikuar nga operatoret alternative dhe nga AMC per terminim ne AMC Fiks jane dhene ne tabelat e mepostheme.

Ndryshimet nga konsultimi public per OA jane te tilla:

- Per operatoret qe aplikojne tarife terminimi ne vlerat 1.5-1.95 lek/minute, keto vlera do te vazhdojne deri me 31.12.2013 dhe me pas ne fazen e I dhe te II ato do te konvergojne ne nje vlere (qe ne fazen I) dhe do te jene 1.50 dhe 1.34 lek/minute respektivisht ne fazen I dhe II. Keto vlera jane te njejta me tarifen e terminimit ne segment lokal te Albtelecom aktualisht dhe me tarifen ne fazen e pare te rregullimit per Albtelecom. Ne kete menyre tarifat e operatoreve alternative do te shkojne me lehtesisht drejt konvergimit me tarifat e

Albtelecom. Kjo praktike eshte ndjekur nga AKEP edhe per reduktimin e pershkallezuar te tarifave te terminimit te operatoreve celulare.

- Per tarifate e terminimit ne rrjetet e operatoreve alternative qe jane ne nivele 2.5-3.25/3.5 lek/minute vlerat e tyre do te konvergojne ne 2.42 lek/minute ne fazen e pare dhe 1.77 lek/minute ne fazen e dyte. Keto vlera jane ato te publikuara ne konsultim publik per operatoret qe aplikojne nje segment tarifimi.
- Ndryshimet e kryera tentojne qe te eliminojne problemin e evidentuar ne kete analize per aplikim te tarifave te ndryshme te terminimit sipas operatorit origjinues dhe njekohesisht te reduktojne asimetrine me tarifate e Albtelecom qe po reduktohen per nje konvergjenca dhe thjeshtezim te tyre ne te ardhmen.

Tabela V.2/1: Vlerat maksimale te tarifave të terminimit ne rrjetet e operatoreve alternative fiks 2013-2015(Final)

	Aktuale- 31.12.2013	Faza I	Faza II
		1.01.2014- 31.08.2014	1.09.2014- deri ne nje Vendim tjetër te AKEP
Tarifa lek/minute			
Lokal	1.5-1.95	1.50	1.34
Mesatare-Njefish/dyfish	2.5-3.25/3.5	2.42	1.77
Tarifë fikse për thirrje (lek/thirrje)	0.83	0.53	0.38

Shenim: Tarifate jane pa TVSH.

Tarifate e mesiperme jane tarifa maksimale per tu aplikuar nga operatoret e percaktuar me FNT te listuar ne Aneks 1 te ketij dokumenti final te analizes. Per Operatore te tjere qe mund te njoftojne per fillim sherbimi telefonik fiks dhe qe mund te marrin numeracion fiks pas dates 30.07.2013, tarifate e terminimit te vendosura me siper per OA do te sherbejne si tarifa rekomanduese dhe AKEP pret qe tarifate e tyre te mos kene ndryshime nga tarifate e mesiperme.

Tarifate e terminimit ne rrjetin AMC per terminimin e thirrjeve drejt numrave gjeografike te AMC (AMC Fiks) ne fazen e pare dhe te dyte jane barazuar me tarifate e terminimit lokal/njefish ne rrjetin Albtelecom ne fazen I dhe II. Ndryshimet nga vlerate e dhena ne konsultim publik jane te vogla nga 1.43 ne fazen e pare behet 1.34 lek/minute dhe nga 1.20 ne fazen e dyte behet 1.19 lek/minute. Njekohesisht per keto dy faza eshte shtuar edhe tarifa per thirrje ne te njejtin nivel me Albtelecom dhe OA. Edhe keto ndryshime kane pasur per

qellim thjeshtezimin dhe konvergimin e tarifave te terminimit te thirrjeve drejt numrave gjeografike fikse te AMC.

Tabela V.3/1: Vlerat maksimale te tarifave të terminimit ne rrjetin AMC per thirrjet drejt AMC Fiks 2013-2015 (FINAL)

	Aktuale- 31.12.2013	Faza I	Faza II
		1.01.2014- 31.08.2014	1.09.2014- deri ne nje Vendim tjetër te AKEP
Terminimi lek/minute	1.50 ose 2.5	1.34	1.19
Tarife fikse per thirrje		0.53	0.38

Shenim: Tarifat jane pa TVSH.

Ndryshimet e mesipeme synojne reduktim te segmenteve te terminimit/origjinimit/tranzitimit dhe vlerave te tarifave te terminimit/origjinimit/tranzitimit per Albtelecom dhe reduktim te segmenteve dhe tarifave te terminimit te operatoreve te tjere fikse duke synuar edhe reduktimin e asimetrise se tarifave te ketyre operatoreve alternative e ato te Albtelecom. Nderkohe per konvergjencen e plote te tarifave te terminimit te te gjithë operatoreve te rrjeteve fikse, AKEP do te marre vendime ne kohen e kalimit me nje segment te tyre. Nje nder ndryshimet kryesore per tarifate e operatoreve alternative eshte edhe reduktimi i numrit te madh te tarifave (6 vlera) te aplikuar aktualisht ne treg nga operatorët per terminimin e thirrjeve ne rrjetet e tyre duke cuar ne 2 vlera tarifa terminimi per keta operatore.

Ndryshimet e mesiperme pritet te kene efekt pozitiv ne treg pasi ato reduktojne nevojën per interkonektim ne shume pika interkoneksioni (bashkimi i segmentit lokal dhe njefish) dhe njekohesisht zvogelojne shpenzimet e operatoreve per pagesat e tarifave te interkoneksionit (reduktimi i tarifave), dhe keta faktore do te cojne ne fleksibilitet me te madh et operatoreve ne tarifim dhe tarifa me te uleta per perdoruesin fundor.

V.2. Masat rregullatore te propozuara per Albtelecom ne tregjet e pakices

Tregjet me pakice te Albtelecom kane qene vazhdimisht nen efektin e detyrimeve rregullatore. Arsyet kane qene te natyres objektive, pasi pervec faktit qe analiza e zhvilluar ne keto tregje ka gjetur me FNT sipërmarresin Albtelecom, por ne reference me problemet kryesore te identifikuar ne keto tregje te cilat kryesisht kane lidhje me:

- Tarifate jo te balancuara dhe subvencionet e terthorta midis shërbimeve te Albtelecom
- Aksesin e kufizuar per perdoruesit fundore
- Mundesite e kufizuara te zgjedhjes se pajtimtareve te Albtelecom, etj.

Nje nder problemet kryesore i cili akoma nuk eshte eliminuar plotesisht, eshte problemi ne lidhje me tarifat jo te balancuara. Ne seksionin perkates te analizes se tregjeve me pakice ne kete dokument eshte trajtuar ne menyre te detajuar ky fakt, por eshte hedhur per diskutim edhe me palen e interesuar ne se vazhdojne te egjostojne kushtet reale te permylljes se procesit te ri-balancimit te tarifave, apo mund te gjykohet se duhen gjetur mekanizma te tjere ne treg qe te bejne eficient sherbimet e cilat deri tani jane ofruar nen kosto.

Ne percaktimin e masave rregulluese per FNT e ndjeshme te Albtelecom ne tregjet me pakice, AKEP gjykon te rendesishme te evidentojte fillimisht disa karakteristika te tregut Shqiptar te telefonise fikse ne ndryshim nga ato te vendeve te tjera te rajonit dhe BE si dhe disa prej ndryshimeve kryesore qe kane ndodhur ne treg ne periudhen 2010-2012 me impakt ne tregjet me pakice ne telefonine fikse.

Shqiperi v BE/rajoni

Kushtet e tregut te telefonise fikse ne Shqiperi jane shume te ndryshme nga ato ne vende te tjera:

- penetrimi i telefonise fikse eshte shume i ulet (12% v 35% BE dhe rajoni) dhe i perqendruar ne zonat urbane, nderkohe qe penetrimi i telefonise celulare eshte shume i larte ne mase 185% ;
- ka nje numer te madh operatoresh alternative (rreth 80) dhe tendencat e dy viteve te fundit tregojne per kalim te pajtimtareve nga Albtelecom ne operatoret alternative me te medhenj qe kane shtrirje ne zonat urbane kryesore ku jane te perqendruar abonentet e Albtelecom. Pra Albtelecom ndeshet me presion konkurrues nga operatoret e tjere alternative megjithese kjo nuk eshte shfaqur ne reduktime te pjeseve te tregut per thirrje por vetem ne reduktim te pjeses se tregut per Abonente;
- trafiku i origjinuar nga operatoret celulare eshte shume me i madh se ai nga rrjetet fikse, qe i dedikohet si numrit shume me te madh te perdoruesve por edhe tarifave shume te uleta per thirrjet brenda rrjetit/grupeve dhe intensifikimit te konkurrences. Tarifat e thirrjeve brenda grupeve te operatoreve celulare jane shumë të ulëta dhe të krahasueshme jo vetëm me tarifat e thirrjeve kombëtare të Albtelecom por edhe e tarifat e thirrjeve locale; Ne keto kushte efekti i konkurrences dhe zevendesueshmerise se aksesit dhe thirrjeve fikse nga aksesit dhe thirrjet celulare eshte shume me i madh se ne vende te tjera.
- praktika në vendet e BE ku shumica e këtyre vendeve kanë hequr detyrimet e rregullimit të tarifave në tregjet me pakicë të telefonisë fikse:
 - në listën e tregjeve të rekomanduara nga KE në vitin 2007 janë hequr tregjet me pakicë të thirrjeve telefonike nga vendndodhje fikse;
 - rezultatet e analizave te tregjeve ne vendet e BE:
 - ne 18 vende nuk ka FNT ne asnje nga 4 tregjet e thirrjeve telefonike sipas rekomandimit 2003;
 - ne 4 vende nuk ka FNT ne 2 nga nga 4 tregjet e thirrjeve telefonike sipas rekomandimit 2003;
 - ne 2 vende nuk ka FNT ne 2 tregjet e aksesit te rekomandimit 2003;
- Procesi i ribalancimit nuk ka perfunduar ende ne Shqiperi, por sic eshte theksuar edhe me pare ai duhet te ishte kryer para liberalizimit te tregut sic ka ndodhur ne vendet e BE dhe ne disa vende te rajonit si Maqedonia dhe Kroacia. Nga pervoja ne Rumani eshte vene re se rregullatori ka lejuar operatorin incumbent te rrise pajtimin mujor deri ne 7 euro/muaj por me pas operatori incumbent ka aplikuar reduktim te tarifes per shkak te humbjeve te medha te abonenteve.

Ndryshime ne 2010-2012:

- Evolimi i teknologjise dhe sjelljes konsumatore ne drejtim te paketave te integruara dhe te thjeshta (me perfshirje te minutave ne pagese mujore). Vihet re se shtytesi kryesor per zhvillimin e telefonise fikse eshte aksesit broadband ne internet (operatoret alternative qe kane perfituar abonente jane edhe ISP me te medha ne vend).
- Tarifate e operatoreve alternative megjithese nuk kane qene ndonjehere nen-rregullim vihet re se karakterizohen nga pajtim mujor i ulet dhe tarifa te larta te thirrjeve telefonike, pra te ngjashme me paketen standarte Familjare te Albtelecom. Kjo mund te shpjegohet me dy arsye:
 - o Konkurrenca ne telefonine fikse eshte e modelit oligopol me nje kompani dominante dhe shume kompani te vogla qe ndjekin strategjine e kompanise leader;
 - o Konsumatoret jane me te interesuar ne shpenzime te vogla fikse per pajtim mujor dhe perdorim te ulet te thirrjeve telefonike fikse duke i dhene nje kontroll me madh per shpenzimet mujore (si tarifate me parapagim ne telefonine celulare).
- Albtelecom ka hedhur ne treg paketa te reja tarifore me zgjedhje dhe perzgjedhja e tyre nga nje numer i madh pajtimtaresh te Albtelecom tregon se ato jane me atraktive per perdoruesit se paketa standart;
- Paketate tarifore te konkurrenteve kryesore te Albtelecom ne telefonine fikse permbajne paketa me pajtim mujor te ulet si dhe me tarifa te uleta brenda rrjetit si edhe paketa te integruara te telefonise, Internet dhe televizion.
- Perfshirja ne paketate e sherbimeve telefonike e sherbimit te aksesit ne Internet nga Albtelecom dhe nga operatore alternative, dhe perzgjedhja e tyre nga nje numer i madh pajtimtaresh tregon se konkurrenca midis operatoreve te telefonise fikse tashme nuk eshte vetem ne drejtim te sherbimeve telefonike por edhe me sherbimin e Internetit dhe ky i fundit konsiderohet te jete shtytesi kryesor per zhvillimin e telefonise fikse.
- fillimi i implementimit te masave rregullatore ne nivelin me shumice (C(P)S dhe LLU), portabiliteti i numrit fiks rrisin presionin konkurrues mbi Albtelecom per thirrjet telefonike;

Nderkohe, AKEP ne kete analize propozon marrjen e masave rregulluese per FNT te Albtelecom ne tregjet me shumice te terminimit/origjinimit/tranzitimit duke propozuar reduktime te ndjeshme te tarifave te ketyre sherbimeve. Keto masa te propozuara se bashku me zhvillimet e ndodhura dhe te pritshme vleresohet te kene impakt pozitiv ne tregjet me pakice te telefonise fikse duke rritur aftesine konkurruese te operatoreve te tjere dhe konkurrencen ne treg.

Per sa me siper AKEP gjykon se opsioni per lenien jashte rregullimit te tarifave me pakice te telefonise fikse duket se po behet gjithmonë e më i pranueshem edhe ne kushtet e tregut Shqiptar.

AKEP vlereson ne kuader edhe te masave te propozuara per tregjet me shumice se eshte e arsyeshme qe Albtelecom te kete detyrime ne tregun me pakice si transparenca dhe publikimi i tarifave, mosdiskriminimi, nderkohe qe mos te kete detyrim per rregullimin e

tarifave. Detyrimet e Albtelecom per FNT ne dy tregjet me pakice te sherbimeve telefonike do te perfshijne:

- detyrimin per transparence.

Ky detyrim perfshin detyrimin e Albtelecom per publikim dhe njoftimin ne AKEP per paketat/ofertat e tarifore te reja dhe cdo ndryshim ne to:

- 1 muaj para hyrjes ne fuqi te ndryshimeve ne paketen tarifore aktuale standard "Familjare";

- Detyrimi per mos-diskriminim

Sipas ketij detyrimi ndalohet diskriminimi i pajustificuar midis aboneteve te ndryshem kur kushtet e sherbimit jane te njejta. Njekohesisht ne kete mase rregullatore, Albtelecom ndalohet te kryeje ofrim te paketave te pajustificuara me sherbime te ndryshme, qe nenkupton Albtelecom duhet te lejoje pajtimtaret (aktuale apo te rinj) te blejne sherbime te vecanta. Pra paketat me sherbime te ndryshme (bundles) duhet te jene opsionale dhe jo detyruese apo qe krahas paketave (bundle), Albtelecom duhet te ofroje sherbime telefonike te vecanta dhe te mos kushtozoje sherbimet telefonike me blerje te sherbimeve te tjera (ne menyre te detyrar per pajtimtarin).

- Ofrimi i Z(P)B per pajtimtarin

Ky detyrim eshte vendosur dhe ne nivel me shumice per Albtelecom qe te ofroje operatoreve te tjere sherbime te Z(P)B dhe nenkupton se pari qe pajtimtaret te kene te drejte te blejne thirrje telefonike duke perdorur Z(P)B. Ofrimi i ketij sherbimi per pajtimtaret kryhet sipas percaktimve te Rregullores dhe Udhezimeve per Z(P)B.

Nderkohe ne lidhje me heqjen e detyrimit te kontrollit te tarifave, bazuar ne nenin 34 te ligjit 9918, heqja e ketij detyrimi do te behet efektive me 1.01.2014, rreth 6 muaj pas marrjes se vendimit per FNT dhe masat rregulluese per Albtelecom sipas konkluzioneve te kesaj analize tregu, si dhe ne te njejten date me ndryshimet e tarifave me shumice ne rrjetin Albtelecom.

Paralelisht me heqjen e detyrimit te rregullimit te tarifave AKEP do te vazhdoje monitorimin e ecurise se tarifave te paketave standart dhe te tjera. Sic eshte theksuar me pare ne kete proces do te kete rendesi trajtimi i pajtimtareve te Albtelecom me perdorim/te ardhura te uleta ne menyre qe ata te mos demtohen apo te mos zgjedhin heqjen dore nga sherbimi i telefonise fikse per shkak te rritjeve te pajustificuara te tarifave. AKEP ne rregullimin e tarifave te terminimit ka propozuar metoden e reduktimitte pershkallezuar per ti lejuar Albtelecom fleksibilitet ne trajtimin e pajtimtareve te tille.

De-rregullimi i tarifave te Albtelecom synon te krijojte fleksibilitet per Albtelecom ne tarifimin e sherbimeve per plotesim me te mire te kerkesave te konsumatoreve dhe nxitje per investime ne linja te reja telefonike pra dhe rritje te penetrimit te telefonise fikse. Kjo mase dhe masat e tjera rregulluese te propozuara ne nivel me shumice jane ne linje dhe me rekomandimet e ne rezolutat e Kuvendit per vleresimin e veprimtarise se AKEP, ne te cilat Kuvendi midis te tjerave kerkon qe AKEP te angazhohet ne zbatimin e politikave nxitese per nje penetrim me te madh te telefonise fikse dhe te nxise konkurrencen ne kete sektor, duke krijuar nje mjedis terheqes per rritjen e investimeve ne linjat fundore te aboneteve.

ANEKS 1. LISTA E SIPERMARRSVE TE RRJETEVE PUBLIKE TELEFONIKE FIKSE TE PERCAKTUAR ME FNT NE TERMINIMIN E THIRRJEVE²¹

Tabela e mëposhteme paraqet listen e sipërmarrësve që ofrojnë rrjete publike fikse dhe të pajisur me numeracion gjeografik fikse për pajtimtare të percaktuar me FNT në tregjet perkates të terminimit të thirrjeve në rrjetet e tyre individuale.

Nr.	Sipërmarrësi
1	MOBITEL WLC Sh.a.
2	IDEA TEL Sh.p.k.
3	TEL-KOM Sh.p.k.
4	SAJET Sh.p.k.
5	SABATEL Sh.p.k.
6	PRIMO Comm Sh.p.k.
7	Tele.Co&Constraction Sh.p.k.
8	VRANIGER COMM Sh.p.k.
9	ESPACE Sh.p.k.
10	EDEN Sh.p.k.
11	Salvi & Ivi Sh.p.k.
12	IVA ELEKTRONIK Sh.p.k.
13	ALMA 2001 Sh.p.k.
14	A.T.N. Sh.p.k.
15	BITRI Sh.p.k.
16	XHENI AD Sh.p.k.
17	Ej & Bi Sh.p.k.
18	NISATEL Sh.p.k.
19	RU-TEL Sh.p.k.
20	LEVIS AURA Sh.p.k.
21	FJOERS ONLINE Sh.p.k.
22	KRANER Sh.p.k.
23	FJOART Sh.p.k.
24	SINTEL Sh.p.k.
25	LEVENDI Sh.p.k.
26	ENADA ONLINE Sh.p.k.
27	FABBTEL Sh.p.k.
28	POPAJ KLODIANO Sh.p.k.
29	ALBFRUT 2005 Sh.p.k.
30	TELEKOM POSTRIBA Sh.p.k.
31	VOSKOPI Sh.p.k.
32	DOVA Sh.p.k.
33	ATEL Sh.p.k.
34	ELCOM Sh.p.k.
35	EGIS-TEL 2004 Sh.p.k.
36	TEEB CENTER Sh.p.k.
37	EDI-2004 Sh.p.k.
38	LUNAL TEL Sh.p.k.
39	ERI-G TELCOM Sh.p.k.
40	KLEOR Sh.p.k.
41	SELCOM Sh.p.k.
42	ERGTEL Sh.p.k.

²¹ Kjo liste nuk përfshin Albtelecom dhe AMC, të cilët shpallen me FNT me vendime të vecanta.

43	ASC Sh.a.
44	ABISSNET Sh.p.k.
45	ABCOM Sh.p.k.
46	HYSA 2008 Sh.p.k.
47	4ALB Sh.p.k.
48	Bardhyl Tosku (P.Fizik)
49	Enkelana Comm Sh.p.k.
50	Orikum Telecomm Sh.p.k.
51	SHKODRA INTEL.TV Sh.p.k.
52	Call Me Sh.p.k.
53	Neofone Sh.p.k.
54	Info Telecom Sh.p.k.
55	ALBON Sh.p.k.
56	ALFREDI ROTA (P. Fizik)
57	A.C.T. Sh.p.k.
58	BLETA Sh.p.k.
59	SENTELL Sh.p.k.
60	FBD Sh.p.k.
61	Mobik Sh.p.k.
62	L.E.M. Sh.p.k.
63	Eralbi Computer System Sh.p.k.
64	MC Networking Sh.p.k.
65	ADAS Sh.p.k.
66	Compatel Sh.p.k.
67	Merita Xhika (P. Fizik)
68	Greta Gjini (P. Fizik)
69	A.M.B.E.
70	VASFI BALLA(p.f.)
71	Iliria Telecom A
72	Premium Net International SRL
73	ENET
74	Telegroup Albania Sh.p.k.
75	APOLL NET Sh.p.k.
76	NEOTEL ALBANIA Sh.p.k.
77	Telekomunikacion Group Sh.p.k.

ANEKS 2: KOMENTET NE KONSULTIM PUBLIK DHE QENDRIMI I AKEP

Ne dokumentin per konsultim publik, AKEP kishte hartuar disa pyetje rreth te cilave kerkonte komente nga palet e interesuara, duke mos u kufizuar te drejten per t'u shprehur edhe jashte ketyre pyetjeve.

Ne perfundim te fazes se konsultimit ne AKEP jane depozituar komente nga operatorët: Albtelecom , Vodafone Albania, Albanian Mobile Communication, Abcom dhe Neofone. AKEP, falenderon operatorët e cituar me siper per perfshirjen me komentet e tyre ne dokumentin e konsultuar.

Mbi dokumentin e konsultuar, nga Autoriteti i Konkurrences ka ardhur nje mendim i sintetizuar me ane te nje shkrese zyrtare, ku nuk vihet re ndonje kundershiti rreth konkluzioneve te propozuara nga AKEP ne dokumentin e konsultuar. Por me ane te kesaj shkrese AK eshte I mendimit se duhet te persosen instrumentet detyruese per realizimin e detyrimit ligjor per ndarjen e llogarive per sherbimet e ndryshme qe ofrojne operatorët me fuqi tregu, apo te vendosen afate kohore per zbatimin e ketij detyrimi.

Sjellim ne vemendje se te gjithë operatorët e perfshire me komentet e tyre kane ruajtur strukturen e pergjigjeve sipas renditjes te pyetjeve te bera nga AKEP, duke i reflektuar ne komentet e tyre.

Duke qene se komentet jane voluminoze, pasi nje pese e konsiderueshme e tyre jane paraqitur edhe ne formen e nje sintheze te pergjithshme, por ne te njejten kohe e njejta pergjigje gjendet edhe ne version te reduktuar tek lista e pyetjeve te shtruara nga AKEP, pjesen e arsytimeve te perseritura nga dokumenti i konsultuar, duke ruajtur thelbin e komentit si ne rastin e dakortesise me qendrimet dhe konkluzionet e AKEP edhe ne rastin e kundershitimeve apo argumenteve ilustruese qe mbeshtesin kundershitimet sipas rastit.

Ndaj per orientim te lexuesit, ne vijim do te gjeni nje renditje te tille:

- pyetjen e hartuar nga AKEP ne konsultim publik;
- komentet/pergjigjet e secilit operator mbi kete pyetje, si dhe
- qendrimin e mbajtur nga AKEP per komentet perkatese

1. Cili eshte opinioni i paleve te interesuara per perkufizimin e tregjeve perkates me pakice te telefonise fikse?

- a. A eshte i drejte ri-segmentimi i tregjeve perkates me pakice per perfshirjen ne te njejtat tregje perkatese te pajtimtareve familjare dhe jo-familjare?***
- b. A jane ende tregjet me pakice te aksesit/thirrjeve telefonike tregje te justifikueshme per nderhyrje ex-ante?***
- c. Aksesi/thirrjet nga celulare duhet te perfshihen apo jo ne tregjet perkates te aksesit/thirrjet nga vendndodhje fikse?***

Pergjigje e Albtelecom :

a. Ekzistojnë të gjitha arsyet që tregu i aksesit/thirrjeve telefonike për pajtimtarët familjarë dhe jo-familjarë të përfshihen në të njëjtat tregje përkatës.

b. Në raste të deformimit të konkurrencës apo në rastin kur vërtetohet se tarifat me pakicë të aplikuara nga operatorët janë më të ulta se kostot e interkoneksionit që paguajnë operatorët e tjerë për terminimin e thirrjeve.

c. Albtelecom mendon se aksesit/thirrjet nga celularë mund të përfshihen në tregjet përkatëse të aksesit/thirrjeve nga vendndodhje fikse. Për të argumentuar mendimin tonë, më poshtë janë marrë në analizë 2 komponentët e përmendur në analizën e AKEP:

1. Ecuria e numrit të pajtimtarëve dhe trafikut te operatorëve.

Pas vendimeve te AKEP no. 1348 dt. 26/07/2010 dhe no. 1368, date 28/08/2010 lidhur me rritjen e tarifës lokale të Albtelekom (nga 01/09/2010); si dhe vendimeve no. 1210 dhe no.1211, date 31/03/2010 për heqje të detyrimit të rregullimit për cmimet me pakicë të operatorëve AMC e Vodafone (nga 01/07/2010); nëse i referohemi të dhënave të raporteve statistikore të AKEP për vitet 2010-2011dhe të dhënave për trafikun lokal të Albtelecom 2009-2011 në tabelën më poshtë vëmë re se:

Nga njëra anë është ulur konsiderueshëm sasia e trafikut lokal në minuta si rrjedhojë e rritjes së tarifës lokale të Albtelecom dhe në anën tjetër është rritur trafiku “brenda rrjetit” i Operatorve mobile si pasojë e uljes së kësaj tarife (tani jo e rregulluar) aplikuar nëpërmjet ofertave të hedhura ne treg nga operatorët mobile. Nëse marrim në konsideratë periudhën e fillimit të zbatimit të vendimeve të vendosura nga AKEP, është llogjikisht e përligjur përqindja e ndryshimit që rezulton për vitin 2010 (4 muaj tarifa e rritur lokale e Albtelecom dhe 6 muaj tarifë e parregulluar me pakicë për Operatorët mobile) dhe për vitin 2011 (12 muaj). Ndërkohë rritja në përqindje për trafikun “brenda rrjetit” prej 18% krahasimisht me vitin 2010, si dhe shifra 94% “trafikut on-net” ndaj totalit në strukturën e thirrjeve dalëse të operatorëve mobile për vitin 2011 tregojnë qartë zëvendësimin e thirrjeve nga rrjeti fiks me thirrjet nga rrjeti Mobile.

Viti	Trafiku lokal ne min	Albtelecom trafiku ulja në %	Op.Mobile Trafiku “On net” rritja në %
2009	475,762,175		
2010	382,360,831	-20%	~6%
2011	282,522,080	-26%	~18%

Nga analiza më sipër mund të themi se përdoruesit e telefonisë fikse kanë qenë të ndjeshëm ndaj ndryshimit të tarifës lokale te Albtelecom dhe e kanë zëvendësuar në masë aksesin/thirrjet nga vendndodhje fikse me akses/thirrje nga rrjete celulare.

2. Tarifimi

Përsa i takon tarifimit, si rrjedhojë e uljes në vazhdim të tarifave brenda rrjetit nga operatorët mobile, megjithë tarifën lokale të pandryshuar nga Albtelecom prej më shumë se 1 viti vazhdon rënia e trafikut lokal në minuta për vitin 2011 (trafikun kombëtar shfaq gjithashtu të njëjtat tendenca rënie), dhe zëvendësimi i thirrjeve të abonentëve të rrjetit fiks me thirrje nga rrjete celulare. Duke qenë se thirrjet brenda grupeve “Vodafone Club”, apo “Ëhat’s Up” vlerësohet të shkojnë mesatarisht në 0.35 lek/min dhe 0.37 lek/min respektivisht, gjithmonë e më tepër ulet nxitja e abonentëve për akses/thirrje nga telefonia fikse. Kështu konsiderata e AKEP për thirrje më të lira lokale nga Albtelecom është praktikisht e pamundur sa kohë 94% e trafikut të 2 operatorëve të mëdhenj mobile është brenda rrjetit, dhe në paketat e sipërpërmendura janë të abonuar ~90% e abonentëve të secilit operator.

Në mungesë të masave rregulluese apo ndërhyrjes së AKEP në çmimet me pakicë brenda rrjetit dhe jashtë rrjetit të aplikuara veçanërisht nga 2 operatorët e mëdhenj celularë, bëhet gjithmonë e më e vështirë arritja e një prej objektivave të kërkuar për tu realizuar në rezolutën e miratuar nga Kuvendi për veprimtarinë e AKEP gjatë vitit 2011 dhe synimet për vitin 2012, rritja e penetrimit të telefonisë fikse. Kuvendi midis të tjerave kërkon që AKEP për vitin 2012 të angazhohet në zbatimin e politikave nxitëse për një penetrim më të madh të telefonisë fikse dhe të nxisë konkurrencën në këtë sektor, duke krijuar një mjedis tërheqës për rritjen e investimeve në linjat fundore të abonentëve.

Pergjigje e Vodafone :

A. Vodafone Albania mbështet aplikimin nga AKEP të Rekomandimit 2007/879/EC *'Mbi tregjet e mallrave dhe shërbimeve në fushën e komunikimeve elektronike që mund të jenë subjekt i rregullimit ex-ante, në përputhje me Direktivën 2002/21/EC të Parlamentit Europian dhe Keshillit për një kornizë rregullatore të përbashkët për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike'* përgjate Analizes së tregut, qofte kjo për tregun e telefonisë fikse apo atë celulare.

Ne këte kuader Vodafone Albania mbështet qëndrimin e AKEP për të ri-perkufizuar tregjet e pakices dhe pershtatur ato sipas Rekomandimit të vitit 2007. Ky i fundit njih si treg të nevojshem për rregullim pikerisht tregun e aksesit në rrjetin e telefonisë publike nga një vendodhje fikse.

B. Vodafone Albania shprehet se tregjet e pakices për thirrjet dhe aksesin në rrjetin e telefonisë publike nga një vendodhje fikse kanë ende nevojë për rregullim paraprak nga AKEP. Kjo për arsye se edhe vete Rekomandimi i BE e parashikon diktatë të tilla; dhe se dyti sepse sic edhe rezultojnë nga statistikat që zoteron AKEP, Altelecom është ende operator dominant në këte treg me një fuqi të ndjeshme që shkon përtej 75% pjesë tregu në rastin e tregut të aksesit dhe mbi 90% në tregun e thirrjeve dalese. Pavarësisht rënies së lehtë që ka pësuar numri i abonentëve për Altelecom nga vitin 2010 në 2011 për tregun e aksesit (-7%, ndërkohë që ka pasur rreth 84% të abonentëve të telefonisë fikse në vitin 2010), pjesët e tregut të tij indikojnë një përqendrim tepër të lartë ndaj dhe AKEP duhet të ndërhyjë për rregullim ex-ante. Rregullimi ex-ante është akoma me shumë i nevojshem në rastin e tregut të thirrjeve dalese (kombetare dhe ndërkombetare) ku rezultojnë se Altelecom ka vazhduar të ruajë dominancën e tij të padiskutueshme në pjesë tregu mbi 90%.

Referuar konkurrencës së mundshme në tregun me pakicë të thirrjeve sipas analizës së kryer nga AKEP, Vodafone shprehet se kjo konkurrencë nuk është në nivele të kënaqshme apo që të mund të 'sfidojë' dominancën e Altelecom, dhe masat rregullatore të marra nga AKEP, sipas linjave të qera, aksesit në infrastrukture apo zgjedhja dhe parazgjedhja e bartesit, janë pothuajse inefektive për të garantuar apopremtuar konkurrencë aktive në treg (keto argumenta janë trajtuar në mënyrë më të detajuar në pyetjen 8).

Për sa më lart, bazuar dhe në përcaktimet e pozitës dominante në treg sipas kuadrit ligjor dhe Udhezimeve të BE, Vodafone mbështet plotësisht qëndrimin e AKEP për rregullimin e këtyre dy tregjeve ku vërehet indeks i lartë dominancë, çka përben shkak për mundësi abuzimi me këte status.

Pergjigje e AMC:

- a- Në rekomandimin e Komisionit Europian të 2007 i vetmi treg retail i mbetur në listën e tregjeve për ndërhyrje rregullatore ex-ante është aksesit në rrjetin publik nga një vendodhje fikse për pajtimtarët familjare dhe jo-familjare.

Pra, kemi nje risegmentim te ketij tregu ne nje segment te vetem si per abonentet familjare ashtu dhe per ata jo-familjare, ndaj AMC shprehet dakort ne lidhje me propozimin e AKEP per te pasur nje treg te me pakice te aksesit nga nje vendndodhje fikse si per pajtimtaret familjare dhe per abonentet jo-familjare. Risegmentimi i tregjeve te tjera retail te thirrjeve telefonike nga nje vendndodhje fikse ne nje treg te pandare per te dyja kategorite e pajtimtareve eshte nje propozim me te cilin AMC eshte dakort, pavaresisht se keto tregje jane hequr nga lista e tregjeve me pakice per nderhyrje ex-ante rregullatore. Keto ndryshime jane ne perputhje dhe me zhvillimet e ketyre viteve te fundit ne tregun me pakice te telefonise fikse pas 2009, per shkak te rritjes se numrit te konkurrenteve dhe paketave integruese (qe perfshijne dhe aksesin dhe navigimin ne internet) qe ata ofrojne, karakteristikat e te cilave sa vijne e behen me te ngjashme si per klientelen business dhe per perdoruesit familjare. Kufiri ndares i paketave fikse per keto dy kategori abonentesh eshte bere i veshtire per t'u dalluar dhe nuk kemi ndryshime thelbesore te atilla qe te justifikojne nje ndarje te ketyre tregjeve sipas dy kategorive te abonenteve (familjare dhe jo-familjare).

- b- Sic permendem dhe ne piken (a) me siper, ne Rekomandimin e BE-se, i vetmi treg me pakice i mbetur ne listen e tregjeve retail per nderhyrje ex-ante eshte aksesin ne rrjetin telefonik publik nga nje vendndodhje fikse per pajtimtaret familjare dhe per ata jo-familjare, ndersa tregjet e tjere me pakice te thirrjeve nga nje vendndodhje fikse jane hequr nga kjo liste, pasi nuk plotesojne me kriteret per nderhyrje rregullatore ex-ante. Gjithashtu, shume vende te BE-se nuk i aplikojne me masat rregullatore ne disa nga keto tregje me pakice, pervec atij te aksesit nga nje vendndodhje fikse.

Tregu me pakice i telefonise fikse ne vendin tone ka pesuar disa ndryshime pozitive keto dy- tre vitet e fundit dhe kjo ka ardhur per shkak te disa faktoreve sic jane: rritja e numrit te konkurrenteve (mbi 80 operatore alternative aktiv ne kete treg dhe e AMC Fiks), hedhja ne treg e shume paketave tarifore fikse sipas nevojave per abonentin, ulja e cmimeve retail ne keto paketa si pasoje e presionit konkurrues, etj.

Megjithate, pavaresisht ketyre ndryshimeve, struktura e tregjeve me pakice ne vendin tone eshte shume e ndryshme nga ato ne vendet e tjera te BE-se, pasi operatori inkumbent ruan akoma pozita monopoliste ne te gjitha tregjet me pakice si ne terma te te ardhurave, per numer abonentesh dhe per shkak te shtrirjes me te madhe te rrjetit ne territorin e vendit, duke sjelle avantazhe te konsiderueshme dhe mundesi per sjellje abuzive ne dem te konkurrenteve te tjere per shkak te pozicionit dominant ne treg. Situata e penetrimit te telefonise fikse ne vendin tone eshte ende shum larg atyre ne vende te tjera te rajonit dhe BE-se, dhe kjo rrit akoma me shume avantazhet dhe pozitat e operatorit kryesor inkumbent ne kete treg.

Prandaj, duke u bazuar ne karakteristikat dhe strukturen e tregjeve me pakice ne Shqiperi, pavaresisht se ne rekomandimin e BE-se te 2007 shume nga keto tregje hequr nga lista e tregjeve te justifikueshme per nderhyrje ex-ante, AMC mendon qe AKEP duhet te analizoje me kujdes pozicionin qe ka cdo operator ne tregjet perkatese me pakice, ne menyre qe atje ku ka akoma situata monopoliste ne treg te merren masat e duhura rregullatore ne proporcion me pozitat qe kane operoret ne keto tregje, pasi evidentohet akoma nje mungese e nje konkurrence efektive ne keto tregje, per shkak se operoret e tjere (alternative dhe AMC fiks) jane operatore te rinj ne kete treg dhe hasin veshtiresi ne operimin e tyre ne tregjet retail te telefonise fikse si

pasoje e pozitive dominante dhe avantazheve te konsiderueshme dhe kontrollit qe ka mbi tregun operatori kryesor inkumbent. Ndersa tregu me pakice i aksesit ne rrjetin publik telefonik nga nje vendndodhje fikse, duke qene dhe ne listen e Rekomandit te 2007 ne listen e tregjeve te justifikueshme per nje nderhyrje ex-ante, i ploteson keto kriteret pa qene nevoja e ndermarrjes se nje analize te tille nga AKEP.

Pra, nje nderhyrje ex-ante rregullatore duhet bere rast pas rasti, duke marre parasysh situaten aktuale te tregut me pakice te telefonise fikse ne Shqiperi qe ka ende konotacione te nje situate monopoliste dhe eshte ende shume larg karakteristikeve te tregjeve te tjera retail ne vendet e BE-se dhe te rajonit.

- c- Zevendesueshmeria e produkteve/sherbimeve nga e kerkeses dhe ofertes eshte faktori kryesor per te percaktuar nese dy produkte/sherbime jane pjese e te njejtit treg ose jo. Zevendesueshmeria midis nje sherbimi fiks dhe atij mobile eshte nje ceshtje kryesisht e tregjeve me pakice qe influencojne tregjet me shumice te lidhur direkt ose indirekt me to. Ne kete rast kemi te bejme me nje zevendesueshmeri asimetrike fiks-mobile per tregjet perkatese me pakice me drejtimin nga fiksi drejt mobile, pasi pajtimtaret mund ndikohen nga niveli i tarifave midis sherbimeve perkatese dhe mund te preferojne sherbimet mobile per shkak te faktorit te levizshmerise sesa te qendrojne ne telefonine fikse. Nje faktor i rendesishem i lidhur ngushte me graden e zevendesueshmerise fiks-mobile eshte dhe niveli i penetrimit te telefonise fikse, qe ne Shqiperi eshte akoma teper i ulet dhe shume zona rurale ne vend jane te pambuluara me telefonine fikse, duke pasur si mjet te vetem komunikimi aksesin ne sherbimet e telefonise celulare, ndaj dhe shkalla e zevendesueshmerise eshte e ulet.

Nga praktika e shumices se vendeve te BE-se (sic evidentohet ne dokumentin **BoR (12) 52 BEREC Report on the impact of FMS in market definition**, faqja 23) tregjet retail fiks dhe mobile jane te ndara nga njera – tjetra per arsye te disa faktoreve te permendur me poshte:

- 1- Ekzistenca e karakteristikave te ndryshme midis sherbimeve retail fiks dhe mobile;
- 2- Cmimet e ndryshme te paketave fiks dhe mobile;
- 3- Ofertat e telefonise fikse nuk lejojne levizshmerine ne perdorimin e sherbimeve;
- 4- Ekzistenca e preferencave te ndryshme midis perdoruesve te sherbimeve fiks dhe atyre mobile;
- 5- Sherbimet retail fiks dhe mobile jane me shume komplementare sesa te zevendesueshme (zevendesueshmeri e pamjaftueshme pasi eshte vetem ne njerin drejtim fiks drejt mobile, mbulimi i ndryshem i territorit me sherbim per fiks dhe mobile, etj).

Ne perfundim te kesaj pike, AMC shprehet per mos perfshirjen e aksesit/thirrjeve nga celularet ne tregjet perkates retail nga vendndodhje fikse, duke i konsideruar keto tregje te ndara nga njera-tjetra.

Pergjigje e Abcom:

Perkufizimi i tregjeve perkates me pakice eshte i rendesshem per te patur nje vleresim real dhe te sakte te ketyre tregjeve. Me poshte po japim opinionet per secilen nga ceshtjet e theksuara ne pyetsor:

- a. Ri-segmentimi i tregjeve shkon ne linje me zhvillimet e teknologjise dhe me tendencat e ofrimeve te sherbimeve bundle. Grupimi i tyre eshte pasoje e ecurise se tregut dhe reflekton derjt ndryshimet ne treg.
- b. Ne situaten dominuese qe ALBtelecom ka ne treg edhe per tregjet me pakice te aksesit , ri-segmentimi dhe nderhyrjet per rregullim te ketyre tregjeve jane veprime qe do te kene shtrirje edhe ne te ardhmen. Nuk parashikohet qe te kete ndryshime te rendesishme te situatave dominuese ne treg per periudhen qe perfshin analiza e tregut.
- c. N/A

Pergjigje e NEOFONE:

a) Ne kushtet e tregut nga ana e ofertes Neofone mendon se nuk ka dallime cilesore midis paketave per abonentet familiare ose jo familiare nga Albtelecom. Gjithashtu Albtelecom eshte i konkruar nga OA te tjere per te dy rastet me siper. Trajtimi si tregje te vecante apo si treg i perbashket nuk perben ndryshime thelbesore me impakt ne treg ne pikpamjen e Neofone.

b) Po tregjet me pakice te aksesit/thirrjeve telefonike jane tregje te justifikueshme per nderhyrje ex-ante.

c) Neofone arsyeton se thirrjet nga vendodhje fikse nuk mund te jene ne te njejtin treg me thirrjet nga telefonia e levizshme (celulare), nisur nga ndryshimet esenciale ne strukturen dhe topologjine e rrjetit, protokollet si dhe ndryshimet cilesore midis produkteve te ofruara nga platformat fikse dhe ato mobile. Gjithsesi trendi i BE po shkon drejt konvergjimit ne te njetin treg te fiksit dhe mobilit por Neofone mendon se ky hap do te ishte i parakohshem per tregun shqiptar ne kushtet ne te cilat ndodhet.

Qendrimi AKEP:

Duke vleresuar komentet e bera per pytjen e pare, AKEP ve re se per nje dakortesi ne parim shkrirjen e segmenteve familjare dhe jo familjare ne nje segment te vetem, si dhe referojne si te drejte aplikimin e rekomandimit te 2007 per listen e tregjeve, sipas se ciles analizohet vetem tregu i aksesit.

Nje dakortesi e tille gjendet per 1 (a) nga shumica e komentuesve, ndersa ne lidhje me 1(b) dhe 1(c) jane dhene komente me pozicionime pothuajse ne drejtime te kunderta, kryesisht kjo vihet re nga komentet e Albtelecom dhe nga dy operatoret celulare VF dhe AMC. E perbashketa e tyre ne pergjigjen e dhene per 1(b) eshte fakti qe ne varesi te rrethanave te zhvillimit te tregut te pakices per thirrjet, eshte e nevojshme ose jo edhe nderhyrja ex-ante per rregullim, duke e sjellur si rast specifik zhvillimin e tregutte pakices per telefonine fikse ne Shqiperi.

Ne lidhje me komentet e sjella per 1(c), kundershtite vihen re ne aspektin e zevendesueshmerise sipas te cilave asimtrine e zevendesueshmerise, ku Albtelecom e konsideron ne disfavor te madh ne rritjen e stimujve per zhvillimin e telefonise fikse ne te dy tregjet (akses+ thirrje), ndersa edhe AMC argumenton natyren e zevendesueshmerise por duke i dhene rendesi faktit mbi nivelin shume te ulet te penetrimit te telefonise fikse, ku shume zona rurale ne vend jane te pambuluara me telefonine fikse, duke pasur si mjet te vetem komunikimi aksesin ne sherbimet e telefonise celulare, d.m.th e pamundur te behet edhe nje pasqyre reale mbi peshen e zevendesueshmerise ndermjet fiks dhe mobile per

(akses+ thirrje), dhe ne rrethana te tilla eshte me e drejte trajtimi ketyre tregjeve si komplementare te njeri tjetrit se sa mund te konsiderohen si zevendesuese.

AKEP ne propozimet e bera ne fazen e konsultimit publik te analizes per telefonine fikse ne tregjet e pakices (thirrje + akses), ka konsideruar dominancen e Albtelecom ne raport me operatoret e tjere te telefonise fikse, por jo me pak rendesi i eshte dhene edhe dy faktoreve te rendesishem qe ndihmojne ne zbehjen e dominances se Albtelecom ne lidhje me efektet qe sjellin ne raportin kerkese/oferte per thirrje dhe akses ne tregjet e pakices, duke pare dy anet e zevendesueshmerise me ne menyre parimore si dhe duke konsideruar:

- dimensionin e limituar te Albtelecom (mbulimin gjeografik dhe te popullsise me sherbimet e Albtelecom) gje e cila vihet re ne shkallen e ulet te penetrimit qe ka telefonia fikse, e cila nenkupton liri te plote per ofruesit e telefonise se levizshme ne plotesimin e kerkeses per akses dhe thirrje per pajtimtaret e tyre, me nje kunderpeshe zero te Albtelecom si pasoje e mungeses se sherbimit te telefonise fikse;

- volumi i madh i trafikut nga celularet dhe efektin negativ te grupeve te mbyllura;

Ne perfundim AKEP vlereson se ne fazen aktuale te zhvillimit te tregut te telefonise fikse si dhe efektet e sjella ne tregjet me pakice te telefonine fikse per thirrjet dhe aksesin nga aspekti i zevendesueshmerise per (thirrjet+aksesin) qe vijne nga rrjetet celulare, nuk mund te perfshihen ne te njejtin treg (thirrjet+ aksesin) nga fiks dhe celulare dhe i qendron arsyetimeve te dhena edhe ne dokumentin e konsultuar per t'u konsideruar si tregje plotesuese dhe jo si tregje ne nje zevendesueshmerite plote ndermjet tyre.

Per te eliminuar efektin negative qe vjen si pasoje e zevendesueshmerise asimetrike, AKEP do te kerkoje instrumente te tjere per te nderhyre ne menyre ex-ante, apo do te inicioje edhe nderhyrje ex-post ne tregjet e pakices per te eliminuar efektet negative qe sjellin thirrjet nga grupet e mbyllura apo disproporcioni i thelluar ne zhvillimin e trafikut dales telefonik on-net per rrjetet celulare, dhe percjellja e mundshme efekteve negative ne uljen e stimujve per perdorimin e aksesit dhe thirrjeve qe zhvillohen mbi rrjete fikse te telefonise.

Ne kete menyre AKEP i qendron propozimeve te bera ne dokumentin e konsultuar, duke i gjykuar site arsyeshme ne fazen aktuale te zhvillimit te tregut te telefonise fikse ne nivelin e pakices.

2. A mendoni se Albtelecom ploteson kriteret per FNT ne tregjet me pakice te aksesit dhe thirrjeve telefonike nga vendndodhje fikse?

Pergjigje e Albtelecom :

Fakti se Albtelecom ka pjesë tregu të lartë në tregjet me pakicë të aksesit dhe thirrjeve telefonike nga vendndodhje fikse nuk do të thotë se ai mund të vendosë çmime në menyre të pavarur nga konkurrentët e tjerë. Në tregun me pakicë të aksesit, çdo tentativë e Albtelecom për të rritur çmimet do të derivonte në largim apo mbyllje të kontratave nga abonentët e tij, që mund të zgjedhin të sigurojnë akses nga operatorë alternativë disa prej të cilëve, me pjesë tregu relativisht të konsiderueshme, konkurrojnë duke mos aplikuar tarifa të pajtimit mujor.

Nëse do i referoheshim të dhënave të Albtelecom në rastin e rritjes së pagesës mujore ndër vite për abonentin familjar situata paraqitet si në tabelën më poshtë:

Periudha	Numri mesatar i kontratave te	Pagesa mujore ne lek
-----------------	--------------------------------------	-----------------------------

	mbyllura/muaj	pa TVSH
Janar 2008-Dhjetor 2008	748	260
Janar 2009-Gusht 2010	3,250	358
Shtator 2010-Dhjetor 2010	5,704	442
Janar 2011-on	4,621	442

Siç shihet çdo rritje e pagesës mujore të Albtelecom është shoqëruar me rritje të konsiderueshme të numrit të kontratave të mbyllura në një përqindje shumë më të lartë se trendi që ky tregues kishte në muajt e mëparshëm. Abonentët që kanë bërë mbyllje të kontratës kanë shpërndarje gjeografike të ndryshme dhe jo vetëm në rajonin e Tiranës ku ka një përqëndrim më të madh të Operatorëve Alternativë dhe ofertave të tyre. Kjo lidhet me faktin se abonentët zgjedhin të zëvendësojnë thirrjet jo vetëm ndërmjet operatorëve të rrjetit Fiks, por dhe me thirrje nga rrjete celulare sa kohë që tarifatat e aplikuara nga operatorët e mëdhenj mobile janë ulur dhe po ulen ndjeshëm duke reduktuar pozitën dominuese të Albtelecom. Ndërkohë kjo i privon pajtimtarët nga mundësia për të përfutur shërbime broadband dhe sigurisht që keqorienton nxitjet e operatorëve për investime në rrjet.

Përsa i takon tregut të thirrjeve telefonike, është fakt se sasia e trafikut në minuta, veçanërisht lokale ka pësuar rënie të ndjeshme në 3 vitet e fundit. Nëse i referohemi trafikut lokal dhe kombëtar (të raportuar dhe në AKEP periodikisht) për periudhën 2009-2011 shihet se ka pësuar rënie të ndjeshme në sinkron me rritjen e trafikut “On net” të operatorëve celulare (por në kah të kundërt) si dhe me heqjen e rregullimit të tarifave me pakicë në tregun e telefonisë së lëvizshme që prej 01/09/2010.

Viti	Trafiku lokal ne min	Ulja ne %
2009	475,762,175	
2010	382,360,831	-20%
2011	282,522,080	-26%

Viti	Trafiku kombetar ne min	Ulja ne %
2009	181,041,129	
2010	96,824,379	-47%
2011	62,564,325	-35%

Në këtë mënyrë, përdorimi i shërbimit të telefonisë fikse po shkurajohet nga edhe për shkak të aplikimit abuziv të kuadrit rregullator nga operatorët e mëdhenj celulare, por zbatohet në mënyrë të duhur nga Albtelecom i cili përballet me pasojat e ketyre abuzivizmave.

Gjithashtu, në tregun e thirrjeve telefonike nga vendndodhje fikse, çmimi me pakicë i Albtelecom kushtëzohet nga çmimet me shumicë, të cilat janë nën rregjim rregullimi. Nëse tentohet të rriten çmimet me pakicë, konkurrentët e tij do të jenë në gjendje të rrisin pjesën e vet të tregut nëpërmjet procesit të carrier (pre)selection, dhe procesit të portabilitetit të numrit apo dhe kartave të parapaguara.

Atribuimi prej vitësh i Albtelecom me statusin FNT dhe detyrimet e aplikuara ndaj tij kanë sjellë vetëm përfitimin e operatorëve më të mëdhenj celulare, pasi megjithëse situata në Analizën e tregut Fiks paraqitet në përqindje dhe pjesë tregu pothuajse konstante për Albtelecom dhe disa nga Operatorët Alternativë, shifrat konkrete dhe normat e fitimit të operatorëve celulare demonstrojnë se në fakt Albtelecom së bashku me operatorët alternativë kanë një rënie të konsiderueshme të pjesëve të tregut në sektorin e Komunikimeve

Elektronike për shkak të zëvendësueshmërisë së këtij shërbimi me shërbimet e ofruara nga operatorët celularë. Ndaj dhe pandryshueshmëria në pjesët e tregut të operatorëve të telefonisë fikse tregon thjesht situatën e tyre midis njëri –tjetrit por nuk reflekton në fakt se si ata të gjithë së bashku janë pozicionuar në Sektorin e Komunikimeve Elektronike si pasojë e efektit të sjelljeve antikonkurruese të operatorëve celularë.

Megjithë përcaktimin në nenin 31 e vijues të Ligjit të kriterëve për përcaktimin e një sipërmarrësi me statusin me FNT, në dokumentin e Analizës vërehet se AKEP është mbështetur mbi pjesët e tregut të numrit të pajtimtarëve dhe pjesët e tregut për të ardhurat për të përcaktuar Albtelecom me FNT në tregun e pakicës (ref: Dokumenti i Analizës, fq. 6). Në këtë kuadër, Albtelecom kërkon nga AKEP që të mbështetet në këto kriterë për të adresuar edhe problemin e diferencimit të tarifave brënda dhe jashtë rrjetit të operatorëve celularë, për të cilat Albtelecom e ka ngritur si shqetësim edhe në shkresën nr. 3122 dt.20.06.2012 ka paraqitur prova dhe argumenta të mjaftueshëm dhe bindës për t'i sjellë AKEP në vëmendje këtë sjellje anti-konkurruese të operatorëve celularë, të cilët po të bazohemi në kriteret e mësipërme që janë përdorur për të vlerësuar pozitën e Albtelecom, do të dilnim mjaft thjesht në konkluzionin se të dy operatorët e mëdhenj celularë gëzojnë statusin me FNT në tregun e pakicës.

Për të gjitha arsyet e mësipërme mendojmë se Albtelecom nuk plotëson kushtet për përcaktimin FNT për tregun me pakicë të aksesit, dhe të thirrjeve telefonike nga vendndodhje fikse.

Pergjigje e Vodafone :

Vodafone Albania shprehet se AKEP duhet të përcaktojë Albtelecom si operator OFNT në të dy tregjet që përcakton AKEP në nivel pakice tregjet e pakices për thirrjet dhe aksesin, pasi këto të fundit kanë ende nevojë për rregullim paraprak nga AKEP. Si edhe me lart permendur, Albtelecom mbetet operator dominant në këto tregje me një fuqi të ndjeshme që shkon përtej 75% pjesë tregu në rastin e tregut të aksesit dhe mbi 90 % në tregun e thirrjeve dalese. Pavaresisht renes se lehte që ka pesuar numri i abonenteve për Albtelecom nga vitit 2010 në 2011 për tregun e aksesit, pjesët e tregut të tij indikojnë një përqendrim tepër të lartë ndaj dhe AKEP duhet të nderhyjë për rregullim ex-ante. Rregullimi ex-ante është akoma me shumë i nevojshëm në rastin e tregut të thirrjeve dalese ku Albtelecom vazhdon të ruajë dominancën e tij të padiskutueshme në pjesë tregu mbi 90%.

Vodafone shprehet se konkurrencane tregun e pakices nuk është në nivele të kënaqshme apo që të mund të 'sfidojë' dominancën e Albtelecom,. Nga ana tjetër masat rregullatore të ndermarra nga AKEP si linjat me qera, aksesin në infrastrukture, aksesin në LLU apo zgjedhja dhe parazgjedhja e bartesit janë pothuajse inefektive për të garantuar apo premtuar konkurrencë aktive në treg. Madje dhe vete AKEP e pranon në Analizë që asnjë operator alternativ nuk ka marrë ende një kod bartesi, cka është një indikator që AKEP duhet të rivlerësojë kushtet dhe tarifën e ofrimit të këtyre shërbimeve që t'i bejë sa më tërheqëse për operatorët dhe pajtimtarët fundorë.

Pergjigje e AMC:

Pavaresisht disa ndryshimeve që kanë ndodhur në tregun me pakicë të telefonisë fikse që nga analiza e fundit e këtij tregu në 2009, perseri vihet re se Albtelekom si operatori inkumbent me i madh në treg ka kuota të tregut mjaft të larta si në numër abonentesh, si në termat e ardhurave ashtu dhe në mbulimin e territorit me shërbimet perkatëse. Gjate 2010-2011 treguesit e tregut për Albtelekom janë në një nivel mjaft të lartë: numri i pajtimtarëve të Albtelekom, edhe pse ka rënë, ngelet mjaft i lartë (76%), trafiku dalese mjaft i lartë (origjina e

thirrjeve) ne nje nivel prej 94% te tregut, niveli i te ardhurave perben rreth 84% te tregut ne terma te te ardhurave ne krahasim me operatoret e tjere alternative.

Nga nje veshtrim i treguesve te mesiperme evidentohet nje situatë e qarte monopoliste ne tregun me pakice te telefonise fikse nga ana e Albtelekom, e cila eshte ende nje simptome e mungeses se nje konkurrence efektive ne treg dhe e rrezikut te sjelljeve abusive qe rrjedhin nga pozita te tilla ne dem te operatoreve te tjere, edhe pse eshte rritur numri i konkurrenteve ne treg, edhe pse jane shtuar ofertat qe keta operatore kane hedhur ne treg dhe kane rritur numrin e pajtimtareve ne rrjetet perkatese, perseri problemet e mungeses se konkurrences ngelen.

Gjithashtu dhe nderhyrjet rregullatore ne tregun perkates me shumice per Albtelekom nuk kane pasur efektet e mjaftueshme per te eliminuar keto probleme ne tregjet me pakice. Ndaj, duke qene se dhe nderhyrjet ex-ante dhe masat rregullatore ne tregjet me shumice te terminimit dhe origjinimit nuk kane arritur qe te adresojne problemet e konkurrences ne tregjet retail, atehere eshte e domosdoshme qe keto nderhyrje te shtrihen dhe ne tregjet me pakice te lidhura me tregjet perkatese me shumice. Edhe pse tregjet me pakice te thirrjeve nga nje vendndodhje fikse jane hequr nga lista e tregjeve te justifikueshme per nderhyrje ex-ante ne Rekomandimin e BE-se te vitit 2007, duke marre parasysh dhe situaten e ndryshme te tregut te telefonise fikse ne krahasim me tregjet perkatese te vendeve te tjera te rajonit (kuotat mjaft te larta ne treg te operatorit incumbent, niveli akoma i ulet i penetrimit te telefonise fikse me shume zona rurale ku nuk ofrohen sherbimet e telefonise fikse, etj), AMC mendon qe Albtelekom i ploteson te gjitha kushtet per te qene nje operator me FNT si ne tregun e aksesit ne rrjetin publik ashtu dhe ne tregjet retail te thirrjeve nga vendndodhje fikse.

Pergjigje e Abcom:

- PO, ALBtelecom ploteson kriteret per FNT ne tregjet me pakice te aksesit dhe thirrjeve telefonike fikse.

Pergjigje e NEOFONE:

Po, Nefone mendon se Albtelecom i permbush plotesisht kriteret per FNT ne tregjet me pakice te aksesit dhe thirrjeve telefonike.

Qendrimi AKEP:

AKEP vlereson komentet e Albtelecom por edhe te operatoreve te tjere per pyetjen nr.2 te shtruar ne procesin e konsultimit publik te dokumentit te analizës.

Por e gjykon te arsyeshme qe sjell ne vemendje te Albtelecom se ne analizen e kryer AKEP nuk ka lene jashte vemendjes edhe kriteret e tjera qe percakton neni 31 (Ligjit 9918, i amenduar), perkundrazi ka dhene arsytetime te mjaftueshme mbi elasticitetin e kerkese/ofertes per (thirrje + akses), ka trajtuar mundesine e zevendesueshmerise se tyre me (thirrjet + akses) nga rrjetet celulare, por ne fund te arsytetimeve ka preluar aspekti i te qenurit te ketyre tregjeve si plotesuese te njeri-tjetrit duke mos neglizhuar edhe aspektin e zevendesueshmerise dhe efektet e mundshme negative qe sjell ne tregjet e pakices ne telefonine fikse per aksesin dhe thirrjet ne keto rrjete.

Pikerisht duke konsideruar keto fakte eshte gjykuar se pavaresisht treguesve statistikore ne % (per pjeset e tregut) te Albtelecom ne raport me Operatoret Alternative, dominance reale eshte e dobesuar pasi eshte gjykuar se tregu i telefonise fikse si peshe totale e tregut te komunikimeve elektronike ne menyre te agreguar (si sector), ze nje peshe te vogel krahasuar me peshen qe zene tregu i telefonise se levizshme. Shume argumente ne mbeshtetje te qendrimin te AKEP per komentet e trajtuara ne kete pyetje, jane edhe ne qendrimin per 1(c).

Pikerisht nga nje vleresim i tille eshte propozuar qe Albetelcom ruan dominance ne te dy tregjet e nivelit te pakices (akses + thirrje), por instrumenti i vetem rregullator ne kete rast eshte perdorur ne propozimin e masave rregullatore, duke hequr detyrimine kontrollit te tarifave per thirrjet dhe aksesin ne nivelin e pakices. Natyrisht qe nuk eshte neglizhuar edhe fakti qe edhe pse ekzistojne detyrime rregullatore ne niveline shumices per tregjet e Albtelcom, koha e implementimit te tyre dhe efekti i mundshem ne nivelin e pakices i dhene nga keto masa rregullatore akoma nuk ka plotesuar pritshmerite e AKEP.

Per te gjitha sa siper, por edhe ne trajtimin e kryer ne dokumentin e analizes (pershire ndryshimet/shtesat ne kete dokument final ne seksionin perkates pas komenteve), AKEP gjykon se Albtelcom permbush kushtet per FNT ne tregjet e pakices.

3. A mendoni se terminimi i thirrjeve ne rrjetin e secilit operator alternativ fiks perben perben nje treg perkates te vecante?

Pergjigje e Albtelcom :

-Po

Pergjigje e Vodafone :

1. Vodafone Albania shprehet dakord me perfundimin e arritur nga AKEP; Tregu i terminimit te thirrjeve ne rrjetin e telefonise fikse eshte nje treg ku duhet te vendoset rregullimi ex-ante per te gjitha operatoret pa perjashtim, perfshire operatoret alternative, AMC fix dhe Albtelcom.
2. Perfundimi i arritur nga AKEP gjen mbeshtetje dhe eshte ne perputhje te plote dhe me dokumentat rregullatore te BE, sic eshte dhe Rekomandimi 2007/879/EC 'Mbi tregjet e mallrave dhe sherbimeve ne fushen e komunikimeve elektronike qe mund te jene subjekt i rregullimit ex-ante, ne perputhje me Direktiven 2002/21/EC te Parlamentit European dhe Keshillit per nje kornize rregullatore te perbashket per rrjetet dhe sherbimet e komunikimeve elektronike'. Ky Rekomandim permban nje liste me tregje qerekomandohen si subjekt rregullimi ex-ante nga organet rregullatore, dhe tregu nr. 3 eshte pikerisht terminimi i thirrjeve ne rrjetet individuale te telefonise publike nga nje vendndodhje fikse (Call termination on individual publik telephone networks provided at a fixed location). Ndaj dhe ky Rekomandim duhet te aplikohet tek te gjitha operatoret qe ofrojne sherbim te telefonise fikse, sipas listes bashkengjitur nga AKEP, pa perjashtim.
3. Per sa me lart, AKEP gjendet ne kushtet e nenit 34/2 te Ligjit 9918 ku qartazi percaktohet se [...] Nese AKEP-i percakton se nje ose disa sipermarres kane fuqi te ndjeshme ne treg, ne tregun perkates, pra nuk ka konkurrence efektive, atehere ajo vendos ndaj tyre nje, disa ose te gjitha detyrimet e vecanta te nevojshme, te cilesuara ne nenet 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45 e 56 te ketij ligji [...] dhe ne kushtet e nenit 37 [...] kur AKEP gjykon se faktet qe justifikuan perfundimet e arritura ne percaktimin dhe

analizen e tregjeve kane ndryshuar, dhe nuk pasqyrojne situaten aktuale ne treg, atehere rishikon perfundimet dhe vendimet perkatese [...].

KONKLUZION:

Vodafone Albania mbeshitet qendrimin e AKEP ne kete pike dhe konsideron se ne baze te Ligjit 9918, nenet 33, 34 dhe 37; dhe Rekomandimin e Tregjeve Perkates ne vitin 2007, se bashku me dokumentin shpjegues te KE(EC 2007 1483/2, *Commission Staff Working Document Explanatory Note*);

- AKEP duhet te marre menjehere nje vendim formal per t'i dhene status OFNT ne tregun me shumice te terminimit te thirrjeve te gjithe operatoreve alternative ne tregun e telefonise fikse, perfshire AMC fiks dhe Albtelecom.
- AKEP, paralelisht, duhet te procedoje menjehere me vendosjen e te gjithe detyrimeve qe percakton Ligji 9918 ne kete rast, perfshire rregullimin e tarifave te terminimit per te gjithe operoret alternative dhe AMC fiks. Vodafone Albaniasugjeron qe kjo te behet sipas modelit te analizes se kostove sic edhe ka ndodhur me operoret celulare. Keshtu AKEP do te garantoje mosdiskrimin mes operatoreve ne treg, perputhshmeri me parimin e neutralitetit teknologjik.

Pergjigje e AMC:

AMC eshte e mendimit qe terminimi i thirrjeve ne rrjetin e secilit operator alternative fiks perben nje treg perkates te vecante, te identifikuar nga tregjet e tjere me shumice, per shkak te pamundesise per te pasur akses ne kete treg nga ana e operatoreve te tjere per te ofruar sherbimin perkates te terminimit ne rrjetin e cdo operatori alternative fiks, si dhe te mungeses se alternativave te tjera zevendesuese. Sherbimet e terminimit qe ofrohen nga nje operator alternative fiks ne rrjetin e tij nuk mund te zevendesohen me sherbime te tjera alternative, fikse apo mobile po ne kete rrjet, per shkak te mungeses per te pasur akses ne rrjetin e terminimit te operatorit alternative fiks. Per me teper, ne nivelin me shumice, nuk ekziston asnje zevendesim direkt fiks-mobile. Gjithashtu tregu i terminimit nga vendndodhje fikse eshte i identifikuar si i tille ne te dy rekomandimet e BE-se te vitit 2003 ashtu dhe te 2007-es, paveresisht nese operatori fiks eshte alternative ose inkumbent, duke pasur nje kontroll 100% te ketij tregu ne rrjetet perkates. E njejta logjike qe eshte perdorur ne perkufizimin e tregjeve te terminimit nga rrjetet mobile, shtrihet dhe ne perkufizimin e tregut perkates te terminimit nga nje vendndodhje fikse dhe per nje operator alternative ose jo.

Ne perfundim te atyre cka u permenden me siper, terminimi i thirrjeve ne rrjetin e secilit operator alternative fiks perben nje treg perkates te vecante.

Pergjigje e Abcom:

PO, Terminimi i thirrjeve ne rrjetin e secilit operator perben nje treg perkates te vecante.

Pergjigje e NEOFONE:

Po, Nefone mendon se terminimi i thirrjeve ne rrjetin e secilit operator alternativ fiks perben nje treg perkates te vecante, por kjo nuk nenkupton se cdo treg i vecante permbush kushtet per

rregullim. Per te vendosur masa rregullatore duhet te arsyetohet nepermjet kritereve te dominances.

Qendrimi AKEP:

Vlereson komentet e te gjithë operatoreve, komente te cilat shprehin dakortesine me propozimet e AKEP ne dokumentin e konsultuar.

4. A mendoni se Altelecom permbush kriteret per FNT ne tregjet me shumice te:

- a. Terminimit ne rrjetin Altelecom;**
- b. Tranzitimit kombetar ne rrjete fikse;**
- c. Origjinimit ne rrjete fikse.**

Pergjigje e Altelecom :

a. Sa kohë që nuk ka një alternativë teknike për të ndryshuar pjesën e tregut të thirrjeve që terminojnë në rrjetin e tij, Altelecom përmbush kriteret për FNT në tregun e terminimit të rrjetit Altelecom.

b. Të qenurit FNT në tranzitimin kombëtar në rrjete fikse varet nga kapacitetet teknike që operatorët e tjerë në treg kanë të lira. Në lidhje me statusin me FNT në tregun e tranzitimit kombëtar Altelecom beson se dështon në plotësimin e tre kritereve për të gëzuar këtë status në rrethanat që ofron tregu për të gjithë sipërmarrësit.

Ky qëndrim mbështetet që në analizë të kriterit të parë lidhur me pengesat juridike për hyrjen në këtë treg i cili në frymën e liberalizimit të tregut dhe regjimit për Autorizimin e Përgjithshëm bazuar edhe në Rregulloren për Autorizimin e Përgjithshëm nuk parashikon asnjë lloj pengese, përkundrazi është mjaft e thjeshtë që nëpërmjet mekanizmit të njoftimit sipas Rregullores përkatëse të mund të autorizohesh për ofrimin e këtij shërbimi dhe hyrjen në këtë treg. Po ashtu edhe për pengesat strukturore, Altelecom shprehet se tashmë disa prej operatorëve alternativë siç janë Abcom, ASC, Abissnet apo ATU kanë prezencë të konsiderueshme të rrjetit të tyre me fibër optike në qendrat kryesore kabllore të cilët përveçse janë të autorizuar nga AKEP për ofrimin e shërbimit të tranzitimit kombëtar nuk kanë gjithashtu pengesa strukturore për hyrjen në këtë treg në rrethanat që jo vetëm kanë një infrastrukturë të ndërtuar por edhe vazhdojnë të investojnë në zgjerimin e saj.

Gjithashtu, Altelecom ka konstatuar tashmë prej kohësh se disa prej operatorëve alternativë terminojnë në Altelecom trafikun e tranzituar kombëtar të më shumë se 8 apo 9 operatorëve njëherazi të cilët nuk kanë prezencë me Pikë lokale për të përfituar nga tarifa lokale e terminimit në rrjetin Altelecom. Ky trafik evidentohet si trafik kombëtar i terminuar në Altelecom, ndaj dhe AKEP nuk ka statistika për ta evidentuar si trafik më vete, megjithëse Altelecom e ka ngritur si shqetësim këtë çështje edhe në raste të procedimeve administrative me operatorë alternativë.

Kjo praktikë vërteton më së miri se ekzistojnë të gjitha rrethanat dhe kushtet qoftë juridike, ligjore si dhe mundësitë që ofron neutraliteti i teknologjisë apo edhe dhe rrethana të tilla të tregut ku operatorët kanë gjetur zgjidhje alternative për të përfituar shërbimin e tranzitimit kombëtar me çmime më konkurruese se ato që ofron Altelecom. Kjo dëshmon qartë se tashmë qëllimi për krijimin e një ambienti konkurrues në një treg të caktuar është arritur dhe nuk është e nevojshme për ndërhyrjen ex-ante të Autoritetit Rregullator, objektivi i të cilit në

bazë të Ligjit për Komunikimet Elektronike është ndërhyrja me masa rregullatore në një treg ku nuk ka konkurrencë apo ku ka gjasa të ketë deformime të tregut si pasjë e mosndërhyrjes. Ndërkohë Albtelecom përballet me faktin se tashmë operatorët i kanë të gjitha mundësitë dhe në të vërtetë e ofrojnë këtë shërbim njëri-tjetrit, situatë kjo mjaft e natyrshme në rrethanat kur pikërisht këta operatorë janë ata që i kanë shfaqur potencialin për lidhje direkte apo zgjidhje alternative për tranzitimin e trafikut ndërkombëtar i cili kërkon shumë më tepër investime dhe mbështetje teknike se sa do të kërkonte tranzitimi i thirrjeve kombëtare.

Për sa analizuam më sipër, Albtelecom dështon në plotësimin që në kriterin e parë të parashikuar nga neni 31, pika 1, e më tej edhe në kriterin e dytë dhe në të tretë për tu cilësuar me FNT në tregun e tranzitimit kombëtar, ndaj kërkojmë që ashtu siç po në këtë mënyre rrethanat e tregut sollën që AKEP me VKD nr. 1348 dt. 26.07.2010 të vendoste heqjen e detyrimeve për tranzitimin e thirrjeve ndërkombëtare, të konsiderojë në Vendimin e tij heqjen e detyrimeve për tranzitimin e thirrjeve kombëtare si detyrime të cilat nuk janë më të nevojshme në kushtet aktuale të këtij sektori.

c. Albtelecom konsideron që nuk përmbush kriteret për FNT në origjinimin e thirrjeve AKEP dhe kërkon që të gjitha detyrimet e propozuara të hiqen duke ia lënë Albtelecom si të drejtë për ta negociuar në terma komercialë me operatorët apo ofruesit e shërbimeve. Kjo në simetri edhe me situatën e detyrimeve të operatorëve të medhenj në treg.

Pergjigje e Vodafone :

4. Vodafone Albania, mbështet qëndrimin e AKEP në këtë pikë – Albtelecom përmbush plotësisht kriteret për t'u shpallur Operator me Fuqi të ndjeshme në treg (OFNT) për tregun e terminimit në rrjetin e Albtelecom, tranzitimit kombëtar në rrjetet fikse dhe origjinimit në rrjetet fikse. Kjo gjetje është në përputhje me përcaktimet e Ligjit 9918, datë 19.05.2008 'Për komunikimet elektronike' dhe Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 'Për mbrojtjen e konkurrencës' si dhe akteve nenligjore në zbatim të tij; analizës ekonomike të kryer nga AKEP; në përputhje me përfundimet statistikore përse i takon pjesëve të tregjeve perkatese; Rekomandimeve të KE në këtë fushë dhe eksperiencës me të mirë të shteteve anetare.

Pergjigje e AMC:

- a. Albtelekom ka një kontroll 100% të tregut të terminimit në rrjetin e tij fikse. Duke kontrolluar 100% këtë treg dhe duke pasur një influencë të plotë mbi përcaktimin e tarifave perkatese të terminimit konfigurohet një situatë monopoliste në këtë treg. Në bazë të kësaj evidence, Albtelekom plotëson të gjitha kushtet për FNT në tregun e terminimit në rrjetin e tij fikse.
- b. AMC është dakort me konkluzionin e AKEP sipas të cilit Albtelekom i plotëson kriteret për FNT në tregun e tranzitimit kombëtar në rrjetet fikse, për shkak të nivelit të lartë të kuotës së kontrollit në treg në terma të trafikut të tranzituar nepermjet rrjetit të tij krahasuar me atë të operatorëve të tjerë alternativë, si dhe të nivelit të përqendrimit akoma të lartë në këtë treg.
- c. Tregu i origjinimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik nga një vendndodhje fikse është një treg i justifikueshëm për ndërhyrje ex-ante rregullatore të përfshirë në listën e tregjeve nën rregullim të Rekomandimit të BE-së të vitit 2007. Albtelekom zoteron një kuotë të

konsiderueshme tregu mbi 90% ne terma te trafikut te thirrjeve dalese krahasuar me ate te operatoreve te tjere alternative, me nje dominace te theksuar individuale ne kete treg.

Tabela IV.3: Pjeset e tregut te origjinimit te thirrjeve ne rrjete fikse 2007-2011

	2007	2008	2009	2010	2011
Albtelecom	89.30%	90.63%	90.33%	94.00%	94.3%
Alternative	10.70%	9.37%	9.67%	6.00%	5.70%

Albtelekom gezon avantazhe te konsiderueshme dhe per shkak te mbulimit te territorit me rrjet ne krahasim me operatoret e tjere alternative. Pavaresisht se jane ndermarre disa hapa pozitive nga AKEP per stimulimin e konkurrences ne kete treg, sic eshte futja e (para)zgjedhjes se bartesit, si dhe heqjes se barrierave ligjore per futjen e operatoreve te tjere ne kete treg, perseri mbetet shume e larget tendenca drejt nje konkurrence efektive ne te ardhmen, per shkak te treguesve te permendur me siper dhe avantazheve qe gezon Albtelekom ne kete treg (shtrirja e rrjetit te Albtelekom, kontrolli i plote per dhenie aksesit operatoreve te tjere, etj). Analiza e AKEP per situaten ne te cilen ndodhet ky treg eshte e drejte dhe AMC shprehet dakort me faktin qe Albtelekom i ploteson kushtet per FNT ne tregun e origjinimit ne rrjete fikse.

Pergjigje e Abcom:

PO, Albtelecom permbush kriteret per FNT ne tregjet me shumice te :

- a. Terminim ne rrjetin ALBtelecom
- b. Tranzitimit kombetar ne rrjetet fikse
- c. Origjinimit ne rrjetin fiks

Pergjigje e NEOFONE:

Po, Albtelecom i permbush te gjitha kriteret e dominaces pasi disponon me shume se 75 % te tregut dhe duhet te trajtohet si FNT ne tregjet :

- a. Terminimit ne rrjetin Albtelecom;
- b. Tranzitimit kombetar ne rrjete fikse;
- c. Origjinimit ne rrjete fikse.

Qendrimi AKEP:

Ne komentet e sjella per kete pyetje te shtruar ne procesin e konsultimit, duke perjashtuar Albtelecom i cili eshte dakort me konkluzionet e AKEP vetem per tregun e terminimit dhe kundershkon konkluzionet e AKEP per dy tregjet e tjera, ate te tranzitimit kombetar dhe origjinimit te thirrjeve ne nivel shumice, te gjitha operatoret e tjere shprehin dakortesine me konkluzionet e AKEP. Por duke qene se barra e detyrimeve eshte mbi Albtelecom, AKEP sjell ne vemendje qe ne te dy tregjet e nivelit te shumices, tranzitim dhe origjinim te thirrjeve nga rrjete fikse, ne dokumentin e analizes jane dhene argumente te mjaftueshme dhe arsyetime te detajuara qe provojne konkluzionet e AKEP. Por gjithsesi ne insistimin e bere

nga Albtelecom ne lidhje me tregun e tranzitimit kombetar, pavaresisht prezences edhe te operatoreve te tjere tranzitues ne kete treg, gje te cilen AKEP nuk e ka mohuar dhe nuk e kundershkon nje gje te tille, pasi eshte organi kopetent qe autorizon nje sherbim te tille, treguesit qe kane lidhje me peshen e tregut ne (%), perqendrimin e ketij tregu sipas indeksit HHI te vleresuar etj., tregojne per dominance te padiskutueshme te Albtelecom ne raport me ofruesit e tjere te ketij sherbimi. Perpjekja e Albtelecom per te provuar ne se plotesohet ose jo testi i tre kriterave ne vleresimin ose jo site nevojshme per analize te ketij tregu, nuk eshte bindes, pasi koncepti i barrierave nuk duhet te fokusohet vetem ne prezencen ose jo te barrierave ligjore, pasi ne tregje te tillate sherbimit te tranzitimit kombetar, kane nje peshe te konsiderueshme barrierat e natyres ekonomike, gje e cila nuk duhet neglizhuar ne asnje rrethane.

Ne lidhje me tregun e origjinimit te thirrjeve ne nivelin e shumices, AKEP gjykon se jane te mjaftueshme argumentet e dhene ne analizen e tregut, per te konsideruar qe Albtelecom ka dominance individuale ne kete treg.

Si perfundim AKEP i qendron mendimit qe konkluzionet dhe arsyetimet e perdorura ne dokumentin e analizes se konsultuar jane te drejta, parimore dhe plotesojne kriteret e ligjit per dominance te Albtelecom ne keto tregje.

5. Cili eshte opinioni juaj per propozimin e AKEP per percaktimin me FNT te te gjithë operatoreve alternative per terminimin ne rrjetet e tyre fikse dhe te AMC per terminimin e thirrjeve drejt AMC Fiks?

Pergjigje e Albtelecom :

Fakti qe secili nga Operatorët Alternativë dhe AMC per AMC Fix zotërojnë 100 për qind pjesë tregu në shërbimin e terminimit të thirrjeve zanore në këto rrjete do të thotë që përmbushin të gjitha kushtet për të qenë FNT për terminimin në rrjetet e tyre, pasi nuk ka arsye të trajtohen të diferencuar nga Albtelecom.

Pergjigje e Vodafone :

5. Vodafone Albania shprehet dakord me perfundimin e arritur nga AKEP, se terminimi i thirrjeve ne rrjetin e secilit prej operatoreve te telefonise fikse perben nje treg perkates. Pavaresisht tregut te marre ne shqyrtim, qofte ai i telefonise se levizshme apo telefonise fikse, tregu i terminimit ne rrjetin e secilit operator perben nje treg te vecante. Ky eshte nje qendrim i pandryshueshem i Vodafone Albania, shprehur qe ne komentet tona pararendese pergjate analizes se tregut te telefonise celulare ne vitin 2010, e me tej perforcuar ne komentet e analizes se tregut te telefonise celulare ne Korrik 2012. Ndaj dhe Vodafone e gjykon si nje hap te rendesishem drejt rregullimit te konkurrences ne treg kete levizje te AKEP.
6. Vodafone Albania eshte e mendimit se, pikerisht mungesa e rregullimit ne kete drejtim per operatoret alternative ka rezultuar ne mosmarreveshje te vazhdueshme mes operatoreve celulare dhe atyre te telefonise fikse ne lidhje me tarifat e terminimit ne rrjetin e ketyre te fundit, dhe ka legjitimuar shpeshhere dhe papergjegjshmerine e

operatoreve alternative per te mos zbatuar detyrimet baze te ligjit sic jane dhe orientimi ne kosto i tarifave dhe mosdiskriminimi. Sic edhe me lart cituar,tregu i terminimit te thirrjeve ne rrjetin e telefonise fikse eshte treg ku duhet te vendoset rregullimi ex-ante per te gjithë operatorët pa perjashtim, pasi ky treg eshte edhe ne listen e tregjeve te rekomanduara per rregullim nga Rekomandimi i KE i vitit 2007, (tregu nr. 3 -Call termination on individual publik telephone networks provided at a fixed location).

KONKLuzion:

- Vodafone Albania shprehet dakord me perfundimin e arritur nga AKEP se tregu i terminimit te thirrjeve ne rrjetin e telefonise fikse eshte treg ku duhet te vendoset rregullimi ex-ante per te gjithë operatorët pjesemarrës pa perjashtim, perfshire ketu operatorët alternative, AMC fiks dhe Altelecom.Ndaj AKEP duhet te marre menjehere nje vendim formal per t'i dhene status OFNT te gjithë operatoreve alternative, AMC fiks dhe Altelecom dhe te procedoje menjehere duke detyruar te gjithë keta operatore te zbatojne rregullimet qe parashikon Ligji 9918. Ne kete drejtim Vodafone Albania sugjeron qe rregullimi i tarifave te kryhet sipas modelit te analizes se kostove, sic edhe ka ndodhur ne menyre te ngjashme me operatorët celulare, apo sic parashikon kuadri rregullator.

Pergjigje e AMC:

Percaktimi me FNT i te gjithë operatoreve alternative per terminimin ne rrjetet perkates eshte nje barre teper e rende qe u vihet ketyre operatoreve per shkak te dimensionit te vogel ne treg, pavaresisht se sipas perkufizimit per tregjet e terminimit ata kontrollojne 100% te tregjeve perkates.

Operatorët alternative nuk i plotesojne te gjitha kriteret per t'u caktuar me FNT ne kete treg, pasi nuk permbushen te gjitha kriteret perkatese per keta operatore. Disa nga kriteret qe parashikon legjislacioni i BE-se, sipas Udhezimit te BE-se per analizen ne treg dhe vleresimin e FNT-se 2002/C 165/2003, per fuqi te ndjeshme ne treg jane te lidhura me poziten dominante ne treg te operatorit. Per te qene dominant ne nje treg te caktuar disa nga kushtet jane: a) kuota ne perqindje e kontrollit ne treg; b) dimensionit i operatorit; c) avantazhet dhe superioriteti teknologjik ne treg; d)mungesa e fuqise kundervepruese; d) akses i privilegjuar ne burimet financiare; e) ekonomi te shkalles dhe densitetit; f) integrimi vertikal; g) mungesa e nje konkurrence potenciale etj.

Ne lidhje me kuoten e kontrollit ne treg, pozita dominante e nje operatori ekziston nese ky i fundit zoteron me shume se 25% te tregut i vetem. Operatorët alternative dhe AMC Fiks kane kuota shume me te uleta se 25% ne treg si ne terma abonentesh ashtu dhe ne terma te te ardhurave ne nivele perkatesisht 24% dhe 16% per te gjithë operatorët alternative se bashku ne total, ndersa operatori inkumbent Altelekom zoteron kuota teper te larta ne nivel 76% dhe 84%. Kjo eshte nje situatë gati monopoliste e operatorit inkumbent, dhe ky kriter nuk plotesohet per operatorët alternative per te pasur FNT.

Nje kriter tjetër eshte fuqia e larte kundervepruese e operatorit inkumbent Altelekom ne blerjen e terminimit ne rrjetet e operatoreve alternative, duke bere qe keta operatore te mos

kene nje aftesi te plote ndikuese ne tarifate e terminimit qe ata percaktojne ne lidhje me operatoret e tjere.

Gjithashtu, nje tjeter faktor qe duhet marre parasysh eshte dhe barrierat qe hasin keta operatore gjate operimit te tyre, dhe per shkak te dimensionit te vogel qe kane, nuk kane mundesi ekspansioni sic gezon Albtekom si operatori inkumbent ne tregun e telefonise fikse.

Duke vazhduar dhe analizuar edhe kriteret e tjera nje per nje, nje pjese e madhe e ketyre kriterëve si: superioriteti ne teknologji apo aksesit ne burimet financiare, nuk ploteson kushtin qe operatoret alternative te kene FNT ne tregjet perkatese te terminimit.

Praktikat per percaktimin e FNT midis operateve alternative dhe atyre inkumbent eshte i ndryshem midis vendeve te ndryshme te BE-se por dhe te rajonit, duke pasur nje asimetri ne percaktimin me FNT midis operateve alternative dhe atij inkumbent, sic ndodh ne disa vende si: Qipro, Irlande, Poloni, Rumani, duke iu referuar raportit te BE-se **“EUROPEAN UNION 2011 Telecommunication Market and Regulatory Developments”**.

Gjithashtu, trajtimi ben AKEP midis operateve alternative dhe AMC Fiks rezulton diskriminues, pasi operatoret alternative fikse ne momentin qe kane hyre ne tregun e telefonise fikse nuk kane pasur statusin e FNT-se ne tregjet perkatese te terminimit ne rrjetet e tyre fikse. Ndersa per AMC, e cila ka pak muaj qe eshte aktive ne tregun e telefonise fikse AKEP propozon percaktimin me FNT ne tregun e terminimit. Kjo sjellje e AKEP eshte ne kundërshtim me nje nga parimet baze rregullatore, ate te mos-diskriminimit ne trajtimin midis operateve ne vendosjen e masave perkatese rregullatore. AKEP shprehet se AMC permbush kushtet per tu shpallur FNT ne tregun e terminimit te thirrjeve drejt pajtimeve te AMC Fix dhe nuk permend se cilat kushte permbush per tu shpallur FNT.

Ndaj AKEP, ne respekt te ketij parimi, duhet qe te lere te gjithe operatoret alternative, se bashku me AMC Fiks pa statusin e FNT ne tregun e terminimit ne rrjetet perkates, sic ka qene dhe me pare.

Pergjigje e Abcom:

Eshte per te theksuar se klasifikimi FNT ne nje rrjet te caktuar me strukturat ekzistuese te rrjetave te operateve ne treg teknikisht eshte i drejte. Duke pare dimensionin gjeografik te tregjeve dhe vendi qe ze secili operator ne treg atehere eshte e nevojshme te kete nje klasifikim jo nga kendveshtrimi teknik i aksesit por nga kendveshtrimi i biznesit dhe te ardhurave qe ai gjeneron. Edhe klasifikimi FNT ose jo per operatoret alternative duhet te konsideroje kete fakt dhe rrjedhimisht edhe rregullimin ose jo te tarifave te aksesit. Nje percaktim i ketyre tarifave nga rregullatori do te perbente nje pengese edhe me te madhe per hyrjen e operateve te rinj ne treg.

Pergjigje e NEOFONE:

Neofone mendon se ky percaktim le vend per diskutime pasi per te percaktuar FNT per cdo sipermarres AKEP duhet te beje analizen e detajuar te cdo operatori X dhe pjeset e tregut qe operatori X disponon. BE ka parashikuar qe operatoret alternative meqense nuk kane ekonomike shkalle mund ti kene tarifate e terminimit deri ne 30 % me te larta. Moskryerja paraprake e nje

studimi të mirefillte për kostot e cdo operatori alternativ në vecanti nga AKEP do të çojë në vendime të gabuara dhe subjektive të AKEP në lidhje me masën e asimetrisë në tarifën e ketyre operatoreve duke i demtuar me shumë se operatorin Albtelekom i cili si nga sasia e abonenteve, shtrirja e gjere e rrjetit por edhe nga ana financiare i tejkalon ndjeshëm të gjithë operatorët alternativë.

Qendrimi AKEP:

Në komentet e operatoreve për këto pyetje, janë dhënë qendrimet parimore të të gjithë operatoreve mbi faktin që cdo rrjet duhet konsideruar monopol në ofrimin e shërbimit të terminimit në rrjetin e tij, përveç këtij qendrimi parimor në komentet e operatoreve AMC Fiks, Abcom dhe Neofone insistojnë në faktin se pavaresisht këtij përcaktimi të drejtë dhe parimor, duhet konsideruar pesha e secilit rrjet në vetevetë dhe sidomos në komentet e AMC-se, (është në kundërshtim me qendrimet e mëparshme për të njëjtin shërbim), pa gjykuar nëse është rrjet fikse apo celulare. AKEP është shprehur mbi faktorët e analizuar, si pjesë tregu, fuqi kundërvetuese dhe nivelin e mosmarrveshjeve për shërbimin e terminimit në rrjetet e operatoreve alternativë. Ndaj duke gjykuar në dokumentin e konsultuar ka argumente dhe arsyetime të mjaftueshme për këto treg të trajtuar.

AMC I referohet dokumentit të KE, “*EUROPEAN UNION 2011 Telecommunication Market and Regulatory Developments*”, por dokumenti nuk citon se ka asimetri në përcaktimin e FNT për operatorët fikse por në masat rregulluese midis incumbent dhe operatoreve alternativë. AKEP ka propozuar në konsultim publik si dhe në këto dokumente përcaktimin me FNT të OA (përshirë AMC fikse) por me masa rregulluese të ndryshme nga Albtelecom. Nderkohe masat rregulluese të propozuara për AMC (për AMC fikse) dhe operatorët e tjere alternativë janë të njëta. Trajtimi disi i vecantë për AMC (për AMC fikse) është bërë për shkak të ndryshimit në ofrimin e shërbimit dhe kjo është dikutuar që në perkufizimin e tregut përkatës të terminimit, pasi AMC fikse ofrohet me rrjet celular dhe jo rrjet fikse.

Përfundimisht AKEP e gjykon si të drejtë vlerësimin e dhënë në dokumentin e konsultuar në lidhje me përcaktimin me FNT për cdo sipërmarres që ofron shërbimin e terminimit në rrjetin e tij.

6. Cfare mendoni për masat rregullatore të propozuara nga AKEP për terminimin, origjinin dhe tranzitimin në rrjetin Albtelecom:

- a. *A sjell përfitime dhe thjeshtezim reduktimi i pershkallezuar i segmenteve të terminimit/origjinimit nga 3 në 2 dhe me pas në 1?*
- b. *Cfare mendoni për reduktimin e propozuar të tarifave të interkoneksionit të Albtelecom?*

Pergjigje e Albtelecom :

Albtelecom konsideron se detyrimi i vetëm i justifikuar është detyrimi për akses në terminimin e thirrjeve në rrjetin e tij. Detyrimet për tranzitimin dhe origjinimin nuk janë proporcionale dhe as të justifikuara.


a- Shumë vende europiane vazhdojnë të kenë skemë tarifimi me 3 dhe 2 nivele për interkoneksionin, kështu që propozimi i AKEP për të aplikuar një tarifë të vetme në Shtator 2014 duhet të rikonsiderohet. Nëse Albtelecom mbyll segmentin e parë ekzistues (lokal, 68 vendndodhje) dhe segmentin e dytë (rajonale, 12 vendndodhje), atëherë sipas përcaktimit do të mbetet vetëm niveli i tretë që i korrespondon segmentit dyfish ekzistues (kombëtar, 2 vendndodhje). Sidoqoftë, nëse Albtelecom do t'i mbajë hapur ato dhe mund të lidhë një OA duke përdorur portën TDM/SS7, atëherë çmimi i segmentit përkatës nuk duhet të eliminohet. Një pjesë e konsiderueshme e kostove të terminimit llogaritet për linkun e transmetimit midis vendndodhjes së centraleve lokale, rajonale dhe kombëtare. Kjo kosto nuk do të reduktohet si rezultat i implementimit të NGN, në të vërtetë mund edhe të rritet gjatë viteve për shkak të rritjes të kostove të kanaleve, tubave dhe punëve civile.

Implementimi i strukturës NGN, përfshin një rishpërndarje të vendndodhjes së pajisjeve dhe centraleve dhe jo një reduktim të numrit të tyre. Kur një central të mbyllet, ai do të zëvendësohet nga një numër mini centralesh. Nuk ka arsye të supozohet që shuma e kostos vjetore të pajisjeve elektronike në keto mini centrale do të jetë krahasimisht më e vogël se kostoja vjetore e pajisjeve që do të zëvendësojnë. Këto minicentrale do të kërkojnë një nivel të ri të linkut të transmissiionit i cili nuk ka qenë në strukturën e para implementimit të NGN.

Në kushtet kur aktualisht Albtelecom gjendet në fazën tranzitore të kalimit të rrjetit nga teknologjia TDM në IP, bashkëjetesa e njëkohshme e të dyve bën që kostot të jenë maksimale. Për këtë arsye Albtelecom kërkon të merret në konsideratë një maturim 3-vjeçar i rrjetit në NGN dhe kërkon shtyrje të afateve të implementimit final të fazës përfundimtare, si dhe mundësinë e hapjes së këtij diskutimi në fillim të vitit 2015. Në këto momente kur Albtelecom akoma s'ka përfunduar kalimin e plotë në NGN reduktimi i segmenteve dhe ulja e tarifave të terminimit nuk mund të sjellë përfitim për Albtelecom përveç se përkeqesim të situatës së tij financiare. Ky propozim për reduktim dhe përshkallëzim të segmenteve dhe tarifave në Analizën për tregun e telefonisë fikse nuk ka shumë informacion plotësues mbështetës si llogaritje apo statistika të vendeve Europiane për këto praktikë.

b- Lidhur me vlerësimin e tarifave të propozuara nga AKEP për terminimin në rrjetin Albtelecom të operatorëve të tjerë në treg, janë analizuar gjerësisht disa tregues që lidhen me normën e reduktimit të tarifave në EU-27 gjatë 6 viteve të fundit, si dhe impakti i tarifave të propozuara për Albtelecom. Në grafikun e mëposhtëm jepen tarifatat e terminimit në EU-27 për secilin nga segmentet.

Fig-1 –Tarifa mesatare e terminimit në rrjetin Fiks sipas segmenteve për EU-27, vitet 2006-2011



Bazuar në të dhënat e mësipërme mesatarja vjetore e uljes së tarifës së terminimit është: për segment lokal 5.9 përqind, segment njëfish 3.9 përqind dhe dyfish 7.4 përqind. Duke supozuar të njëjtat ritme reduktimi për EU-27 në vitet në vazhdim, në tabelën e mëposhtme është dhënë parashikimi i tarifës së terminimit në rrjetin fiks për muajin Tetor 2014, si dhe tarifën e propozuara nga AKEP duke filluar nga Shtatori 2014.

Tab-1 Krahasim i tarifave të parashikuara për EU-27 dhe tarifave të propozuara nga AKEP, në Lek

	Lokal	Segment njëfish	Segment dyfish
Tetor 2014- parashikim per EU-27	0.52	0.75	0.80
Shtator 2014- propozuar nga AKEP	0.80	0.80	0.80

Tabela tregon qartë se tarifën e reja të propozuara janë në trendin e tarifave të EU-27, por ulja e tyre në ndryshim nga vendet e EU-27 tentohet të arrihet nëpërmjet normave të reduktimit shumë më të larta krahasimisht për secilin nga segmentet.

Në vazhdim, tabela e mëposhtme paraqet mesataren vjetore të uljes së tarifave për shtetet e EU në periudhën 2006-2011 dhe mesataren vjetore të uljes për tarifën e terminimit në rrjetin Fiks të propozuara nga AKEP në këtë analizë.

Tab-2 Mesatarja vjetore e reduktimit të tarifës së terminimit në rrjetin fiks, në %.

	Local	Segment njëfish	Segment dyfish
Mesatarja vjetore e uljes- EU 27	5.9	3.9	7.4
Mesatarja vjetore e uljes- propozim i AKEP	21.1	36.9	45.9

Siç mund të konstatohet, norma e reduktimit të tarifave propozuar nga AKEP për secilin nga segmentet është shumë më agresive se ritmi i vëzhguar së fundmi në vendet Europiane.

Bazuar në analizën e mësipërme dhe në benchmarkun europian, është llogaritur një mesatare vjetore e uljes së tarifave 6 për qind për secilin nga segmentet, duke filluar nga 01 Dhjetor 2012. Tarifën minimale të propozuara nga Altelecom nëse do t'i referoheshim normës së reduktimit të zbatuar nga EU-27 për terminimin në rrjetin e tij Fiks gjenden në tabelën me poshtë, ku paraqiten tarifën aktuale, tarifën pas fazës së parë të reduktimit dhe tarifën pas 14 viteve duke zbatuar normën e reduktimit 6 përqind. Tabela ka në përmbajtje të saj tarifën në vitin 2026, pasi mesatarja e tarifës lokale, segment njëfish dhe segment dyfish (~0.8 lek/min) është e ngjashme me tarifën e propozuara nga AKEP për t'u aplikuar nga muaji Shtator 2014.

Tab-3 Tarifën e propozuara nga Altelecom bazuar në normën mesatare të uljes te EU-27

Tarifat	aktuale	Dhjetor 2012- Nentor 2013	Dhjetor 2026-on	reduktimi mesatar në %
Segment lokal	1.50	1.41	0.59	6
Segment njëfish	2.50	2.35	0.99	6
Segment dyfish	3.50	3.29	1.38	6

tarifë/thirrje	0.83	0.78	0.33	6
----------------	------	------	------	---

Nëse AKEP do të përcaktonte tarifa terminimi sipas Tab-3 propozuar nga Albtelecom, do të mundësohej një reduktim më i ngadalte i të ardhurave nga interkoneksioni për trafikun kombëtar të terminuar në Albtelecom. Nëse përqindja vjetore e reduktimit të tarifës do të jetë 6 përqind, atëherë të ardhurat nga interkoneksioni do të ulen me 6 përqind, duke supozuar të njëjtën ecuri trafiku si aktualisht. Ky arsytim, gjykojmë, është në linjë me situatën financiare të Albtelecom dhe me nevojën e madhe për investime në modernizimin e rrjetit.

Nëse do të zbatoheshin tarifatat e propozuara nga AKEP, **të ardhurat mujore** të llogaritura duke marrë si referencë trafikun e një muaji normal (Qershor 2012) me tarifatat e Shtatorit 2014 do të uleshin nga 5.3 milionë lekë aktualisht, në rreth 2.0 milione lekë, duke supozuar të njëjtin vëllim trafikun. Ndërsa në rastin e reduktimit gradual të tarifave me 6 përqind çdo vit, të ardhurat nga Dhjetori 2014 do të reduktoheshin në rreth 4.4 milionë lekë në muaj.

Risjellim në vëmendje edhe njëherë se Albtelecom, siç është trajtuar më sipër, konsideron se asnjë reduktim i tarifave të terminimit në rrjetin Albtelecom nuk është i justifikuar, në kushtet e ekzistencës së deficitit të aksesit dhe trashëgimisë së tarifave të anësuarat në favor të operatorëve celularë.


Pergjigje e Vodafone :

7. Vodafone Albaniapershendet inisiativen e AKEP me qellim uljen e tarifave te terminimit (dhe origjinimit e tranzitimit) ne rrjetin e operatoreve fiks. Megjithate, serish Vodafone deshiron t'i beje reference uljes se vazhdueshme qe po pesojne tarifatat e terminimit ne rrjetin e operatoreve fikse per hir te rregullimit, por qe nuk reflektohet me te njejtat ritme te shpejta dhe sinjifikative ne propozimet e AKEP. Konkretisht, ne France ARCEP pasi mori miratimin e KE dhe Autoritetit Kombetar te Konkurrences, duke filluar nga data 1 Tetor 2011 reduktoi tarifatat e terminimit ne rrjetin fiks ne rreth 0.30 euro cents per minute, dhe serish ne 0.15 Eurocents per minute ne Korrik 2012, perpara se te vijoje me uljen e rradhes ne 0.08 cent ne Janar 2013. Keto kosto jane perllogaritur sipas modelit te Long-Run Average Incremental Cost (LRAIC).
8. Deshirojme gjithashtu t'i kujtojme AKEP qe ne nivel europian ulja e tarifave te terminimit po ndiqet me kujdes, dhe cdo veprim qe nuk reflekton ato ritme uljeje te shpejta, ka hasur ne rezistence dhe investigime ne treg. I tille eshte dhe rasti i propozimeve per tarifatat e terminimit ne Letoni nga rregullatori kombetar SPRK. Ky i fundit ka propozuar tarifa terminimi ne nivelin 0.29 eurocent per thirrje dhe 0.26 eurocent per minute nga 1 Prill 2013. Metodologjia e aplikuar nga SPRK mbi tarifatat e terminimit ne rrjetin fiks nuk garantojne nivelin e kostove te nje operatori eficientdhe si te tilla jane te papranueshme per standartet e BE.
9. Neelie Kroes,Zv. Presidente e Komisionit European eshte shprehur se: "Jam e vendosurqe te garantoj se tarifatat e rregulluara te terminimit, perfshire ato te telefonise fikse, duhet te shkojne drejt nivelit te kostove te nje operatori eficient ne te gjitheshtetet anetare, pa asnje vonese te metejshme." Kjo rezultoi ne nje leter te nisur nga KE drejt SPRK (13 Gusht 2012) ku shpjegohet se tarifatat e propozuara nga ky organ rregullator nuk jane ne perputhje me parimet dhe objektivat e rregullave ne fushen e komunikimeve elektronike, te cilat u kerkojne shteteve anetare te promovojne konkurrencen dhe interesat e konsumatoreve se bashku me zhvillimin e tregut te


perbashket. KE ne kete faze ka pezulluar aplikimin e ketyre tarifave dhe ka filluar nje hetim te thelluar ne lidhje me ceshtjen (*Reference: IP/12/902 Date: 13/08/2012*).

10. Meqenese AKEP ne menyre transparente i eshte referuar te dhenave me te perditesuara nga rajoni persa i takon FTR (fix termination rates - tarifate e terminimit ne rrjetin fiks), ne nuk do te ndalemi aty, por do ti bejme reference me te gjere, me pergjithesuese dhe me te azhornuar FTR ne nivel Bashkimi Europian. Po ti referohemi raportit me te fundit zyrtare publikuar nga BEREC (Body of European Regulators for Electronic Communications) ne Maj 2012 - *TR Benchmark snapshot (as of January 2012)*, ku reflektohen te dhena te raportuara nga organet rregullatore deri ne Janar 2012, rezulton se “tarifate e terminimit ne rrjetin fiks (FTR) jane analizuar ne 3 nivelet e interkoneksionit te rrjeteve fiks. Mesatarja e EU per segmentin lokal (Layer 1) eshte 0.54€cents(0.75 Lek)per minute. Ndersa persa i takon segmenteve njefish dhe dyfish (layer 2 and 3), mesatarja e EU qendron ne nivelet 0.66€cents (0.92 Lek) per minute dhe 0.80€cents (1.12 Lek) per minute, respektivisht.
11. Me poshte Vodafone Albania paraqet cmimin mesatar efektiv per secilin segment, ofruar nga operatorret inkumbente ne nivel BE, se bashku me mesataren europiane (vija horizontale).


Paraqitja grafike ne nivel BE te tarifave te terminimit ne Eurocentne nivel lokal (layer 1)



Paraqitja grafike ne BE te tarifave te terminimit ne Eurocentne nivel njefish (layer 2)



Paraqitja grafike ne BE te tarifave te terminimitne Eurocent ne nivel dyfish (layer 3)



12. Per ta bere me te thjeshte krahasimin, dhe per te treguar sa me te larta jane tarifat qe propozon AKEP sipas modelit benchmarking te marre per reference, Vodafone Albania paraqet me poshte tarifat e synuara per operatorin inkumbent (Albtelecom) dhe mesataren perkatese ne nivel EU (ne Lek dhe Eurocent per minute):

Lidhja e interkoneksionit	Propozimi i AKEP LEke/€cents per minute	Mesatarja EU Leke/€cents per minute
Segment local (Layer 1)	1.34 /0.95	0.75/0.54
Segment njefish(Layer 2)	1.34/0.95	0.92/0.66
Segment dyfish(Layer 3)	2.68/1.91	1.12/0.80

13. Nga ana tjeter, Vodafone gjen rastin t'i kujtoje AKEP qe ende nuk ka miratuar Oferten Reference te Interkoneksionit te Albtelecom, ndaj dhe sugjerojme qe pjese e detyrimeve qe do te qendrojne mbi Albtelecom ne dokumentin perfundimtar te Analizes se tregut te jete dhe procesi i paraqitjes se ORI per miratim prane institucionit tuaj.AKEP ka miratuar ORI per 3 operatoret celulare Vodafone Albania, AMC dhe Eagle Mobile me efekt dhe fuqi te plote, menjehere pas analizes pararendese te tregut celular ne muajin Mars 2010 dhe ka ndjekur ne menyre rigoroze cdo amendim te ketij dokumenti per te reflektuar zhvillimet rregullatore. Nga ana tjeter, analiza e meparshme e tregut te telefonise fikse ka perfunduar qe ne muajin Korrik 2010, por ORI i Albtelecom nuk eshte miratuar ende zyrtarisht nga AKEP. Nje veprim i tille bie ndesh me parimin e mosdiskriminimit dhe te neutralitetit teknologjik te parashikuar ne Ligjin 9918.
14. ORI i Albtelecom rezulton i publikuar ne faqen zyrtare te internetit te Albtelecom qe prej dates 5 Prill 2011 (data qe mban dokumenti) edhe pse eshte nje dokument i pa certifikuar nga AKEP e madje eshte ne zbatim dhe ne Marreveshjen ekzistuese te interkoneksionit me Vodafone Albania. Vodafone sjell ne vemendje se neni 8/c i Ligjit

9918 percakton se eshte kompetence e AKEP qe te miratoje oferten e references per aksesin dhe/ose interkoneksionin. Po ashtu, ne nenin 52/3 te Ligjit 9918 percaktohet se, AKEP ka detyrimin te kontrolloje nese ORI i sipermarresve ploteson kerkesat, qe lidhen me kushtet e vecanta per ndershmerine, mosdiskriminimin, transparencen, arsyeshmerine dhe grafikun kohor, duke i dhene te drejten AKEP te ndryshoje dokumentin kur ka shkelje te elementeve te lartpermendur. Ndaj dhe ne zbatim te ketyre dispozitave kerkojme investimin e AKEP ne kete drejtim, per te garantuar ligjshmerine e dokumentit dhe 'certifikimin' perkates.KONKLUZION:

Vodafone pershendet inisiativen e AKEP per te ulur tarifat e terminimit ne tregun me shumice te telefonise fikse, sidoqofte ne jemi te mendimit se **AKEP duhet te shtyje me teper drejt tarifave qe reflektojne realisht koston e operatorit eficient ne kete treg (objektivi paresor i KE), ose ne rastin me pak te preferuar (benchmark) te reflektoje realisht nivelet mesatare te tarifave te aplikueshme ne nivel BE, qe jane edhe me te ulta se ato qe propozon AKEP ne Analize. Po ashtu, AKEP duhet te monitoroje perditessimin e ORI te Albtelecom ne baze te gjetjeve te kesaj analizeperfundimtare dhe ta miratoje ate dokument (ORI), ne menyre te ngjashme dhe jo diskriminuese, sic edhe ka vepruar me operoret celulare.**

Pergjigje e AMC:

AMC eshte dakort me propozimin e masave rregullatore nga AKEP per te treja tregjet: terminimin, origjinimin dhe tranzitimin ne rrjetin e Albtelecom, per shkak te permbushjes se kritereve me FNT ne keto tregje, sic dhe eshte me permendur me pare ne kete analize.

- a. Thjeshtezim reduktimi i pershkallezuar i segmenteve te terminimit/origjinimit nga 3 ne 2 dhe me pas ne 1 do te sjelle perfitime si nga ana teknike ashtu edhe komerciale. Lidhjet e interkonkesionit do te jene me te thjeshta dhe me te shpejta per tu realizuar si edhe operacionet mujore te matjeve te trafikut. Me tej kjo do te sjelle reduktimin e kostove te interkonkesionit te operatoreve te tjere alternative te cilet sot jane te detyruar te paguajne tarifa interkonkesioni ne segment local, njefish dhe dyfish.
- b. Ne lidhje me tarifat e interkoneksionit te propozuara ne kete analize tregu te telefonise fikse per Albtelekom nga AKEP, nuk jane dhene shpjegimet nga AKEP se ku eshte bazuar ne perlllogaritjen e vlerave te propozuara per tarifat e terminimit/origjinimit dhe te tranzitimit sipas segmenteve perkates (lokal, njefish, dyfish). AKEP duhej qe krahas propozimit te vlerave perkatese te tarifave te interkoneksionit per Albtelekom, te kishte publikuar dhe referencat ose koston perkatese te interkoneksionit sic eshte modeli BULRAIC, qe do te sherbenin si baze per perlllogaritjen e ketyre tarifave.AMC sugjeron qe AKEP deri ne kete analize tregu duhej te kishte perfunduar dhe publikuar modelin BULRAIC te kostove te interkoneksionit per Albtelekom, ne menyre qe dhe vlerat e percaktuara te tarifa perkatese te interkoneksionit te ishin te orientuara ne kosto, ashtu sic eshte vepruar dhe per tarifat celulare te interkoneksionit, dhe sic e kerkojne dhe direktivat perkatese te BE-se, sipas te cilave, tarifat me shumice te interkoneksionit duhet te jene te orientuara ne kosto sipas operatorit eficient.

Nje problem tjetër qe konstatohet ne kete analize lidhet me reduktimin e tarifave te tranzitimit njefish per Albtelekom. Ne glide-path-in e propozuar per keto tarifa vihet re se ne tranzitimin njefish kur kalohet nga periudha aktuale e tarifave te tranzitimit ne fazen e I, vihet re nje rritje

e kesaj tarife nga 1.50 leke/min ne 1.71 leke/min, dhe nuk e kuptojme se perse AKEP propozon nje rritje te kesaj vlere nga 1.5 ne 1.71 leke/min ne kalimin midis ketyre periudhave, duke avantazhuar operatorin Albtelekom dhe kjo rritje eshte e papranueshme dhe e pajustificueshme, ne momentin qe propozohet nje reduktim i tarifave te interkoneksionit, ketu kemi nje rritje artificial dhe arbitrare, dhe me ane te ketij veprimi AKEP ka kryer gjithashtu nje veprim diskriminues ndaj operatoreve te tjere, pasi kjo rritje ka dhe impakt financiar per operatoret e tjere duke rritur kostot perkatese te tranzitimit me Albtelekom.

Niveli i tarifave te terminimit per Albtelekom ka qene i rregulluar dhe ne periudhat e meparshme 2008-2010 I cili I solli tarifate e tij ne mesataren e BE. Ndryshimi arbitrar i tarifave te albtelekom dhe rritja e tyre mbi 300% ne 2010 dhe mungesa e vendimit te AKEP pas studimit te kostove perkatese te terminimit e cila nuk be kurre transparente I dhane albtelekom nje avantazh te pamertuar ne shkelje te ligjit per tarifa te orientuara drejt kostos. Edhe niveli i propozuar sot eshte arbitrar, duke mos qene i bazuar ne asnje reference, ne menyre qe te jene te justifikuara dhe te mos krijojne favorizime per Albtelekom si operatori inkumbent ne lidhje me operatoret alternative ne tregun e telefonise fikse.

Ne perfundim te ketij paragrafi AMC shprehet per nje rishikim te kesaj vlere, e cila te jete minimalisht e barabarte ose me e vogel se vlere aktuale e tarifave se tranzitimit njefishte Albtelekom. Gjithashtu, AKEP duhet sa me pare te ndermarre nje studim per percaktimin e kostove te interkoneksionit sipas modelit BULRAIC, proces i filluar me Janar 2010, ne menyre qe tarifate e interkoneksionit per Albtelekom si operator inkumbent ne telefonine fikse, por dhe per te gjithe operatoret e tjere alternative te jene te orientuara sipas ketyre kostove.

Pergjigje e Abcom:

Lidhur me masat rregullatore kemi keto mendime perkatesisht:

- a. Nuk mendojme se sjell perfitime por sjell thjeshtezime ne pergatitjen e sistemit tarifar dhe te produkteve ne treg
- b. Reduktimi i tarifave te terminimit eshte nje veprim ne perputhje me tendencat e tregut dhe ne relacion me koston. Ceshtja eshte te percaktimi i sakte i koston se kohe-bisedes dhe tarifave se pajtimit mujor.

Pergjigje e NEOFONE:

a) Neofone mendon se thjeshtezimi ne fjale do te sjelli ndryshime por s'mund te percaktoje nese keto ndryshime do jene pozitive apo negative ne lidhje me impaktin final.

b) Reduktimi i tarifave eshte nje mase rregullatore e mire kur kryhet ne funksion te kostove reale si dhe ofrimit te nje konkurrence me te mire ne treg. Jo c' do reduktim tarifash nenkupton konkurrence me te mire.

Qendrimi AKEP:

Pevc komenteteve te mesiperme per analizen e tregut, Albtelecom ne zbatim te kerkeses se AKEP (komunikimet e AKEP me Albtelecom ne periudhen Shkurt-Qershor 2012) per perlllogaritjen e kostove te sherbimeve te ofruara prej tij duke marre ne konsiderate edhe ndryshimet e ndodhura ne rrjetin Albtelecom, me date 5.11.2012 ka depozituar ne AKEP

dokumentin “Top down cost model of Albtelecom network”. Nepermjet shkreses shoqeruese “Paraqitja e kostove te sherbimeve te Albtelecom”, Albtelecom sqaron se ka perlllogaritur kostot e sherbimeve te tij me konsulence nderkombetare dhe ne dokumentin e dorezuar ka dhene pershkrim te modelit te perdorur per keto perlllogaritje. Pra Albtelecom ne zbatim te pikes 1 te nenit 59 te ligjit 9918, perpiqet te provoje qe tarifat e sherbimeve te ofruara prej tij jane rrjedhoje e kostove eficente, duke mundesuar nje norme te arsyeshme fitimi. Kostot e perlllogaritura nga Albtelecom me model Top Down kane ndryshim nga propozimi i AKEP ne konsultim publik si edhe nga kostot Bottom Up LRAIC te perlllogaritura nga AKEP me konsulence nderkombetare (sipas pikes 2 te nenit 59) ne vitin 2010.

Zbatimi nga Albtelecom i detyrimit te mesiperm, solli zbatimin e pikes 5 te nenit 59 te ligjit 9918, sipas te ciles, ne raste te tilla (kur operatori depoziton kostot e llogaritura), AKEP, ose nje ekspertize e kualifikuar e pavarur, e perzgjedhur nga AKEP-i, ka te drejte te kryejë auditimin (verifikimin) vjetor te perputhshmërisë me sistemin e llogaritjes së kostos.

AKEP ngriti nje Grup Pune me eksperte te AKEP per “Shqyrtimin e dokumentit te sipermarresit Albtelecom sh.a. mbi kostot e sherbimeve”. GP ka shqyrtuar dokumentacionin e paraqitur nga Albtelecom, ka kerkuar informacione dhe dokumente shtese si dhe ka zhvilluar nje takim me Albtelecom dhe konsulentin e Albtelecom me 11.02.2013. Per verifikimin e kostove te paraqitura nga Albtelecom, GP i eshte referuar rekomandimeve te KE, ERG/IRG dhe BEREC dhe praktikave me te mira per AS/CA, apo me specifikesht per kostot TD LRIC te cilat jane pergatitur nga Albtelecom. GP, gjykoi se sqarimet e dhena ne dokumentacion si dhe ne takim dhe ne informacionin shtese te derguar nga konsulenti i Albtelecom, nuk jane bindese per te vertetuar se modeli dhe rezultatet e modelit te paraqitur nga Albtelecom, paraqesin kostot eficente te ofrimit te sherbimeve te Albtelecom.

Ne vijim te komenteve te operatoreve dhe informacionit te sjelle nga Albtelecom per kostot, si dhe ndrsyhimeve te tjera te ndodhura dhe qe pritet te ndodhin ne treg, AKEP ka rishikuar pjesen e masave rregulluese per tarifat e terminimit/origjinimit/tranzitimit ne rrjetin Albtelecom, duke vleresuar te nevojshme te bejedisa ndryshime ne keto masa, per reduktimin e segmenteve dhe tarifave te terminimit/origjinimit/tranzitimit, te cilat jane reflektuar ne pjesen perkatese ne kete dokumnet final te analizes.

7. *Cfare mendoni per masat rregullatore, perfshire rregullimin dhe nivelin e tarifave, te propozuara nga AKEP per operatoret alternative per FNT per terminimin ne rrjetet e tyre fikse dhe per AMC per terminimin e thirrjeve drejt AMC Fiks?*

Pergjigje e Albtelecom :

Fakti qe secili nga Operatorët Alternativë dhe AMC per AMC Fix zotërojnë 100 për qind pjesë tregu në shërbimin e terminimit të thirrjeve zanore në këto rrjete do të thotë që përmbushin të gjitha kushtet për të qenë FNT për terminimin në rrjetet e tyre, pasi nuk ka arsye të trajtohen të diferencuar nga Albtelecom.

Pergjigje e Vodafone :

15. Vodafone Albania, si dhe me lart permendur, mbeshitet qendrimin e AKEP ne lidhje me shpalljen OFNT te gjithë operatoreve te telefonise fikse per tregun me shumice te terminimit te thirrjeve dhe vendosjen e detyrimeve perkatese ne menyre te njetrajtshme dhe jodiskriminuese per te gjithë operatoret. Ne kete kuader, Vodafone Albania sugjeron qe vendosja e detyrimeve si pasoje e statusit OFNT ne tregun me shumice te terminimit te thirrjeve, te hyje ne fuqi sa me shpejt te jete e mundur, per te gjithë operatoret e telefonise fikse, menjehere pas miratimit te Analizes perfundimtare.
16. Vodafone Albania veren gjithashtu se AKEP synon te aplikojë dhe legjitimojë asimetrine ne lidhje me tarifat e terminimit per Albtelecom, AMC fiks dhe operatoret e tjere alternative. Qendrimi i Vodafone Albania kaheerazi ka qene dhe vazhdon te jete qe AKEP duhet te aplikojë simetrie te plote tarifash ne treg. Simetria e plote dhe afatgjate mundeson konkurrence me te madhe ne treg, nxit investime dhe novacion, garanton siguri rregullatore dhe mireqenie te pergjithshme per perdoruesit. Nga ana tjetere, edhe Rekomandimi i vitit 2009i KE percakton qarte se nuk ka vend per asimetri pergjate perlllogaritjes se tarifave te rregulluara ne tregun e telefonise fikse per arsyen se: “eshte e ndryshme situata per lojtaret e rinj ne tregun fiks (ndryshe nga tregu celular), pasi keta lojtare kane mundesi te arrijne kosto te uleta per njesi, duke fokusuar ndertimin e rrjeteve te tyre ne zonat me dendesi te larte popullesie, apo duke marre me qera pjese rrjeti apo infrastrukture nga operatori inkumbent.”
17. **Vodafone Albania, sugjeron qe pervec detyrimeve rregullatore sugjeruar nga AKEP, pjese e detyrimeve per keta operatore te jete dhe publikimi dhe depozitimi ne AKEP i Marreveshjes se Nivelit te Sherbimit.** Pergjate funksionimit te Marreveshjeve te interkoneksionit me disa operatore alternative qe jane te lidhur ne menyre te drejtperdrejte me Vodafone, kemi pasur eksperience te perseritur kur Operatoret Alternative kane qene ne shkelje te KPI percaktuar ne Rregulloren per Treguesit e Cilesise se Sherbimit miratuar nga AKEP, si psh:
- Detyrimet rregullatore te Portabilitetit, cka ndikon direkt bazen e abonenteve te Vodafone (dhe Operatoreve celulare ne pergjithesi) dhe demton cilesine e sherbimit. Shkeljet kane konsistuar nemos respektim te parimit All Call Query ACQ dhe mos perditesim te databazes lokale, me pasoje routing i gabuar i thirrjeve, renie e thirrjeveduke detyruar qenumrat e portuar nga Vodafone ne rrjete te tjera (dhe anasjelltas) te mos arrijne te marrin thirrje kombetar/nderkombetare;
 - Morespektimin e CLI (apo edhe KPI te tjera) te hasura pergjate rrugesimit te thirrjeve, cka shkakton probleme faturimi psh., sidomos ne rastin e nje strategjie me tarifa terminimi asimetrike, te ndryshme ne operatore te ndryshem.
18. Vodafone Albania kujton se ka derguar dhe ankesat perkatese ne AKEP per sa me lart. Pervecse demtimit te Marredhenies kontraktuale ne nivel operatoresh, keto shkelje te perseritura kane ndikuar dhe ne marredheniet kontraktuale mes Vodafone Albania dhe abonenteve te rrjetit tone. Nje sere prej ketyre operatoresh, duke mos pasur abonente fundore ne rrjetin e tyre nuk kane ndjere trysnine tregut per respektimin e parimeve rregullatore te portabilitetit dhe treguesve te tjere te cilesise se sherbimit, pasi duke mos operuar ne nivel pakice dhe ne mungese ta marredhenieve te drejtperdrejta me pajtimtaret, nuk vuajne presionin e pasojave kontraktuale mbi mbrojtjen e konsumatorit.

KONKLUZION:

Per gjithë sa me lart, Vodafone Albania permbledhurazi i kerkon AKEP;

- Shpalljen OFNT te gjithë operatoreve te telefonise fikse;
- Vendosjen e te gjithë detyrimeve qe percakton Ligji 9918 per operatoren me OFNT ne menyre te njetrajtshme per te gjithë operatoren alternative perfshire AMC fiks; mosdiskriminim, transparence, akses dhe interkoneksion dhe perdorim i perbashket i faciliteteve dhe detyrim per kontroll tarife, ndarje llogarish dhe llogaritje kostoje;
- Hyrjen ne fuqi te menjehershme te detyrimeve nga miratimi i dokumentit perfundimtar;
- Simetri e plote e aplikuar ne tarifat e terminimit;
- Detyrimin e Operatoreve Alternative per publikimin e SLA.

Pergjigje e AMC:

Sic theksuam dhe me lart, percaktimi me FNT per operatoren alternative ne tregjet perkates te terminimit eshte nje barre e rende per keta operatore, per shkak te dimensionit te tyre ne tregun e telefonise fikse, pasi nuk plotesohen te gjitha kriteret e nevojshme per percaktimin e tyre me FNT ne keto tregje, si pasoje e fuqise se larte kundervepruese te Albtelekom ndaj tyre, si operator inkumbent, dhe duke bere qe keta operatore te mos kene aftesi te plote ndikuese ne percaktimin e tarifave te terminimit ne rrjetet e tyre. Rrjedhimisht dhe vendosja e masave perkatese rregullatore ne keto tregje eshte e panevojshme, duke qene se asnje operator alternative, perfshi dhe AMC Fiks, nuk i ploteson kriteret per te pasur nje status te tille ne tregun perkates te terminimit.

Per rrjedhoje, AMC mendon qe dhe niveli i propozuar i tarifave te terminimit per operatoren alternative te kete nje natyre rekomanduese, meqenese nuk plotesohen kushtet per te pasur FNT ne keto tregje.

Ne kte analize per percaktimin e nivelit te tarifave te terminimit nuk kuptohet arsyeja se perse AKEP ne rastin e reduktimit te tarifave te terminimit te operatoreve alternative ka parashikuar deri ne 4 faza per nje periudhe kohore 3- vjecare, ndersa ne rastin e AMC Fiks jane parashikuar vetem 3 faza te tilla. AMC Fiks ne kete analize eshte trajtuar si nje operator alternative i cili ka vetem disa muaj qe eshte aktiv ne treg, pra ka hyre me vone se operatoren e tjere ne treg.

AKEP duhej qe te kishte publikuar rezultatet per perllogaritjen e kostove te terminimit per operatoren e telefonise fikse gjate kohes qe nga analiza e telefonise fikse e zhvilluar gjate 2009, ne menyre qe dhe reduktimi i tarifave perkatese te terminimit te ishte i orientuar ne kosto dhe jo ne menyre arbitrare ashtu sic eshte vepruar ne kete analize. Reduktimi i vlerave te terminimit eshte bere duke mos dhene asnje lloj reference se ku eshte bazuar AKEP ne percaktimin e ketyre vlerave, apo cilen metodologji ose reference ka aplikuar ne vendosjen e ketyre tarifave.

Nisur nga ajo cka permendet pak me siper, eshte i gabuar justifikimi qe ben AKEP ne lidhje me avantazhet qe gezon AMC ne lidhje me operatoren alternative (**faqja 69 e dokumentit, ku citon se:**

”... Ndryshimi ne vlerat e tarifave te terminimit per AMC Fiks me ato te operatoreve alternative gjykohet i arsyeshem per shkak te:

- ndryshimeve te rrjeteve te AMC dhe operatoreve alternative fiks ku AMC ka me shume avantazhe se operatoret alternative fiks dhe kosto me te uleta te shtimit te abonenteve te rinj;
- detyrimi per konvergimin e dy tarifave 1.5 dhe 2.5 ne tarifen me te ulet 1.43 ne fazen e pare gjykohet i arsyeshem per faktin se AMC megjithe prezencen kombetare me rrjet dhe pajisje me te gjitha kodet NDC te numeracionit (per te gjitha zonat e numeracionit gjeografik) nuk ofron pika lokale/rajonale interkoneksioni.)”

ne lidhje me strukturen me te ulet te kostove dhe per rrjedhoje te propozoje nje detyrim per nje konvergim te tarifave per AMC Fiks 1.5 leke/min dhe 2.5 leke/min ne 1.43 lek/min ne fazen e I-re te reduktimit te tarifave, duke mos paraqitur asnje reference apo studim se ku eshte bazuar ne perlllogaritjen e ketyre vlerave.

Ajo qe parashtron AKEP ne lidhje me avantazhet qe gezon AMC ne lidhje me operatoret e tjere alternative per shkak te kostove me te uleta eshte i gabuar, perderisa AKEP nuk ka bere asnje lloj studimi ne perlllogaritjen e ketyre kostove, si per AMC fiks ashtu dhe per operatoret e tjere alternative per te pasur referenca te sakta per baze krahasimore midis AMC Fiks dhe operatoreve te tjere alternative. Nga ana tjetere nese do nisemi nga argumentimi se AMC perdor rrjetin GSM per realizimin e sherbimit dhe per kete arsye ka kosto me te ulta, kjo bie ndesh me me cka BU LRIAC ka konkluduar per rrjetat mobile dhe ne kete rast AMC per AMC fix do te duhej te perdoret tarifat e terminimit ne AMC Fix te njejta me tarifat e terminimit ne AMC mobile.

Ndaj dhe percaktimi i ketyre tarifave eshte arbitrar pasi eshte bere mbi baza supozuese dhe jo mbi nje studim te sakte te kostove te terminimit ne menyre qe tarifat e percaktuara te jene te justifikueshme dhe te mbeshtetura ne kosto duke reflektuar ne kete menyre strukturen e cdo operatori ne treg.

Per me teper AKEP e vendos AMC ne pozita edhe me diskriminuese kur vendos nje glad path vetem per tarife per minute dhe jo tarife per thirrje. Nderkohe si per Albtelekom ashtu edhe per operatoret e tjere alternative AKEP ka parashikur nje glad path te tarifes per minute ashtu edhe te tarifes per thirrje. Konvergimi i dy tarifave 1.5 dhe 2.5 leke/min ne te njetjen tarife 1.43 eshte i pajustificuar, pasi nuk mundet qe te kemi nje reduktim kaq disproporcional per dy tarifa te ndryshme terminimi ne masen 43% nga 2.5 ne 1.43 lek/min dhe ne masen 5% nga 1.5 ne 1.43 leke/min, duke e trajtuar ne kete rast AMC Fiks sikur te ishte nje operator inkumbent ne telefonine fikse i njejte me pozitat e Albtelekom ne kete sektor.

AMC nuk eshte dakort ne lidhje me reduktimin e nivelit te tarifave te terminimit per AMC Fiks, pasi nuk trajtohet njelloj si operatoret e tjere alternative duke u vendosur ne pozita diskriminuese, pavaresisht se gjate kesaj analize eshte trajtuar si nje operator alternativ ne telefonine fikse. Per kete arsye reduktimi i tarifes 2.5 leke/min duhet te jete i njejte me ate te propozuar dhe per operatoret e tjere alternative, i parashikuar ne 4 faza reduktimi. Por ngelet imediate per AKEP percaktimi dhe publikimi i kostove perkatese te interkoneksionit te telefonise fikse sipas modelit BULRAIC te ndermarre gjate analizes se 2009 per Albtelekom, ashtu sic eshte vepruar dhe ne telefonine celulare, ne menyre qe reduktimi i tarifave te

interkoneksionit te jete i orientuar ne kosto, pra te kete nje baze reference per percaktimin e tarfiave perkatese, duke shmangur ne kete menyre arbitraritetin dhe problemet qe lindin ne percaktimin e ketyre tarifave pa pasur asnje reference per t'i justifikuar keto vlera.

Si konkluzion mund te themi se ne dokumentin e analizës se tregjeve te telefonise fikse nuk eshte argumentuar se perse AMC duhet te jete FNT ne terminimin e thirrjeve drejt AMC Fix.AMC e kundeshton ne menyre te prere shpalljen e AMC FNT per terminimin e thirrjeve drejt AMC Fiks per me teper edhe trajtimin diskriminues midis operatoreve alternative dhe AMC fiks per tarifen per thirrje duke shkelur detyrimin e tij ligjor per trajtim te barabarte te operatoreve.

Pergjigje e Abcom:

Aplikimi i masave rregullatore per operoret alternative mendojme se eshte i parakoheshem. AKEP nuk mundet te rregulloje tarifat e operoreve alternative duke qene se ata jane faktore minoritare ne treg dhe ekziston konkurrenca e mjaftueshme per te optimizuar tarifat e tyre te sherbimit. Ne analize nuk jepen te dhena apo parashikime te ndryshimit te tregut per deri ne 2015, vit qe parashikon zhdukjen e asimetrise 30% me tarifene AT. Mendojme se tregu do te kete te njetin konfigurim edhe ne periudhen e parashikuar dhe e konsiderojme te parakoheshme propozimin per zhdukjen e asimetrise. Masat rregullatore ndaj operoreve alternative do te shtonin pengesat per hyrjen e tyre ne treg te cilat edhe keshtu jane jo te pakta.

Pergjigje e NEOFONE:

Neofone mendon se trajtimi per here te pare i operoreve alternative per FNT eshte nje proces shume delikat nisur nga brishtesia qe operoret alternative kane ne tregun shqiptar. Neofone mendon se pjeset e tregut qe operoret alternative kane ku te gjithe se bashku nuk zoterojne as 25 % te tregut eshte e parakohshme dhe e pa studiuar per te vendosur nivele te sakta asimetrie.

Qendrimi AKEP:

Pozicionimi i komenteve "pro" dhe "kunder" propozimit te AKEP ne analizen e konsultuar per pyetjen e shtruar me siper, percakton palet mbi te cilat propozohen detyrimet rregullatore dhe ne te njejten kohe reflekton dakortesine e Albtelecom dhe Vodafone Albania. Edhe ne kete pike VF, jo vetem shpreh dakortesine per sa eshte propozuar nga AKEP, por insiston edhe per detyrime shtese ne lidhje me nivelin e cilesise se sherbimeve te operoreve alternative si dhe zhdukje te plote te asimetrise ndermjet OA dhe operatorit incumbent.

Ne lidhje me komentet e AMC sipas te cilave AMC Fiks nuk ka asnje favor te ndryshem nga te gjithe operoret e tjere alternative, per t'u konsideruar si i ndryshem edhe pse sherbimet e AMC Fiks ofrohen duke perdorur rrjetin GSM, AKEP gjykon se trajtimi i ndryshem per AMC Fiks eshte i lidhur me mundesite qe AMC ka te ofroje sherbimin e telefonise fikse AMC Fiks bazuar ne rrjetin GSM, per mundesite e shtrirjes ne menyre te shpejte dhe te pavarur nga rrjetet e tjere alternative fikse, duke shtuar ketu edhe mbi mundesite ekzistuese per AMC per te ofruar sherbimin e telefonise fikse (AMC Fiks) ne zona ku nuk egziton asnje

operator alternative fikse, përfshirë këtu edhe Albtelecom, duke e vlerësuar si një avantazh të konsiderueshëm edhe pse në një periudhë të shkurtër, të gjitha mundësitë e cituara më sipër duhen konsideruar si avantazhuese të teknologjisë në ofrimin e shërbimit të telefonisë fikse duke përdorur rrjetin GSM që shërben në të njëjtën kohë edhe si rrjet për ofrimin e shërbimit të telefonisë celulare.

Në lidhje me vlerat e tarifës së terminimit në rrjetet e operatorëve alternativë, AKEP është i mendimit se detyrimi për kontroll të tarifës është i drejtë, ndërsa vlera e tarifës dhe glide –path i dhënë, është konsideruar si i lidhur ngushtë edhe me vlerat e përcaktuara për Albtelecom në shërbimin e terminimit të thirrjeve. Në vijim të përfundimit për tarifën e Albtelecom, AKEP ka bërë ndryshime në këtë dokument final (në seksionin përkatës) duke citur se vendim-marrja për vlerat e tarifave të terminimit në rrjetet e OA dhe AMC (për AMC Fiks) do të kryhet pas një procesi tjetër konsultimi publik.

8. Çfarë mendoni për faktorët e marrë në konsideratë nga AKEP në lidhje me de-rregullimin e tarifave me pakicë të Albtelecom si:

- a. *Karakteristikat e ndryshme të tregjeve me pakicë në Shqipëri dhe vendet e BE;*
- b. *Ndryshimet e ndodhura në 2010-2012 si paketat tarifore me zgjedhje, paketa bundle (telefoni dhe Internet) që kufizojnë aftësinë ndikuese të Albtelecom në tarifën me pakicë;*
- c. *Ndikimin e masave në nivel me shumicë si Z(P)B, LLU, portabiliteti i numrit fikse në konkurrencën në tregjet me pakicë në telefoninë fikse.*

Përgjigje e Albtelecom :

Mendojmë se elementët e marrë në analizë nga AKEP në lidhje me de-rregullimin e tarifave janë të mjaftueshëm për situatën e ndryshimit në treg pas vitit 2010.

Përgjigje e Vodafone :

19. Vodafone Albania i sheh ende si prematurë rezultatet pritshme të portabilitetit, ZPB dhe LLU si masa efektive që kanë/mund të ndikojnë realisht tregun e pakicës duke rritur konkurrueshmërinë dhe rrjedhimisht duke ulur nevojën për rregullim. Konkretisht:

- Portabiliteti i telefonisë fikse është një proces shumë i vonuar në kohë dhe ka filluar të implementohet në mënyrë të pjesshme vetëm pak ditë më parë, ndaj dhënk mund të konsiderohet si faktor për rritjen e konkurrencës në nivel pakicë (retail) përgjatë analizës së tregut të telefonisë fikse për dy vitet e fundit. **Rregullorja për Portabilitetin e Numrit, pakca se është miratuar nga AKEP me anë të VKD nr 1219 që në datë 07.04.2010 dhe ka përcaktuar se implementimi i procesit të portabilitetit (përfshirë portabilitetin fikse-fikse) duhet të ishte efektiv në fund të muajit Prill 2011, ka vazhduar të shtyhet në mënyrë teparjustifikuar, për rreth 16 muaj.**Ndaj dhe renditja e këtij rregullimi si faktor me peshe në rritjen e konkurrencës është ende e nxituar.
- Zgjedhja dhe parazgjedhja e bartesit Z(P)B është gjithashtu një proces i vonuar, i cili nuk mund të merret në konsideratë nga AKEP si faktor me impakt mbi rritjen e konkurrencës në tregun e pakicës, pasi rezultatet e tij ende nuk janë provuar në treg. Z(P)B është një detyrim rregullator i cili qëndron mbi operatorin Albtelecom që prej datës 26.07.2010 nëpërmjet VKD 1348, dhe u dëshen mbi 20 muaj përpara se AKEP

te miratonte perfundimisht tarifat e ofrimit te ketij sherbimi. **Per te mos harruar, qe ka pasur ankesa pikerisht nga operatore alternative qe jane dhe perfitues te drejtperdrejte te benefiteve te ketij sherbimi(por edhe nga Vodafone) ne lidhje me tarifat e miratuara nga AKEP ne proces, te cilat jane vleresuarsi jo-konkurruese dhe pengese ndirekte ne zgjerimine ketij sherbimi.**Mbi te gjitha, Vodafone nuk veren asnje evidence statistikore te paraqitur nga AKEP qe te vertetoje sadopak se Z(P)B eshte nje sherbim realisht aktiv ne tregun e komunikimeve elektronike dhe qe ka sjelle benefite konkrete per konsumatoret, mdaje vete AKEP e pranon ne Analize qe asnje operator nuk eshte regjistruar per te marre nje kod bartesi.

- **Ofrimi i linjave me qera eshte nje tjetër proces i vonuar, per te cilin nuk kemi asnje evidence ekonomike apo statistikore qe te reflektoje sadopak suksesin e tij karshi konsumatoreve fundore.** AKEP ka nxjerre VKD Nr. 1564 qe ne date 13.04. 2011 duke percaktuar sipermarresin Altelecom sh.a me Fuqi te Ndjeshme ne Treg dhe vendosjen e masave rregulluese ne tregun me pakice te linjave me qira (grupi minimal) dhe tregjet me shumice te segmenteve terminuese dhe trunk te linjave me qira. Detyrimi per te ofruar linjat me qera, sipas analizes se miratuar nga AKEP po me VKD nr.1564, qendroimbi operatorin Altelecom per rreth 12 muajperpara se AKEP te merrte masa per implementimin e ketij sherbimi ne favor te operatoreve te tjere te interesuar dhe publikuar ORU e Altelecom. Ketu nuk duhet harruar peridha e ‘pezullimit’ te ketij akti, per shkak te ankimit administrativ depozituar nga vete Altelecom.

KONKLuzion: Vodafone Albania shprehet e mendimit se tregu i pakices ne parim nuk duhet te jete nen rregullim tarifash. Sidoqfte ne kushtet e tregut shqiptar reflektohen shenja te nje dominance te theksuar ne akses dhe thirrje nga vendndodhje fikse nga ana e Altelecom, sic edhe rezulton nga analiza e AKEP. Pavaresisht hapave qe ka marre AKEP ne kete drejtim, ata kane qene te vonuar dhe rezultatet ende nuk jane te prekshme per konsumatoret fundore, ndaj dhe AKEP duhet ta monitoroje me kujdes kete treg.Mbi te gjitha, dominanca e theksuar ne nivele tejet te larta te Altelecom, sic jane dhe pjeset e tregut prej 75% ne tregun e aksesit dhe mbi 90% ne tregun e thirrjeve tregojne se masat rregullatore (me lart permendur) qe AKEP ka ndermarre jane ende jo efikase per thyer hegjemonine e operatorit incumbent. Nga ana tjetër premiset jane qe kjo dominance te rritet edhe me shume me kalimin e rritjes te Altelecom ne NGN/NGA. **Ndaj dhe Vodafone Albania sugjeron qe AKEP pa humbur kohe te rishikojë kushtet e ofrimit te ZPB dhe aksesit ne infrastrukture, aksesit ne LLU dhe linjat me qera per te garantuar veprime konkrete, me tarifa te pranueshme qe synojne rritjen reale te konkurrencës dhe jo pengimin e saj.**

Pergjigje e AMC:

- a- Ne lidhje me karakteristikat e ndryshme te tregjeve me pakice ne Shqiperi dhe ne vendet e tjera te BE-se, ky eshte nje faktor shume deciziv qe evidenton me qarte problematikat qe ka tregu retail i telefonise fikse ne Shqiperi. Aspekti kryesor qe nxjerr ne pah ky faktor eshte nje konkurrence akoma jo-efektive ne Shqiperi, duke iu referuar treguesve kryesor te Altelekom ne tregun me pakice ne krahasim me operatoret e tjere alternative: numri i abonenteve, trafiku i thirrjeve dalese, mbulimi i territorit, etj. Niveli i larte qe kane keta tregues eshte nje indikator i qarte i nje strukture tregu me konotacione oligopoliste te operatorit inkumbent Altelekom ne

treg dhe te pozites se tij dominante. Mjaftojne edhe vetem keta tregues per te konkluduar qe nuk eshte akoma moment i pershtatshem per nje de-rregullim te tarifave me pakice te Albtelekom, pasi shihet qe masat e meparshme rregullatore ne tregjet respektive me shumice nuk kane dhene efektet e duhura ne drejtim te konkurrences ne tregun retail te telefonise fikse, pavaresisht hyrjes ne treg te shume operatoreve te tjere ne treg. Gjithashtu, problematikat e konkurrences ne tregun me pakice te telefonise fikse perforcohen akoma me teper dhe nga niveli i ulet i penetrimit te telefonise ne krahasim me vende te tjera te BE-se.

- b- Pavaresisht ndryshimeve qe kane ndodhur ne tregun me pakice gjate 2010-2012 ne lidhje me rritjen e ofertes se paketave tarifore nga operatoret Albtelekom dhe ata alternative, keto paketa nuk kane pasur nje efekt te dukshem mbi aftesite ndikuese te Albtelekom ne tarifate me pakice, perderisa, vihen re akoma probleme te orientimit ne kosto te paketave standarte te Albtelekom, megjithese nen rregullim qe nga analiza e meparshme e tregut te telefonise fikse. Gjithashtu dhe renia e te ardhurave te Albtelekom nuk ka qene e ndjeshme, megjithe shtimin e paketave tarifore.
- c- Futja e elementeve ne tregjet me shumice si Z(P)B, LLU, portabiliteti i numrit fiks pavaresisht se do te kete ndikimet e saj te ardhshme ne nivelin e konkurrences ne tregjet me pakice te telefonise fikse, nuk ka akoma impaktin e duhur mbi aftesine ndikuese te Albtelekom ne percaktimin e tarifave me pakice dhe ne nje rritje te ndjeshme te nivelit te konkurrences te pakten ne nje te ardhme te aferme, duke marre ne konsiderate avantazhet e shumta qe gezon Albtelekom ndaj operatoreve te tjere alternative ne situaten aktuale te tregut me pakice te telefonise fikse.

Per sa i perket implementimit te portabilitetit fiks, AKEP ka shkelur te gjitha afatet e percaktuara ne ligjin per komunikimet elektronike si dhe te percaktuara prej tij ne rregulloren e portabilitetit te numrit, duke shkaktuar konfuzion ne treg per operatoret. Portabiliteti I numrit per telefonine fikse duke mos qene ende efektiv ne treg, nuk mund te konsiderohet si nje faktor per t'u marre ne konsiderate per te justifikuar de-rregullimin e tarifave me pakice te Albtelekom dhe efektet qe do te kete mbi konkurrencen ne tregun me pakice te telefonise fikse. AKEP ende nuk ka dhene nje date te lancimit te plote te portabilitetit te numrit per telefonine fikse edhe pas shume kerkesesave te AMC dhe takimeve te bera per kete qellim.

Per me teper portabiliteti i numrave fiks nuk mund te kete te njejtat efekte mbi konkurrencen ne treg ashtu sic ka pasur ne ate mobile, per shkak te karakteristikave te ndryshme qe kane keto dy tregje me pakice nga njeri-tjetri, pasi portabiliteti fiks ne tregun e telefonise fikse eshte nje proces shume me i komplikuar, jo te gjitha operatoret alternative jane gati te suportojne portabilitetin e numrit (gje qe eshte perseri ne kundeshstim me rregulloren e PN si dhe me ligjin e komunikimeve elektronike) dhe ketyre i shtohet dhe fakti qe nderkohe AKEP ka ndermarre dhe nje projekt tjetër ne lidhje me ndryshimin e numeracionit fiks, duke e nderlikuar me tej keto dy procese.

Ndryshimet qe rrjedhin nga portabiliteti fiks dhe nga ndryshimi i numeracionit do te reflektohen dhe ne nivelin e tarifave me pakice, dhe per keto efekte AKEP nuk ka ofruar asnje detaj ose studim se si do te behen. Kjo shtate nuk shkakton konfuzion vetem per operatoret por dhe per konsumatorin.

Per sa u analizua me siper konkluzioni eshte se *faktoret e marre ne konsiderate nga AKEP ne lidhje me derregullimin e tarifave me pakice te Albtelecom nuk jane te mjafta. Pa qene ne efektivitet te plote masat ne nivel me shumice si Z(P)B, LLU.*

Portabiliteti i numrit fiks ne konkurrencen e tregjeve me pakice ne telefonine fikse nuk mund te konsiderohen faktore ne derregullimin e tarifave me pakice te Albtelekom. Derregullimi i tarifave me pakice i Albtelekom do te kete nje impact negative per konsumatorin pa pasur portabilitetit e numrit fix ne eficence te plote, ne menyre qe konsumatori te kete mundesi te zgjedhjeje dhe te kemi nje konkurence efektive midis

Albtelekom dhe operatoreve te tjere alternative ne tregjet me pakice te telefonise fikse.

Pergjigje e Abcom:

- a. Situata monopol e operatorit incumbment ne Shqiperi e kushtezon shume edhe heqjen e elementeve rregullator ndaj segmenteve te tregut per ALBtelecom-in. Karakteristiake e tregjeve nuk jane definuar akoma dhe jane ne perpjekjet e tyre fillestare keshtuqe mendojme se duhet te vazhdoje rregullimi i tarifave per tregjet me pakice.
- b. Ofrimi i paketave bundle jep mundesine e fshehjes se kostove te sherbimeve te ndryshme kundrejt sherbimeve te tjera.
- c. Nuk ka akoma ndonje efekt ne treg marrja e masave per ofrimin e Z(P)B dhe LLU sepse keto sherbime akoma nuk jane ofruar ne treg me shumice dhe tarifat e tyre jane jashte mundesive reale te operatoreve. Duke qene qe ALBtelecom mbetet operator me FNT edhe per keto tregje, mendojme se duhet te vazhdoje rregullim edhe per keto tregje.

Qendrimi AKEP:

Duke qene se komentet qe kane ardhur ne pergjigje te pyetjes se shtruar per konsultim nga VF, AMC dhe Abcom jane pak a shume ne te njejten natyre kundershite dhe konkludojne ne idene se akoma tregjet e pakices per Albtelecom duhen mbetur nen rregullim. Qe tedy operoret VF dhe AMC jo vetem ne periudhat pararendese dhe komentet e vazhdueshme qe kane sjelle, por edhe ne komentet aktuale per kete dokument jane dakort qe AKEP te referohet ne listen e tregjeve te Rekomandimit te 2007, sipas ce cilit konsiderohet vetem tregu i aksesit si treg i mundshem per t'u analizuar dhe per kete VF, i sugjeron AKEP rishikimin e listes se tregjeve qe ndodhen ne Rregulloren e Analizes se Tregjeve, gje te cilen AKEP e ka normalisht ne konsiderate dhe se shpejti do te behet amendimi i kesaj rregullorje.

Tendenca per te mos konsideruar fakoret ndikues zhvillimin e konkurrences ne tregjet retail te telefonise fikse, te lidhur ngushtesisht me situaten reale te ketyre tregjeve ne Shqiperi, por thjesht arritja e konkluzionit se masat rregullatore te cituara nga komentuesit dhe te detajuara ne menyre te plote nga AKEP ne analizen e konsultuar, akoma nuk kane arritur efektet e plota, pa i analizuar keto masa rregullatore ne nivelin e shumices ndaj Albtelecom si dhe mos-konsiderimin nga komentuesit te faktorit te pakompensuar "deficit akses" si te pamundur per vijimin e tij ne kushtet aktuale te zhvillimit te tregut te telefonise fikse, orientojne vendimarrjen e AKEP qe te konsideroje si te drejte propozimin per derregullim te plote te tarifave te tregjeve te pakices per Albtelecom.

Keshtu qe ne lidhje me kete pike, AKEP i qendron propozimit te bere ne konsultim publik per de-rregullim te plote te tarifave me pakice per Albtelecom, si dhe faktoret e marre ne konsiderate per kete konkluzion i gjykon te mjaftueshem

9. Cili eshte opinion i paleve te interesuara ne lidhje me propozimet e AKEP per masat rregulluese per Albtelecom ne tregjet me pakice te telefonise fikse:

- a. A eshte i justifikur propozimi per mos-rregullim te nivelit te tarifave te Albtelecom?*
- b. A jane masat rregulluese te propozuara te transparences dhe mos-diskriminimit te mjaftueshme per tregjet me pakice telefonike?*

Pergjigje e Albtelecom :

Në gjykimin e Albtelecom analiza e faktorëve që mundësojnë de-rregullimin e tarifave të tregut me pakicështë e justifikuar. Vazhdimi i rregullimit të tarifave të pakicës për Albtelecom vetëm do të kufizonte mundësinë e kompanisë për të qenë më në shërbim të klientit. Në lidhje me detyrimet për transparencën dhe mosdiskriminimin, Albtelecom kërkon të sjellë në vëmendje të AKEP se nuk gjejmë aspak proporcional detyrimin e Albtelecom për të njoftuar të paktën dy muaj përpara hyrjes në fuqi të ndryshimeve në paketën tarifore aktuale “Familjarë” dhe 1 muaj para hyrjes në fuqi të ndryshimeve në paketat e tjera tarifore dhe paketave/ofertave të reja tarifore.

Ky detyrim bie ndesh edhe me frymën e Rregullores së re të sapomiratuara mbi publikimin e tarifave e cila përcakton një afat njoftimi prej 3 ditësh pas publikimit të ofertës apo planit të ri tarifor. Në kushtet aktuale të tregut dhe në kushtet kur operatorët alternativë nuk kanë qenë gjithmonë korrekt në detyrimin që rrjedh prej Ligjit për publikimin e tarifave dhe operatorët celularë nuk janë subjekt i detyrimit për njoftim paraprak 1 apo 2 muaj, praktikisht vetëm Albtelecom rëndohet me një detyrim të tillë i cili kufizon jashtëzakonisht larmishmërinë dhe fleksibilitetin e ofertave në dispozicion të pajtimtarit. Skuadrat e Marketingut të cdo Kompanie duhet të ndjekin dinamikën e tregut dhe të jenë të aftë të reagojnë menjëherë me oferta dhe plane tarifore konkurrense. Ndërkaq, kohës së domosdoshme të reagimit ndaj zhvillimeve të tregut nga Albtelecom, i shtohet dhe detyrimi i propozuar nga AKEP i cili ngadalëson edhe më tej këtë reagim duke sjellë si pasojë ulje të fleksibilitetit, për të testuar tregun në iniciativa, oferta dhe plane konkurruese. Kjo do të reflektohet menjëherë tek konsumatori i shërbimeve telefonisë fikse dhe për më tepër, do të sillte efekte në kahun e kundërt për largimin e abonentëve aktualë të cilët do të joshen nga ofertat e operatorëve të tjerë më të “shkathët” për shkak të kohëzgjatjes më të shkurtër të zhvillimit dhe lëvrimit të produkteve të tyre. Duke qenë se masat rregullatore vendosen për të nxitur konkurrencën në treg, edhe aspektet procedurale që shoqërojnë vendosjen e këtyre masave duhet të shërbejnë në funksion të objektivave për rritjen e përhapjes së telefonisë fikse.

Ndërkohë Albtelecom nuk sheh asnjë arsye objektive për të lidhur statusin me FNT me trajtimin e afateve për njoftimin e ofertave dhe planeve tarifore. Për sa më sipër, Albtelecom kërkon që të trajtohet në të njëjtin standart si të gjithë subjektet e tregut, për t’iu përmbajtur afateve për njoftimin e ndryshimeve apo promovimit të ofertave dhe planeve tarifore.

Pergjigje e Vodafone :

20. Vodafone Albania ka qene gjithmone e parimit se AKEP nuk duhet te rregulloje tarifat ne nivel pakice, sepse kjo eshte mase ekstreme rregullatore qe nderhyn ne ekonomine e

lire te tregut dhe e shtremberon ate. Sipas Ligjit 9918 neni 56, ne cdo rast rregullimi i tarifave ne nivel pakice duhet te jete masa e fundit e aplikueshme, pasi praktika te kete treguar se cdo mase tjeter rregullatore ka deshtuar te sjelle konkurrence ne treg.

21. Per sa me lart, Vodafone mbeshtet qendrimin e AKEP per de-rregullim te tarifave ne nivel pakice per Albtelecom. Sidoqofte, Vodafone i kerkon AKEP qe te monitoroje ne menyre te vazhdueshme kete treg pasi rasti i Albtelecom eshte rasti klasik i monopolistit te integruar vertikalisht ne tregun me pakice te aksesit dhe vazhdon te zoteroje nje perqindje te larte te tregut ne nivel retail por edhe ne nivel shumice per thirrjet. Duhet mbajtur ne vemendje qe nje monopolist i integruar vertikalisht ne tregun e pakices te parregulluar ka incentive te aplikojte nje ‘margin squeeze’ apo te ushtroje presion mbi marzhin e fitimit te operatoreve te tjere ne tregun e pakices te cilet furnizohen prej tij. Po ashtu nje monopolist i parregulluar ne menyren e duhur, ka tendence ti refuzoje akses operatoreve alternative qe jane me eficiente sesa biznesi i tij ne pakice. Madje kjo eshte nje praktike e hasur dhe me pare per te cilen Albtelecom eshte perballur disa here rresht ne mosmarreshje administrative perpara AKEP dhe eshte akuzuar nga operatore te tjere alternative ne tregun e telefonise fikse per ushtrimin e vazhdueshem te nje ‘margin squeeze’, sidomos ne tregun e kartave me parapagim.

Pergjigje e AMC:

- a- Duke pare problemet e mungeses se konkurrences efektive qe evidentohen akoma ne tregun me pakice te telefonise fikse per Albtelekom, situaten shume te paqarte ne lidhje me implementimin e portabilitetit fiks dhe vonesave te tij jashte cdo afati, propozimet per ndryshimin e numeracionit fiks, qe e bejne situaten ne tregun e telefonise fikse me pakice shume konfuze, vendosja e masave rregullatore per Albtelekom ngelet e domosdoshme ne kete treg.

Megjithatë vendosjen e detyrimeve rregullatore ne tregjet perkatese me shumice per Albtelekom, ato nuk kane pasur efektet e pritshme ne tregun me pakice, pasi struktura e tregut nuk eshte ende konkurruese, Albtelekom ka nje pozite dominante mbi operatoret e tjere alternative ne treg, te cilet kane shume pak aftesi ndikuese mbi Albtelekom, pavaresisht paketave te ndryshme tarifore qe ata ofrojne.

Rregullimi i tregjeve me pakice parashikohet nga neni 17 i Direktives mbi Sherbimin Universal, i amenduar nepermjet Direktives se BE-se 2009/136/EC, ne momentin kur vendosja e detyrimeve rregullatore ne tregjet me shumice te lidhur me ato retail nuk jep efektet e duhura te realizimit te objektivit te arritjes se konkurrences efektive ne tregun retail:

“ *Article 17 shall be amended as follows:*

(a) paragraph 1 shall be replaced by the following:

‘1. Member States shall ensure that national regulatory authorities impose appropriate regulatory obligations on undertakings identified as having significant market power on a

given retail market in accordance with Article 14 of Directive 2002/21/EC (Framework Directive) where:

(a) as a result of a market analysis carried out in accordance with Article 16 of Directive 2002/21/EC (Framework Directive), a national regulatory authority determines that a given retail market identified in accordance with Article 15 of that Directive is not effectively competitive; and

(b) the national regulatory authority concludes that obligations imposed under Articles 9 to 13 of Directive 2002/19/EC (Access Directive) would not result in the achievement of the objectives set out in Article 8 of Directive 2002/21/EC (Framework Directive).''

Duke qene se paketat standarte te Albtelekom kane akoma probleme me orientimin ne kosto te tarifave perkatese, pavaresisht se kane qene nen rregullim, si dhe mungesa e konkurrences efektive ne tregun me pakice, AMC mendon qe eshte i pajustificueshem propozimi i AKEP per mos-rregullim te nivelit te tarifave te Albtelekom, dhe per kete sugjeron qe rregullimi i ketyre tarifave te vazhdoje te mbetet ne fuqi, si nje element i domosdoshem per te kufizuar mundesite per ndonje situata abuzive qe rrjedh nga pozita dominante e Albtelekom ne tregun me pakice te telefonise fikse.

Rreziku per situata te tilla abuzive nga ana e Albtelekom do te jete akoma me i madh ne kushtet e nje de-rregullimi te tregut me pakice, pas futjes se portabilitetit te numrit fiks, duke qene se Albtelekom kontrollon pjesen me te madhe te tregut ne te gjithe territorin dhe duke pasur avantazhe shume te medha ndaj operatoreve alternative, si nga ana financiare, ashtu dhe nga mbulimi i territorit. Keto rrisin me tej mundesite per situata abusive ne kurriz te operatoreve te tjere dhe ne dem tenje konkurrence te lire dhe te ndershme midis operatoreve alternative dhe atij inkumbent.

Duke qene se dhe tarifat me pakice per Albtelekom kane qene te rregulluara ne periudhen e meparshme, dhe jane evidentuar probleme te ketyre tarifave ne lidhje me kostot perkatese duke mos qene te orientuara ne kosto, lenia e ketyre tarifave te de-rregulluara per Albtelekom do te theksoje me teper kete problematike, duke i lene diskrecion te plote Albtelekom, i cili mund te abuzoje me keto tarifa ne treg, duke demtuar konkurrencen me operatoret e tjere. Dhe ketu duhet te kemi parasysh avantazhet e shumta qe ka Albtelekom ne lidhje me operatoret e tjere ne tregun e telefonise fikse.

- b- Pavec masave rregullatore te transparences dhe mos-diskriminimit ne tregjet e telefonise fikse me pakice, eshte e nevojshme dhe vendosja e rregullimit dhe mbajtjes nen kontroll te tarifave me pakice per operatorin inkumbent Albtelekom, ne menyre qe te parandalohen situata te mundshme abuzive qe mund te gjenerohen per shkak te pozites dominante ne keto tregje nga ana e Albtelekom, pasi vetem detyrimet e transparences dhe mos-diskriminimit nuk jane te mjaftueshme per te eliminuar keto situata. Vendimi per mos-rregullim te tarifave retail mbart me vete dhe disa rreziqe, nga te cilat operatoret inkumbente mund te perfitojne duke qene te lire ne percaktimin e tarifave, sic jane: vendosja e tarifave nen kosto per paketa te ndryshme qe mund te ofrohen ne te ardhmen, etj.

Pergjigje e Abcom:

- a. Mendojme qe nuk jane zhdukur akoma pengesat ne treg per operatoret e tjere dhe per rrjedhoje nuk eshte krijuar akoma mjedisi konkurrent qe te justifikonte mosrregullimin e tarifave te operatorit dominant ne treg.
- b. Keto masa jane te mjaftueshme por ato nuk mund te aplikohen pa detyrimin per rregullim te tarifave.

Qendrimi AKEP:

AKEP duke vleresuar komentet e operatorëve në lidhje me këte pyetje të shtruar në konsultim publik, konsideron si parimor qëndrimin dhe komentet e Vodafone Albania në lidhje me kontrollin ose jo të tarifave në tregjet e pakicës. Duke mos gjetur të njëjtin qëndrim parimor edhe në komentet e AMC, AKEP sjell në kujtesë të AMC se në lidhje me faktin që tarifën me pakicë për Albtelekom kanë qenë të rregulluara në periudhën e mëparshme, dhe janë evidentuar probleme të këtyre tarifave në lidhje me kostot përkatëse duke mos qenë të orientuara në kosto, ky fakt ka rënduar apo ka qenë në disfavor të Albtelecom (kryesisht tarifa e aksesit). Por arsyetimi në këte rast duket të konsiderojë në mënyrë të plotë situatën aktuale dhe mundësitë reale të Albtelecom për të orientuar tarifën e aksesit në kosto (pasi do të shndërrohej në një efekt të kundërt), si dhe kushtet reale të numri gjithnjë e më shumë të paketave tarifore që sot egzistojnë në treg, përfshirë këtu edhe shërbimin e internetit si pjesë të paketave tarifore që janë prezente në treg.

AKEP gjykon se lenia e lirë (de-rregullimi) i tarifave të pakicës për Albtelecom, do të shërbejë si një instrument shtyës për zhvillimin e konkurrencës edhe për operatorët e tjerë alternativë në këte treg, qoftë edhe për një rivendosje me të drejtë të balancës së shërbimeve që mbajnë paketat tarifore që hedhin në treg, duke vleresuar shërbimet në baze të prioritetit që mund të këte edhe përzgjedhja e pajtimtarit.

Në dokumentin e konsultuar, AKEP se bashku me propozimin e bërë për de-rregullim të tarifave të pakicës për Albtelecom, sjell në vëmendje angazhimin me të madh dhe rritjen e nivelit të monitorimit nga AKEP për këte segment tregu, duke përcaktuar elemente shtesë në detyrimin e vendosur për mos-diskriminim ndaj Albtelecom në tregjet me pakicë.

Në rrethim në lidhje me detyrimin e njoftimit të tarifave me pakicë para aplikimit të tyre nga Albtelecom, AKEP ka bërë ndryshime në këte dokument final duke reduktuar afatin e njoftimit për paketën standard Familjare nga 2 muaj në 1 muaj si dhe duke hequr detyrimin për njoftimin paraprak të tarifave të tjera. Në rrethim njoftimi paraprak i tarifave (sipas afatëve të përcaktuara nga AKEP) nuk bie në kundërshtim me “Rregulloren për Publikimin e informacionit për tarifën si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”, pasi paragrafi i fundit i nenit 8 përcakton se:

Sipërmarrësit, të cilëve AKEP u ka vendosur detyrime të vecanta për tarifën me pakicë, duhet të aplikojnë afatet dhe rregullat e përcaktuara nga AKEP në mënyrë specifike.